



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**

**“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE FINANCIAR”**

**“BASHKIA HIMARË”**

**Tiranë 2023**

## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit .....	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	10
<b>II. HYRJA.....</b>	<b>12</b>
1. Objektivat e auditimit.....	13
2. Qëllimi i auditimit .....	13
3. Identifikimi i çështjes .....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	14
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	14
6. Kriteret e vlerësimit .....	14
7. Standardet e auditimit .....	15
8. Metodologjia e auditimit.....	15
9. Dokumentimi i auditimit .....	17
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>17</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Himarë.....	17
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	18
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik. ....	18
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	30
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.....	53
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	74
2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. ....	126
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit. ....	135
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. ...	137
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .....	155
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>164</b>
<b>V. ANEKSET.....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Himarë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi Financiar u krye për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Himarë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Buxheti **për vitin 2021** është realizuar në total në masën 47% ose nga 961,416 mijë të programuara, është realizuar 452,081 mijë lekë, nga të cilat nga granti i kushtëzuar dhe i pakushtëzuar në vlerën 158,261 mijë lekë ose sa 35% e realizimit vjetor dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 293,820 mijë lekë ose 65% e realizimit vjetor.

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” 215 “Mjete transporti”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2021, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet me vlerë kontabël 137,747,839 lekë në fillim të vitit 2021 dhe 287,712,000 lekë në fund të vitit 2021. Gjendja e kësaj llogarie ka pësuar rritje nga në vlerë 149,964,161 lekë, si pasojë e mos pagesës dhe mos arkëtimit së detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore nga subjekte.

- Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **914** subjekte debitorë në vlerën **252,053,121 lekë**, në vlerë **35,659,000 lekë** janë debitorë për taksë toke, në vlerën **5,819,000 lekë**, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën **29,840,000 lekë**.

- Nuk janë ndjekur procedurat për pajisjen me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë **në vlerë 8,000,000 lekë**.

- Nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **59 persona** me vlerë **3,851,173 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë.

- Nuk kanë likuiduar detyrimet për periudhën objekt auditimi 11 qiramarrës në vlerën **5,375,850 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë.

- Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan:

- 2 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor;
- 3 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve në lidhje me afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi;

- 5 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit që duhet ngarkuar në sistemin e-leje;
- Nga auditimi i zbatimit të punimeve rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **4,161,966.26 lekë** për 3 kontrata.
- Nga auditimin e 7 procedurave me vlerë të fondit limit 159,825 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 7 procedura me vlerë kontrate 151,937 mijë lekë ose 95 % e vlerës së Fondit Limit. Në këto procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim, ka pasur mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në 4 (katër) procedura për vlerën 51,729,783 lekë pa Tvsh.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Himarë, KLSH ka dhënë “*Opinion të kundërt*” për pasqyrat financiare dhe “*Opinion të kundërt*” për përputhshmërinë. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse.

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Himarë si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoji të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Himarë 15 Akte Konstatime dhe 1 Akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Himarë të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 74,770,620 lekë, ose 12,8 % e vlerës së buxhetit të vitit 2021 dhe vendime gjykate në vlerën 585,320 lekë nga viti 2018-2021. (faqe 17-30 të RPA)	E lartë	Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Himarë të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore të paraqesë një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrimeve në vlerën <b>74,770,620 lekë</b> , duke ndjekur radhën e pagesave.

2	<p>Në fund të vitit 2021, llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 46,136,181 lekë rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën 20,859,786 lekë, pra me diferencë për vlerën <b>178,152 lekë</b>, pasqyruar më pak në llogaritë e fund vitit 2020 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në 51 raste për vlerën 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Himarë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. (faqe 53-74 të RPA)</p>	E lartë	<p>Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.</p>
3	<p>Në fund të vitit 2021, llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 46,136,181 lekë rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën 20,859,786 lekë, pra me diferencë për vlerën <b>178,152 lekë</b>, pasqyruar më pak në llogaritë e fund vitit 2020 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në 51 raste për vlerën 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Himarë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. (faqe 53-74 të RPA)</p>		<p>Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.</p>
4	<p>Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe pagesave për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, u konstatua se disa fatura të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin vitit 2020, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 5 raste në vlerën 16,378,087 lekë. Për vlerën 46,593,485 lekë si detyrim i prapambetur për objektin “Ndërtimi i rrugës së fushës së sportit Himarë” kategoria Investim me fondet e veta, kryer para vitit 2015. Është konstatuar se ky detyrim nuk është përcjellë në raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe as nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2021 duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të PF të vitit 2021 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve. Për pasojë është nën vlerësuar llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerë -62,958,572 lekë. Vlerë e cila duhej të paraqitej në shumën 137,729,192 lekë në fund të vitit 2020 dhe 120,364,105 lekë në mbyllje të vitit 2021. Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.</p>

	në fund të vitit ushtrimor 2021 për vlerën <b>-46,593,485</b> lekë. (faqe 53-74 të RPA)		
5	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë. Më konkretisht, Bashkia Himarë, me miratimin e këtyre lejeve të ndërtimit, ka shkelur përcaktimet ligjore në lidhje me respektimin e distancave urbane, lartësisë së ndërtesave, parcelën minimale të zhvillueshme, intensitetin e ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit të tokës, shfrytëzimin e hapësirave publike dhe hapësirave për rrugë, kërkesat minimale për parkim. (faqe 135-159 të RPA)	E lartë	Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.
6	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 5 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit që duhet ngarkuar në sistemin e-leje. Më konkretisht, dokumentacioni që mungon ka të bëjë me vërtetimet e operatorit Ujësjellës-Kanalizime Himarë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, që tregojnë se subjektet e zhvillimit nuk kanë detyrime të papaguara, Certifikatës së Regjistrimit në QKB ose ekstraktit historik i regjistrimit tregtar, policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale. (faqe 135-159 të RPA)	E lartë	Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit shoqëruar për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara <b>Ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"</b> , i ndryshuar dhe <b>VKM nr. 408, datë 13.5.2015</b> , i ndryshuar.
7	Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Himarë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza: 1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Himarë; 2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore; 3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore. Nga auditimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Himarë rezulton se: - Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullor, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe. (faqe 30-53 të RPA)	E lartë	Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me: <b>1.</b> T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura. <b>2.</b> Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. <b>3.</b> Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej <b>207.65</b> ha, duke aplikuar tarifën dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit ( <b>14,090,740 lekë/vit</b> , për 18 subjekte). <b>4.</b> Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore. <b>5.</b> Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrime vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

8	<p>Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë <b>914</b> subjekte në vlerën <b>252,053,121 lekë</b> dhe në vlerë <b>35,659,000 lekë</b> janë debitorë për taksë toke <b>5012</b> familje në vlerën <b>5,819,000 lekë</b>, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, 5852 familje në vlerën <b>29,840,000 lekë</b>.</p> <p>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve. (faqe 30-53 të RPA)</p>	E lartë	<p>Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën <b>287,712,121 lekë</b>, si më poshtë vijon:</p> <p><i>a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.</i></p>
9	<p>Nga auditimi i praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ukonstatua se nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, për periudhën objekt auditimi, ndaj subjekteve “H...P...” Shpk, “M.. V...” Shpk, “A... K...” Shpk, “D...” Shpk, “D...O...” Shpk, “H....P...” Shpk, “M.. S...P...” Shpk, dhe “D... Oil” Sh., nuk janë ndjekur procedurat për pajisjen e tyre me Autorizim/Licenca për tregtimin e naftës dhe gazit, veprime në kundërshtim me VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kap II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxheti Bashkisë Himarë në vlerë <b>8,000,000 lekë</b>. (faqe 30-53 të RPA)</p>	E lartë	<p>Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektori i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga <b>8 subjekte të vlerës 8,000,000 lekë</b>, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit, Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.</p>



10	Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksë e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë <b>59 persona</b> me vlerë <b>3,851,173 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë.</b> (faqe 30-53 të RPA)	E lartë	Bashkia Himarë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, ti kërkojë ASHK-së, Vlorë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi dhe hipotekore subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit, pa kryer pranë Bashkisë Himarë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, sektorin e të Ardhurave Vendore të bëjë të mundur kontabilizimin dhe pasqyrimin e plotë të debitorëve. Të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë ndjekjen e hapave ligjorë, deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e paraqitur si debitorë në vlerën <b>3,851,173 lekë</b> sipas listës, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.
11	Bashkia Himarë për periudhën objekt auditimi ka lidhur 11 kontrata për dhënie me qira të Aseteve pyje dhe kullota për vendosjen e antenave të telefonisë celulare, nga auditimi në lidhje me pagesat e detyrimeve të kontratave u konstatua se nuk kanë likuiduar detyrimet në vlerën <b>5,375,850 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë.</b> (faqe 30-53 të RPA)	E lartë	Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës <b>5,375,850 lekë</b> , duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës, bashkëlidhur Raportit të Auditimit.
13	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 11,108,665.70 lekë, fituar nga BOE “K... I...” Shpk & “I...” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>951,232.26 lekë pa Tvsh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 460 prot., datë 15.12.2021 të lidhur mes AK Bashkia Himarë dhe BOE “K..I..” Shpk & “I...” Shpk. (faqe 126-135 të RPA)	E lartë	Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>951,232.26 lekë pa Tvsh</b> nga BOE “K..I..” Shpk & “I...” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
14	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 194,444,444 lekë, fituar nga BOE “K...G... K...” Shpk & “M../S...” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën <b>2,612,310 lekë pa Tvsh</b> . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 229 prot., datë 07.09.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe BOE K.. G... K...” Shpk & “M../S...” Shpk. (faqe 126-135 të RPA)	E lartë	Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>2,612,310 lekë pa Tvsh</b> nga BOE “K.. G... K...” Shpk & “M../S...” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, duke mos u mbështetur në bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë, por në një tjetër bazë ligjore dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksa me vlerën më të lartë, në bazë të <b>Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006</b> dhe ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt: <b>“Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”</b> , me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021,		Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimit Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës <b>279,728.78 lekë</b> , përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues <b>z. F...M....</b>

	me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues "A...N..." ShPK, në Dhërmi, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej <b>279,728.78 lekë</b> . (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të RPA).		
15	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, duke mos u mbështetur në bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë, por në një tjetër bazë ligjore dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksa me vlerën më të lartë, në bazë të <b>Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006</b> dhe <b>Ligjin nr. 107/2014</b> , "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt: " <b>Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë</b> ", me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues "J...I..." Shpk në Jalë, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej <b>4,363,399.06 lekë</b> . (faqe 135-159 të RPA)	E lartë	Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës <b>4.363.399,06 lekë</b> , përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues " <b>J... I...</b> " Shpk.
	Nga auditimin e 7 procedurave me vlerë të fondit limit <b>159,825 mijë lekë</b> , janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 7 procedura <b>me vlerë kontrate 151,937mijë lekë</b> ose 95 % e vlerës së Fondit Limit, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në 4 (katër) procedura për vlerën <b>51,729,783 lekë pa Tvsh</b> .(faqe 74-126 të RPA)	E lartë	AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### Opinioni i auditimit:

##### I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2021:

Objekti i Audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Himarë për vitin ushtrimor 2021 të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare, është bërë vlerësimi i parimeve kontabël të aplikuara, vlerësimeve të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Sipas mendimit

tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet, pozitën financiare të Bashkisë Himarë më datat 31 Dhjetor 2021 referuar ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe Akteve të tjera nënligjorë mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, të cilat justifikojnë dhënien e **opinionit të kundërt** për pasqyrat financiare të vitit 2021, e shprehur kjo në bazën për opinion.

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë edhe faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të vitit 2021 dhe/ose në këtë periudhë nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, është përgjegjësi e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive. Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2021, i referohen faktit që disa llogari të detyrimeve kreditore dhe të drejtave mbi debitorët, nuk pasqyrojnë gjendjen reale në vlera materiale,-ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se për vitin 2021 nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

-Për vitin 2021, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 1 rast në vlerën 46,593,485 lekë.

-Për vitin 2021, llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është raportuar më pak vlerën 178,152 lekë.

-Për vitin 2021, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” është raportuar më pak vlerën 103,574,000 lekë.

#### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë:**

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, mbi zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e të ardhurave, mbi menaxhimin e asetëve si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues si dhe. Në opinionin tonë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Himarë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kundërt të përputhshmërisë.

#### **Baza për dhënien e opinionit të kundërt<sup>3</sup>**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Në 7 raste të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2021 janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përputhje me të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

- Në 7 raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.

- Në 4 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 51,729 mijë lekë.

<sup>3</sup>Sipas Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, *Opinion i kundërt jepet nëse rastet kur mospërputhjet janë materiale dhe të përhapura, fq. 105.*

- Janë konstatuar detyrime të pa arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet me vlerë **3,851,173 lekë**.

- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve konstatohet se detyrimet që subjektet fizikë/juridikë kanë më 31.12.2021 janë në vlerën **252,053,121 lekë**, debitorë për taksë toke në vlerën **35,659,000 lekë**, debitorë për taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore në vlerën **5,819,000 lekë**, debitorë familjarë në vlerën **29,840,000 lekë**.

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan:

- 2 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë;

- 3 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve në lidhje me afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi;

- 5 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriterëve në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit që duhet ngarkuar në sistemin e-leje.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Himarë:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Himarë.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1024/1 Prot, datë 15.11.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar me shkresën nr. 1024/2 Prot, datë 28.12.2022 nga data 21.11.2022 deri në datë 13.02.2023, në subjektin Bashkia Himarë u krye auditimi Financiar për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. G.. K.. – *Përgjegjës Grupi*
2. R.. L.. – *Anëtar*
3. P.. X.. – *Anëtar*
4. J..B.. – *Anëtar*

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Himarë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuarra dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>4</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Himarë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Himarë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2021.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.06.2021-31.12.2021.

---

<sup>4</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi zbatimimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

#### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arrijtjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

#### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Himarë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimet e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Himarë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;

- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Himarë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse,

por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Himarë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

#### 8. Raporte dhe Informacione.

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

*Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>5</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup>ISSAI 1315

<sup>6</sup>Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektive* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin - Bashkia Himarë**

**Zona Gjeografike:** Bashkia e re e Himarë kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastrë dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2011 Himara ka 7,818 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron 27,049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km<sup>2</sup>, densiteti i popullsisë në bazë të censurit rezulton vetëm 13.7 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrimit civil, densiteti është 47 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës Horë Vranisht. Ajo është një bashki e pasur me burime ekonomike me përqendrim të turizmi, peshkimi, blegtoria e ullishtet, të gjitha produkte dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar. Por pavarësisht kësaj, është bashkia e dytë me densitetin më të ulët të popullsisë në Shqipëri pas Dropullit si pasojë e largimit të pjesës dërrmuese të banorëve për në Greqi ose në qendrat e mëdha urbane në vend.

Bashkia ndahet në dy territore shumë të ndryshme: zona bregdetare si dhe zona e ish-komunës Horë - Vranisht, një zonë e thyer malore e cila aktualisht nuk lidhet me qendrën e bashkisë me rrugë moderne të drejtpërdrejtë, por vetëm me një rrugë historike mushkash e cila aktualisht nuk është e përdorshme. Bashkia ka mundësi të konsiderueshme ekonomike dhe në përgjithësi infrastrukturë të zhvilluar në drejtim të rrugëve dhe ujit të pijshëm ndërsa bregdeti i saj konsiderohet nga më të pastrit në vend për shkak të distancës së banesave nga bregu i detit.

Ndërkohë, resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

## 2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

#### Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Raportet e Monitorimit;
7. Pyetëtori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Himarë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1 “Angazhimi për integritet dhe vlerat etike”.**

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

- Për periudhën 2021 ka pasur një Rregullore të Brendshme, përkatësisht Rregullore e Brendshme miratuar në vitin 2017. Nuk është miratuar Kodi i Etikës, por rregullat mbi etikën përshkruhen në rregulloren e brendshme. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi, komunikimi mbi rregulloren e brendshme është kryer verbalisht.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin”.

**Në lidhje me parimin 2** “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

- Për vitin 2021 nuk ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Për periudhën 2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë hartuar çdo 4 - muaj, nuk ka raportime periodike, por vetëm vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitet e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencionit.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Për vitin 2021** është miratuar me Vendim nr. 111 datë 31.12.2020 dhe ka në përbërje të saj 215 punonjës.

- Për periudhën objekt auditimi rezulton se, përgjatë periudhës 2021, ka pasur ndryshime të shpeshta të strukturës edhe në krijimin e sektorëve, çka në gjykimin e grupit të auditimit ndikon negativisht në performancën dhe realizimin e objektivave institucional, duke mos pasur qëndrueshmëri në numrin e punonjësve, krijimin e paqartësive si rrjedhojë e ndryshimeve të shpeshta.

- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

**Në lidhje me parimin 4** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Në Bashkinë Himarë nuk është hartuar “Harta e procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore” për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve ndonëse janë kryer trajnime me ASPA.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

-Për Bashkinë Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, si dhe Zëvendëskryetari për dy funksione (autorizuar nga Kryetari i Bashkisë), i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizimin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

**Në lidhje me parimin 5** “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjëshmërinë menaxheriale”.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoli i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur raste të delegimit të detyrave.

- Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të qeverisjes vendore”, janë ngritur GMS vetëm për hartimin e PBA 2019-2021 dhe 2020-2022 dhe jo për PBA 2021-2023. Lidhur me përbërjen e GMS, në përgjithësi ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësive të qeverisjes vendore”, ku drejtuesi i grupit është Kryetari i Bashkisë, si dhe ka përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e bashkisë.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

- Bashkia Himarë nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

- Nuk administrohen proces verbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, për strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Duke marrë parasysh dhe faktin që ka pasur ndryshime në strukturë, është domosdoshmëri hartimi I rregullores së re duke e përshtatur sipas strukturës aktuale.

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Himarë përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) vetëm në hartimin e PBA-ve dhe buxheteve vjetore. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Himarë nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është vartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar) të Bashkisë Himarë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e njësive të vetëqeverisjes Vendore”.

- Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla, kryesisht në planin e buxhetit vjetor me planin e buxhetit të parashikuar në PBA.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.

- Në Bashkinë Himarë, nuk ka pasur një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.

- Në Bashkinë Himarë nuk është krijuar regjistri i riskut.

- Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

- Në Bashkinë Himarë, po ashtu Drejtoria Ekonomike për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin “Excel” dhe jo me program kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Ekonomike dhe hartimi i pasqyrave financiare, gjithashtu edhe Sektori i Tatim-Taksave operon me programin “Excel” për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe me Agjentët Tatimorë.

**Në lidhje me parimin 8:** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrim”.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**Në lidhje me parimin 9:** “Njësia publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Himarë nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

### **III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.

- Për prokurime nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve /shërbimeve.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit duhej të ishte mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Nuk është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

- Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM nuk ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjësimin e tyre. Nuk ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.

- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Himarë, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas

marrëveshjes së Bashkisë Himarë të bërë me këta agjentë. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.

- Bashkia Himarë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.

**Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Bashkia Himarë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

- Në Bashkinë Himarë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

- Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

**Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve të sektorëve, ku vihen re mbivendosje/mbingarkesë të funksioneve.

- Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin e investimeve merret Drejtoria Ekonomike, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullores së brendshme.

- Nga njësia AB nuk është ushtruar auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.08.2018 i ndryshuar “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

**Në lidhje me parimin 13:** “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Bashkia Himarë disponon faqen e saj zyrtaren të internetit; <http://himara.gov.al> ku pasqyrohet përgjithësisht aktiviteti i saj si, planet e performancës, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

Përdoret sistemi e-albania për deklarime online për të marrë dokumente të ndryshme informimi. Nëpërmjet sistemit on-line të informimit, Bashkia Himarë nuk ka krijuar të gjitha mundësitë për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në procesin e prioriteteve buxhetore, nuk ka shpallur publikisht kalendarin e dëgjësive publike për çdo drejtori, sipas programeve respektive për periudhën 2021 si:

- Dëgjesa publike për programin “Paketa fiskale”
- Dëgjesa publike për programin “Investime në infrastrukturë rrugore dhe transport publik”
- Dëgjesa publike për programin “Strehimi dhe Shërbimi Social”

- Dëgjesa publike për programin “Arsimi parashkollor dhe parauniversitar” dhe “Shërbimet publike, investimet në Arsim”

Për vitin 2021, sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë verbale.

Grupi auditues konstaton se, nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

#### **V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, nuk administrohen plotësisht raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia Himarë lidhur me pyetësin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE, për vitin 2021.

- Në Bashkinë Himarë mungojnë rregullat të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Në Bashkinë Himarë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshëm dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

**Konkluzion:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

#### **“Mjedisi i kontrollit”**

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë



Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Riskut, dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

#### **“Menaxhimi i Riskut”**

-Nuk ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, sipas nenit 21 i Ligjit Nr.10 296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Procesi i menaxhimit të riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr.1 6, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në Bashkinë Himarë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatim Taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

- Mungesa e hartimit të regjistrit të riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut, ka sjellë mos identifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

#### **“Aktivitetet e Kontrollit”**

- Bashkia Himarë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm 2 specialistë që mund të kontrollojnë të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj.

#### **“Informimi dhe komunikimi”**

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në Rregullore është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, veprime me komunikim verbal ose shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### **“Monitorimi”**

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Himarë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Bashkinë Himarë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë raportet e zbatimit për planet e menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

### **Titulli i gjetjes 1: Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë Bashkisë Himarë**

#### **Situata:**

##### **“Mjedisi i kontrollit”**

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Riskut, dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Mungojnë evidenca mbi punën e kryer nga GSM.

##### **“Menaxhimi i Riskut”**

- Nuk ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe rregjistër risku, sipas nenit 21 i Ligjit nr. 10 296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Proçesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhedokumentuar me vendimet përkatëse në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, KreuII, si dhe Udhëzimit nr.16 datë20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit tëriskut njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në Bashkinë Himarë, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës dhe Sektori i Tatim Taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

- Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

- Mungesa e hartimit të regjistrit të riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut, ka sjellë mosidentifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

#### “Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Himarë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqsish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

- Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm 2 specialistë që mund të kontrollojnë të gjitha fazat e funksionimit të IT si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj.

#### “Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në Rregullore është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, veprimeve me komunikim verbal ose shkresor, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

#### “Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Himarë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Në Bashkinë Himarë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23, 24.

**Ndikimi:** Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mungesa e analizimit të cilësisë së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit, lënë hapësira për ndodhjen e anomalive dhe mos informimin e titullarit për këto anomali, nuk nxjerrin qartë përgjegjësitë etj.

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandime:** Kryetari i Bashkisë Himarë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

**Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm**

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë periudhës 01.06.2021 deri më datë 31.12.2021, është organizuar dhe ka funksionuar me 1 numër punonjësish në 6 mujorin e parë dhe 6 mujorin e dytë të 2021.

Përgjatë periudhës 2021, drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Himarë, është M..B., përkatësisht drejtues i njësisë deri më datë 31.12.2021.

**Struktura e njësisë AB për periudhën 2021**

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi
	<b>Për vitin 2021</b>						
1	M..B..	Përgjegjës	Viti 2016	I larte (ekonomik)	+33	16	I certifikuar

*Burimi: NJAB Himarë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

**Titulli i gjetjes 2:Mbi mangësitë e veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm**

**Situata:** Përgjatë periudhës Janar Dhjetor 2021, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Himarë, janë kryer gjithsej 2 auditime, ndarë si më poshtë vijon:

**Viti 2021**, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr.3351/2 prot., datë 19.10.2020, sipas të cilit janë planifikuar për t’u audituar:

Nr	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit				
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin
1	Spektori I PMZSH	3	Spektori I PMZSH	1					
2	Drejtoria Financës. Detyrimet e prapambetura e Financës	3	IMVT	1	1		0		
		<b>3</b>	<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>

*Burimi: NJAB Himarë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 3351/2 prot., datë 19.10.2020.

Nga auditimi i raportimit 2021, rezulton se janë dhënë 4 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë pranuar të gjitha. Nga 4 rekomandimet nuk janë zbatuar asnjë prej tyre.

Në mënyrë të përbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr.	Viti	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2021	4	0	0	4	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

- Për periudhën nga data 01.06.2021– 31.12.2021, pozicioni i drejtuesit të sektorit të auditit të brendshëm ka qenë vakant dhe nuk janë marrë masa për plotësimin e tij;
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Mungon Karta e auditimit të brendshëm sipas formatit të miratuar në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;.
- Për periudhën Qershor-Dhjetor 2021 numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë 1 i punësuar;
- Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021-2023, dhe është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6, mungon identifikimi i subjekteve, prioritetet;
- Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2019 - 2021 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me Formatin Standard 5: Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB përcaktuar në MAB, konkretisht jepet informacion vetëm për fushat që do të auditohen, llojet e auditimit dhe numrin e tyre, pra jo për zhvillimet aktuale të NJAB, objektivi (at) kryesore për vitin, sigurimi i brendshëm i cilësisë;
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2018-2021 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën “ç” të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”, pasi nuk jepet informacion për shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse; veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar;
- Plani strategjik 2020-2022 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2020 është hartuar nga drejtuesi i sektorit të auditimit të brendshëm, në përputhje me përcaktimin e bërë shkronjën “c” të nenit 14 në ligjin nr. 114/2015, “Për auditin e brendshëm publik”;
- Nuk ka gjetur zbatim Urdhri nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, lidhur me strukturën e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimeve të kryera në vitin 2021, si dhe dhënien e opinionit në përfundim të auditimit.
- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike për vitin 2021 janë arkivuar në arkivin e njësisë vendore, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar nuk janë çelur elektronikisht dhe manualisht për t'i shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3;

- Në auditimet e kryera për periudhën e vitit 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm.

- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;

- Për vitin 2021 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 3 auditime dhe janë kryer 2 gjithsej.

- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim 5 fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Himarë, të cilat janë vlerësuar 2 me risk të lartë dhe 3 me risk të mesëm.

**Kriteri:** Shkronja “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronjat “c” dhe “ç” në nenin 14, shkronja “e” në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3 të VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016” Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB), miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Kapitulli II, pika 8, Kreu 2.2.2, shkronjat “a” dhe “d”, Kreu 2.4.4, Kapitulli III “Plani i auditimit duhet të përgatitet mbi bazë risku – e thënë ndryshe.

**Ndikimi:** Moskryerja e auditimeve në fushat me risk që ka veprimtaria e njësisë vendore, sjell mosnjohjen nga auditi dhe titullari të rreziqeve të mundshme që ka në këto fusha, e për pasojë, duke mos i njohur, nuk ka as vëmendje për t'i minimizuar këto risqe e për ti monitoruar. Si përfundim titullarit nuk i jepet këshillimi i duhur nga ana e auditit të brendshëm, e cila është detyra kryesore e kësaj njësie.

**Shkaku:** Mungesa e stafit të NJAB dhe moskryerja e auditimeve në fushat me risk.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandime:** Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim eficientë e këtij sektori të rëndësishëm për Bashkinë.

**Për sa trajtuar më sipër ngarkohen përgjegjësi:**

- Z. J.G., Kryetari i Bashkisë Himarë;

- Znj. M.B.. Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për detyrat që ngarkohen ndaj këtij sektori në hartimin e rregjistrin të riskut;

- Z. L.M.. në funksionin e Nëpunësit zbatues;

## **2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

### 1.Programimi i PBA 2021-2023

Nga Bashkia Himarë, janë miratuar treguesit e buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën e viteve 2021-2023. PBA, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 27.11.2020, vlerësuar i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1165/1, datë 14.12.2020, protokolluar në bashki me nr. 1010/1 prot., datë 17.12.2020 dhe i është përcjellë Ministrisë Financave “Drejtoria e Financave të pushtetit vendor”. Treguesit e miratuar të PBA-së sipas llojeve të projekteve, janë si më poshtë vijon (Në formë tabelare):

## Të Ardhurat<sup>000/lekë</sup>

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021
1	Të ardhura nga taksat lokale	203,500
2	Të ardhura nga taksat e ndara	7,000
3	Të ardhura nga tarifat vendore	122,300
4	Të ardhura të tjera	3,000
5	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qira	36,000
<b>A</b>	<b>TOTALI TE ARDHURAVE TË VETA</b>	<b>371,800</b>
1	Transferta specifike	3,087
2	Transferta e pa kushtëzuar	120,771
3	Transferta e kushtëzuar	53,106
4	Fondi Zhvillimit Rajoneve	0
<b>B</b>	<b>Totali i të Ardhurave nga buxheti qendror</b>	<b>176,964</b>
1	Të ardhura të trashëguara me destinacion	
2	Të ardhura të trashëguara me pa destinacion	281,848
<b>C</b>	<b>Totali i të Ardhurave të trashëguara</b>	<b>281,848</b>
	<b>Totali të ardhurave (A+B+C)</b>	<b>830,612</b>

000/lekë

Nr.	Përshkrimi	2021
1	Shpenzime për personelin (600+601)	128,632
2	Shpenzime operative (602+606)	202,596
3	Shpenzime për investime (230+231)	475,748
4	Rezerve + Kontigjencë	10,404
5	Të tjera	13,232
<b>D</b>	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>830,612</b>

-Në programimin e buxheteve afat mesëm (PBA) për periudhën 2021, konstatohet se përgjithësisht janë zbatuar procedurat ligjore, treguesit e buxhetit afat mesëm. Konkretisht, janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë:

a) Kalendar i programit buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor është miratuar brenda datës 31 Dhjetor të vitit paraardhës, në zbatim të kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” me VKB nr. 66, datë 21.12.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 372 prot., datë 26.01.2021.

-b) Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm janë miratuar brenda muajit Korrik (të vitit paraardhës), në zbatim të kërkesave të nenit 37 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

-c) Janë miratuar Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve, kërkesë në zbatim të kërkesave të nenit 34 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Me shkresën nr. 2875 prot., datë 11.09.2021 i është dërguar Ministrisë së Financave Tabelat e plotësuara dhe relacioni shpjegues për PBA 2021-2023.

Për vitin 2021 buxheti është miratuar me VKB nr. 66, datë.21.12.2020.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Himarë për vitin 2021 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura nga taksat vitit.	210,500	
2	Të ardhura nga tarifa vitit	125,300	
3	Të ardhura nga shitja e pronës ose qira	11,000	
4	Të ardhura të trashëguara vitit	150,877	
5	Të ardhura të trashëguara nga granti pakusht	130,971	

6	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	53,106	
7	Te ardhura nga transfertat e kushtëzuar sektoriale	120,771	
8	Granti specifik	3,087	
9	Të ardhur nga debitorë të prapambetur	25,000	
	<b>Shpenzime</b>		
1	Paga (600)		110,090
2	Sig.shoqërore (601)		18,541
3	Shpenzime operative (602)		185,099
4	Transferta (603+604+605+606+609)		19,170
5	Investime (230 +231)		377,161
6	Rezerva + Kontigjence+tjera		10,404
7	Detyrime të prapambetura Investime		101,088
8	Detyrime të prapambetura Operative		9,059
	<b>Totali</b>	<b>830,612</b>	<b>830,612</b>

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se nga totali i të ardhurave që do mbulojnë shpenzimet e buxhetit për vitin **2021**, të ardhurat e veta zënë 63% ose në vlerën 522,677 mijë lekë ndërsa 37% janë grante specifike dhe grante konkurrese ose në vlerën 307,935 mijë lekë.

- Në buxhetin e miratuar për vitin 2021, nuk janë programuar si zë më vehte, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditoretë trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2020, janë në shumën totale 75,170,102 lekë nga të cilat:

75,170,102 lekë, llogaria 467- “Kreditorë të ndryshëm”.

Mos programimi si zë më vete në buxhet të detyrimeve të vitit paraardhës, është në **kundërshtim** me kërkesat e nenit 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

2 Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Për të gjithë periudhën e audituar, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

**Për vitin 2021** buxheti fillestar është për **vlerën 830,612 mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për **vlerën 961,416 mijë lekë** me rritje për **vlerën 130,805 mijë lekë**.

Për vitin 2021 me VKB nr. 19, datë 30.03.2021 është miratuar buxheti faktik i muajit Mars 2021 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1195/1, datë 06.04.2021 Për buxhetin e miratuar në Mars 2021, vlera e buxhetit është **860,169 mijë lekë, pra 29,555 mijë lekë** rritje në vlerë. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave nga grantet e pakushtëzuara të përgjithshme nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Po përsëri në vitin 2021 është ndryshuar buxheti në muajin Qershor me VKB nr. 26, datë 28.05.2021 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2059/1 prot., datë 14.06.2021. Në këto ndryshime totali i buxhetit është **941,416 mijë lekë**, pra 81,247 lekë më shumë se buxheti paraardhës i miratuar që ka ardhur si pasojë e rritjes së të ardhurave të veta nga vlera e parashikuar 210,500 mijë lekë në Mars 2021, në 311,748 në Qershor 2021 dhe pikërisht nga rritja e “Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë”.

3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.



Është rakorduar çdo muaj me degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Vlorë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitet respektive të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës më poshtë:

*Realizimi i buxhetit për vitin 2021, sipas situacionit me Thesarin.*

Në lekë

Nr	Emërtimi Sipas Artikujve Të shpenzimeve	Viti 2021	
		Plani/vjetor	Fakti/vjetor
1	Llog.600 - Paga	123,217,132	106,567,822
2	Llog 601 - Sig.shoq.Shëndetsore	23,639,818	17,797,706
3	Llog 602-Shpenz.operative	202,866,859	131,631,060
4	Llog 603, Subvencione Ujsjellësi	13,300,000	13,264,709
5	Llog 604, Këshilli Qarkut	3,438,000	2,967,377
6	Llog 606, Ndihmë ekon+Shpër. Lindje	5,145,000	701,203
7	Llog 609, Fondi rezerv, kontigjenc	23,191,000	0
8	Llog 605, Transferim jashtë Inst		
9	Llog 231 Investime	478,210,014	125,181,409
10	Llog 230 Projekte	88,408,682	53,969,532
	<b>TOTALI</b>	<b>961,416,505</b>	<b>452,080,899</b>
	<b>Realizimi në %</b>	<b>47%</b>	

### **Titulli i gjetjes 3:** *Mangësi në programimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2021*

**Situata:** Për vitin 2021, buxheti është realizuar në total në masën **47%** ose nga **961,416** mijë të programuara, është realizuar **452,081** mijë lekë, nga të cilat nga granti i kushtëzuar dhe i pakushtëzuar në vlerën **158,261** mijë lekë ose sa **35%** e realizimit vjetor dhe nga të ardhurat e veta në vlerën **293,820** mijë lekë ose **65%** e realizimit vjetor.

Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën **86 %** ose nga **123,217** mijë lekë të programuar, realizuar në masën **106,568** mijë lekë, nga të cilat nga granti **68,765** mijë lekë ose në masën **65%** dhe nga të ardhurat e veta në vlerën **37,803** mijë lekë ose **35,%** të totalit të realizimit të pagave, në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike **601**, është realizuar në masën **75 %** ose nga **23,640** mijë lekë të programuar, realizuar në masën **17,780** mijë lekë, nga të cilat nga granti **11,180** mijë lekë ose **63%** dhe nga të ardhurat e veta në vlerën **6,618** mijë lekë ose **37%** të totalit të sigurimeve. Shpenzimet operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën **65 %** ose nga **202,867** mijë lekë të programuar, realizuar në masën **131,631** mijë lekë, nga të cilat nga granti në vlerën **9,695** mijë lekë ose **7%** e realizimit dhe nga të ardhurat e veta në vlerën **121,936** mijë lekë ose **93%** të totalit të shpenzimeve operative dhe në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masëm **26 %** ose nga **478,210** mijë lekë të programuar, realizuar në masën **125,181** mijë lekë, nga të cilat nga granti **30,319** mijë lekë ose në masën **24%** dhe nga të ardhurat e veta në vlerën **94,862** mijë lekë ose **76 %** të totalit të investimeve.

**Kriteri:** Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, 65; UMF nr. 2, datë 06.02.20212 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46.

**Ndikimi:** Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Himarë dhe performancës në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi jo i duhur i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë në zbatimin e buxhetit vjetor. Mos zbatimi i kërkesave ligjore për kontabilitetin me efekt rritjen e detyrimeve kreditore dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.

**Rëndësia: E lartë:**

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë t parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Nga auditimi në lidhje me likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura për periudhën 01.01.2021-deri 31.12.2021, rezulton se janë prokuruar dhe financuar 27 kontrata të lidhura në vlerën **606,446** mijë lekë me TVSH, janë financuar gjatë periudhës 2021 në vlerën **105,576** mijë lekë ose 17.4 % e vlerës së kontratave sipas të dhënave në pasqyrën si më poshtë:

Në/000 lekë

Nr	Objekti	Operatori fitues	Vlera kontratës me TVSH	Kontrata		Likujd. 2021-22	Diferenca
				Nr	Datë		
1	Ujësjiellësi i Fshatit Tërbaç Himarë (vazhdim) Loti II	"C.." shpk	19,733	25	05.03.2021	3,753	15,980
2	Blerje karburant	BOE "E.." Sha & "D.. O.." Shpk	9,999	132	16.04.2021	5,147	4,852
3	Rikonstruksioni i rrugës Stefanel segmenti 1-2	"S.." shpk	57,711	--	19.04.2021	0	57,711
4	Rikonstruksioni i rrugës dhe zgjerimi i varrezave Piqeras	"A.." shpk	6,772	-	16.04.2021	0	6,772
5	Përmirësimi i ndriçimit Kudhës, Himarë	"S.." shpk	1,635	134	16.04.2021	865	769
6	Blerje materiale dhe detergjent pastrimi	"M.. C..S.." shpk	2,293	147	30.04.2021	2,293	0
7	Mobilim i pjesshem i zyrave te Bashkise	"S.." shpk	1,864	144	26.04.2021	1,864	0
8	Përmirësimi i ndriçimit Shkallë, Borsh	"I.. E.." shpk	1,974	-	19.04.2021	0	1,974
9	Rikonstruksioni I ujesjellesit Kallarar	"A..-2..C.." shpk	9,783	141	20.04.2021	5,706	4,076
10	Mirembajtja e kanaleve vaditese dhe kulluese	"E.." shpk	8,666	139	08.03.2021	6,036	2,630
11	Mirembajtje e shetitoreve Himare, Jala, Dhermi dhe Qeparo	"J..K.." shpk	2,935	148	30.04.2021	2,784	151,418
12	Sinjalistika ne plazhe dhe rrugore	BOE "S... & R.. S.. S.." shpk + "P.. G.."	3,321	169	28.06.2021	3,154	167
13	Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatit Vranisht	BOE "K... G.... K..." shpk+	194,444	-	07.09.2021	144,471	49,973
14	Shërbimi i pastrimit për zonat turistike	" K.. G..K.." shpk	9,197	-	19.09.2021	17,939	-8,742
15	Ujësjiellësi i zones Bramush Hore Vranisht	"A..-2... C.." shpk	40,130	321	12.10.2021	12,455	27,674
16	Rikonstruksioni i ujesjellesit Piqeras	BOE "E.. S..." + " D... C.."	87,067	332	15.10.2021	38,183	48,884
17	Vepra e marrjes dhe e shites se Linjes kryesore Kuç	"L.." shpk	26,365	380	15.11.2021	26,358	6
18	Mirembajtje shkollash	"J.." shpk	8,441	278	27.09.2021	8,439	1
19	Rikonstruksioni i rrjetit te ujesjellesit Hunde e Xhepe Bolene	"A...2... C..." shpk	8,747	470	21.12.2021	5,003	3,744
20	Blerje makinash	"C.." shpk	9,960	469	21.12.2021	9,960	0
21	Permiresimi i ndriçimit rrugor fshati Kuç	"L.." shpk	6,816	474.	22.12.2021	6,805	11
22	Mbrojtje lumore dhe pyllëzim i anës së lumit Borsh	BOE " K..I.. " shpk + "L.." shpk	11,108	460	15.12.2021	11,107	1
23	Rikonstruksioni pjesor i shkollës 9-vjeçare Himarë	"A...-2.. C..." shpk	7,542	385	08.11.2021	07,541	06
24	Rrethimi dhe sistemimi i oborrit të shkollës Borsh	"E.." shpk	6,615	381	05.11.2021	0	6,615
25	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje lerash	"A...-2... C.." shpk	5,961	472	21.12.2021	5,961	0
26	Mirëmbajtje rrugë rurale	"A..-2.. C.." shpk	8,878	461	15.12.2021	8,023	854
27	Rikonstruksioni i rrugës Stefanel segmenti 2-4	"S..." shpk	42,477	456	10.12.2021	28,772	13,704
	<b>Totali</b>		<b>600,446</b>			<b>369,245</b>	<b>231,201</b>

#### 4. Monitorimi

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021, të bashkisë Himarë është paraqitur në afat dhe pjesërisht sipas formateve të Udhëzimit nr. 22, datë, 30.07.2020 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetqeverisjes vendore”.

Bashkia Himarë, mbi bazë të raportit të dërguar MFE ka paraqitur detyrime financiare të konstatuara dhe të papaguara në vlerën 27,650,651 lekë ndërsa në bilancin kontabël të vitit 2021 paraqitet në vlerë 74,770,620 lekë, vlerë e cila nuk është paraqitur në raport. Nuk është paraqitur niveli, kohëzgjatja dhe struktura e detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë, si pjesë e raporteve periodike të monitorimit të buxhetit. Nuk janë dërguar raportet periodike të monitorimit sipas kërkesave të pikës.8 të Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetqeverisjes vendore” ku përcaktohet se: *Procesi i raportimit mbi performancën e produkteve për secilin program kërkon përgatitjen e tre raporteve periodike të monitorimit në vit. Raporti i katërmujorit të parë dhe katërmujorit të dytë dorëzohen në Këshillin e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe në Drejtorinë përgjegjëse për financat vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit, dhe konkretisht deri në 30 Maj; 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor, brenda muajit shkurt të vitit të ardhshëm. Si dhenë kundërshtim me pikën 5, të nenit 42, të ligjit 68/2017.*

#### 5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore.

Nga të dhënat, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 74,770,620 lekë, ose 12,8 % e vlerës së buxhetit të vitit 2021 dhe vendime gjyqate në vlerën 585,320 lekë.

Në mënyrë analitike detyrimet për fatura të pa likujduara me datë 31.12.2021, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Nr.Fature	Data	Emertimi	Shuma/lekë
1	327	07.07.2020	G... C.. SHPK mbikeqyrje punimesh KUZ POTAM	40,000
2	31	02.10.2020	T... N.. Person Fizik	120,000
3	124	14.10.2020	M... Shpk	770,400
4	116	18.08.2020	F.. M.. Blerje materiale hidraulike	790,962
5	02	20.06.2020	K..F.. C... Mbikqyrje punimesh Rik. i Qendrës Tërbac	11,880
6	28	21.12.2020	E... Shpk sherbim kolaudimi Ndricimi me llamba led	25,729
7			Energjia Elektrike	8,925,742
8	114	21.12.2021	Rikonstruksioni i ujesjellesit Barmush,	35,371
9	64	19.11.2021	Ndertimi I ujesjellesit Piqeras E.. S.. SHPK	3,288,864
10	64	01.11.2021	Permiresimi I sistemit te furnizimit me uje Dhermi GJ.. SHPK	15,705,920
11	52	17.11.2021	Ndertimi I ujesjellesit Vranisht K..G...K..	26,257,856
12	69	29.12.2021	Supervizim ujesjellesi Dhermi H....&.S... ..	1,000,000
13	326	17.12.2021	Supervizim ujesjellesi Terbac H....&.S... ..	200,000
14	7	30.09.2021	K...&...F.... C... Mbikqyrje punimesh Pastrimi mirembajtje kanale vaditese	119,880
15	47	15.11.2021	Pastrimi I zonave turistike K.. G...	578,534
17	21	18.11.2021	Permiresimi I ndricimit Borsh I... E... SHPK	1,974,600
18	439	23.12.2021	Mbikqyrje ujesjellesi Vranisht N...-G...SHPK	631,958
19	33	23.12.2021	Materiale ndertimi S...	1,968,400
20	17	03.12.2021	Mirembajtje kanale vaditese K.. K..	40,000
21	1	13.12.2021	Blerje dru zjarri O... 2...	797,000
22	40	09.12.2021	A...-S... Festat e Nentorit	322,000
23	43	24.12.2021	AJ... S.. Blerje ndricues dhe dekor qyteti	576,000
24	419	31.12.2021	Shtypshkronja e letrave me vlere	43,200
25	131-133	29.12.2021	C.... SHPK Blerje makinash	9,960,000
26	24	29.12.2021	K... K...Supervizim i rugeve rurale	108,000
27	25	30.12.2021	K... K... Superv punimesh ndertim ujesjellesi	395,074
28	26	30.12.2021	K... K... kolaudim ujes Terbac	83,250
			<b>TOTALI</b>	<b>74,770,620</b>

### Detyrimet sipas vendimeve gjyqësore detyrim më datën 31.012.2021

Emër	Data Viti	Vendimi	Vlera/lekë	Shuma/ lekë
T... L..	26.05.2020	24	129,240	129,240
A...K..	07.05.2018	263	93,600	93,600
A. K..	07.05.2018	263	93,600	93,600
A...K...	07.05.2018	263	3,240	3,240
E... E...	09.07.2019	377	93,600	93,600
A... K...	07.05.2018	263	3,240	3,240
A. K..	07.05.2018	263	3,240	3,240
A... K...	07.05.2018	263	3,240	3,240
E... E...	09.07.2019	377	93,600	93,600
A...K...	07.05.2018	263	3,720	3720
<b>Shuma I</b>			<b>520,320</b>	<b>520,320</b>
<b>Viti 2021</b>	Data			
M... N..	07.01.2021		13,000	13,000
M... N..	02.02.2021		13,000	13,000
M... N...	02.03.2021		13,000	13,000
M... N...	06.04.2021		13,000	13,000
M... N...	05.05.2021		13,000	13,000
<b>Shuma II</b>			<b>65,000</b>	<b>65,000</b>
<b>Total (I+II)</b>				<b>585,320</b>

Sa më sipër nga Sektori i Financës nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40, 48.

#### **Titulli i gjetjes 4:** Mos likuidim në kohë i faturave dhe detyrimeve gjyqësore

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 74,770,620 lekë, ose 12,8 % e vlerës së buxhetit të vitit 2021 dhe vendime gjykate në vlerën 585,320 lekë nga viti 2018-2021.

**Kriteri:** Kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48.

**Ndikimi:**Në treguesit ekonomik dhe financiarë të Bashkisë.

**Shkaku:**Mos zbatitmi i legjislacionit në fuqi.

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Himarë të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore të paraqesë një material për gjendjen e faturave të pa likujduara dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrimeve në vlerën 74,770,620 lekë, duke ndjekur radhën e pagesave.

6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKB-në nr. 59, datë 27/11/2020, konfirmuar dhe nga Prefekti i Qarkut Vlorë, “ Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Himarë” ku përfshin dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07 .2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar. Përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, për periudhën 01.01.2021 deri në 31.12.2021.

Në strukturën e Bashkisë Himarë, ka funksionuar Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social kupër të ardhurat ka funksionuar Sektori i të Ardhurave, me një Përgjegjës Sektori dhe 8 specialistë të taksave dhe tarifave vendore.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, për vitin 2021, kanë ushtruar aktivitet 749 subjekte (676 subjekte të biznesit të vogël, 73 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione).

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

*Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas llojeve të taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera, në 000/ lekë.*

Tabela nr.1

Nr.	Emertimi	Viti 2021		Në Përqindje
		Plani vjetor	Fakti Vjetor	
<b>A</b>	<b>I- Te Ardhura nga Taksa</b>	<b>311.748</b>	<b>374.000</b>	<b>120,0%</b>
1	Tatim i thjeshtuar mbi Biznesin	4.500	3.410	75,8%
2	Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura	3.000	2.981	99,4%
3	Tatim mbi te ardhurat personale	0	0	
4	Taksa mbi kalimin e te drejtës se Pronësisë	3.000	12.733	424,4%
5	Taksa mbi Rentën Minerare	1.000	0	0,0%
6	Taksa e Ndërtesës	30.000	14.029	46,8%
7	Taksa e Truallit	3.000	1.744	58,1%
8	Taksa e Tokës Bujqësore	4.500	1.131	25,1%
9	Taksa e Ndikimit ne Infrastruktore	251.248	331.103	131,8%
10	Taksa e Fjetjes ne Hotel	10.000	6.506	65,1%
11	Taksa te Përkohshme(Parkimi)	0	0	
12	Takse Reklame	1.500	364	24,3%
<b>B</b>	<b>II- Te Ardhura nga Tarifa</b>	<b>125.300</b>	<b>148.846</b>	<b>118,8%</b>
1	Tarife Pastrimi	40.000	25.994	65,0%
2	Tarife Gjelbërimi	7.100	6.587	92,8%
3	Tarife Ndriçimi	7.100	6.976	98,3%
4	Tarife për Zënien e Hapësirës Publike	50.000	88.887	177,8%
5	Tarifa për Leje Ndërtimi	4.000	11.350	283,7%
6	Tarife për Shërbime Komunale	5.000	3.934	78,7%
7	Tarifa për Shërbime Administrative	3.000	1.359	45,3%
8	Tarife KUZ	1.100	182	16,5%
9	Tarife Parkimi	4.000	469	11,7%
10	Tarife Leje Licenca	1.000	61	6,1%
11	Kamatëvonesa	1.000	171	17,1%
12	Gjoba	2.000	2.876	143,8%
<b>C</b>	<b>III- Te Ardhura nga Menaxhimi i Aseteve</b>	<b>11.000</b>	<b>1.556</b>	<b>14,1%</b>
1	Shitje te Pasurive te Paluajtshme	0	0	
2	Qira Ndërtesa	1.000	0	0,0%
3	Qira Troje	6.000	1.556	25,9%
4	Qira Kullota	4.000	0	0,0%
<b>D</b>	<b>Te Ardhura Gjithsej (I+II+III)</b>	<b>448.048</b>	<b>524.402</b>	<b>117,0%</b>

1	Te Ardhura nga Debitore te Prapambetur	25.000	17.704	70,8%
2	Te tjerat te Ardhura	0	0	
	<b>Totali</b>	<b>473,048</b>	<b>542,107</b>	<b>114,6%</b>

Burimi: Drejtoria e të ardhurave

-Nga të dhënat e Drejtorisë së Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, janë realizuar në vlerën **542,107** mijë lekë ose 114.6 % e planit në vlerë totale.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi dhe tejkalimi.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Himarë janë paraqitur si më poshtë:

Tabela nr.2

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	
		Plan/vjetor	Fakt/vjetor
<b>A</b>	<b>TE ARDHURA NGA TAKSAT</b>	<b>311,748</b>	<b>542,107</b>
1	Tat.Tthj. mbi Fitimin DRT	4,500	3,410
2	Tak. Mjet. te Perdorura DRSHR	3,000	2,981
3	TAPersonale DRT	0	0
4	Taksa kalimin e Pronesis ASHK	3,000	12,733
5	Taksa mbi Renten Minerare DPD	1,000	0

Konstatohet se :

Përsa më sipër tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mospatur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët e kalojnë xhiron vjetore dhe në zbatim të ligjit kanë paguar Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Himarë, taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më përpara dhe të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale rezulton të mos jetë planifikuar për periudhën objekt auditimi.

Sa më sipër planifikimi i këtyre lloj taksave është bërë pa u mbështetur në dokumentacion ligjor, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

*Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet pa leje në mënyrë progresive deri me datë 31.12.2021.*

Nga të dhënat që disponon Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas listave të sjella nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Vlorë sot ASHK Vlorë me shkresë, të destinuara për regjistrim në ASHK Vlorë, konstatohet se për periudhën e auditimit, sipas listave për leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **59 persona dhe subjekte** me vlerë **3,851,173 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë**, sipas pasqyrës (aneks nr.2/4) bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.thuhet se: *Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për*

Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 2/1, ku thuhet: “Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit”. Në mënyrë të detajuar paraqiten në (Aneks.2/4) bashkëlidhur PRA.

**Titulli i gjetjes 5:***Të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i taksës në infrastrukturë për ndërtimet e pa leje të kualifikuar për legalizim apo të legalizuara.*

**Situata:**Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se, nga Bashkia Himarë Sektori i të Ardhurave, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Vlorë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Himarë, konstatohet se deri më 31.12.2021, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 59 persona, veprime dhe mosveprime e jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23. “Për Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të Bashkisë Himarë, pika IV, sipas listës që disponon Bashkia, **me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 3,851,173 lekë.**

**Kriteri:** Ligji nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.

**Ndikimi:** Mungesa e realizimit të të ardhurave nga taksa e infrastrukturës për legalizimet e ndërtimeve informale.

**Shkaku:** Mos ndjekje dhe mos marrje e masave nga Bashkia Himarë për arkëtimin e taksës së infrastrukturës nga debitorët, që kanë kryer legalizime të ndërtimeve pa leje.

**Rëndësia:** I Lartë

**Rekomandimi:**Bashkia Himarë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Vlorë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi dhe hipotekore subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit, pa kryer pranë Bashkisë Himarë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, sektorin e të Ardhurave Vendore të bëjë të mundur kontabilizimin dhe pasqyrimin e plotë të debitorëve. Të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë ndjekjen e hapave ligjorë, deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e paraqitur si debitorë në vlerën **3,851,173** lekë sipas listës.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Z. K... K...me detyrë, ish/Përgjegjës i Sektorit së Të Ardhurave Vendore.*

*Të ardhurat nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit,për periudhën objekt auditimi.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e lëshimit të Autorizimeve /Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë dhe arkëtimin e detyrimeve për këtë tarifë rezultoi se: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, për periudhën objekt auditimi nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra

në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, përsa i përket arkëtimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Himarë.

Referuar kapitulli II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, në të përcaktohet që:

*II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:*

*b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.*

*9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5,000,000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.*

*- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr. 344, datë 19.4.2017.*

*“9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.*

Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Himarë, u audituan procedurat e dhënies dhe pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, Vendimeve të Këshillit Bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për licencë karburanti, (Autorizim), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, u konstatua se:

Në bashkinë Himarë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 8 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me licencën dhe nuk kanë likuiduar vlerën prej **8,000,000 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë**, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, si dhe pika 15.1, 15.2 të këtij akti normative, sipas të dhënave të pasqyrës si më poshtë:

Lista e subjekteve aktivë që ushtrojnë aktivitet të tregtimit të lëndëve djegëse e hidrokarbure për konsumatorët fundorë, në territorin e Bashkisë Himarë.



Tabela nr.4

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Detyrim për tu paguar në /lekë
1	H... P...-1	K...H	Himarë Fshat	1,000,000
2	M...V...	J....N	Shen Vasil	1,000,000
3	A... K...	J....S	Lukovë	1,000,000
4	D... shpk	K....E	Qazim Pali	1,000,000
5	D... O...shpk	L....G	Himar Fshat	1,000,000
6	H... P...-2	K....H	Dhermi	1,000,000
7	M... So... P...	L...A	Potam	1,000,000
8	D... O.. shpk	L....G	Dhermi	1,000,000
	<b>Shuma</b>			<b>8,000,000</b>

**Titulli i Gjetjes 6 :** Mbi licensimin dhe tarifimin e gabuar e të ardhurave nga tarifa e licencimit të ushtrimit të veprimtarisë nga subjektet private për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante etj.

**Situata:** Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, u konstatua se 8 subjekte private si vijojnë janë të pa pajisur me licencë për periudhën: dhe ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me licencë nga Bashkia Himarë për periudhën 2021. Subjektet e mëposhtme bazuar në dokumentacionin e disponuar janë debitorë me nga 1,000,000 lekë secili. Më poshtë paraqiten subjektet e konstatuara pa autorizim të vlefshëm:

Nr	Subjekti	Nipti	Adresa	Detyrim për tu paguar në /lekë
1	H..P...-1..	K...H	Himar Fshat	1,000,000
2	M..V..	J...N	Shen Vasil	1,000,000
3	A..K..	J...S	Lukovë	1,000,000
4	D..shpk	K...E	Qazim Pali	1,000,000
5	D.. O.. shpk	L...G	Himar Fshat	1,000,000
6	H..P...-2..	K...H	Dhermi	1,000,000
7	M.. S.. P..	L...A	Potam	1,000,000
8	D..O..shpk	L...G	Dhermi	1,000,000
	<b>Shuma</b>			<b>8,000,000</b>

Këto subjekte ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante me seli në territorin e Bashkisë Himarë dhe në Njësitë Administrative dhe nuk janë pajisur me autorizim të vlefshëm për ushtrimin e veprimtarisë me afat 5 vjeçar për periudhën e vitit 2021 dhe që e shtrin efektin deri në vitin 2026. Nuk kanë paguar tarifën e caktuar prej 1,000,000 lekë secili, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën **8,000,000 lekë**.

**Kriteri:** VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9.

**Ndikimi:** Të ardhura të munguara, për buxhetin e Bashkisë Himarë, në vlerën **13,000,000 lekë**.

**Shkaku:** Mos arkëtimi i tarifës vendore nga lëshimi i autorizimeve për këtë kategori subjektsh.

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe sektorit të Ardhurave Vendore, të marrë masa që për 8 subjektet të arkëtojnë tarifën e plota, për diferencën debitore prej 8,000,000 lekë për Subjektet debitorë si vijon:

1-H... P...-1... K....H H..F..1,000,000 lekë.

2-M... V... J....N S.. V... 1,000,000 lekë.

3-A... K... J...S L.... 1,000,000 lekë.

4-D.... shpk K...E Qazim Pali 1,000,000 lekë.

5-D... O... shpk L...G Himarë Fshat 1,000,000 lekë.

6-H...P.-2 K...H Dhërmi 1,000,000 lekë.

7-M... S.. P.. L...A Potam 1,000,000 lekë.

8-D.. O.. shpk L...G Dhërmi 1,000,000 lekë.

Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit, Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

*-Të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi.*

Bashkia Himarë për periudhën objekt auditimi ka lidhur 11 kontrata për dhënien me qira të aseteve pyje dhe kullota për vendosjen e antenave të telefonisë celulare, nga auditimi në lidhje me pagesat e detyrimeve të kontratave u konstatua se nuk kanë likuiduar detyrimet **në vlerën 5,375,850 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, lidhja 2, pika 7, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sipas të dhënave në pasqyrën si më poshtë:

***Lista e debitorëve të antenave të telefonisë celulare***

*Në/lekë*

<i>Nr</i>	<i>Subjekti</i>	<i>Detyrim i papaguar 2019</i>	<i>Detyrim i papaguar 2020</i>	<i>Detyrim i papaguar 2021</i>	<i>Shuma progresive</i>
<b>1</b>	V...VUNO	340,650	340,650	0	681,300
<b>2</b>	V... DHERMI	0	0	425,000	425,000
<b>3</b>	V...KEPI I QEFALIT	160,500	160,500	0	321,000
<b>4</b>	V...Gjorm,VRANISHT	339,600	339,600	0	679,200
<b>5</b>	A.... SH.A.Palermo	0	300,000	300,000	600,000
<b>6</b>	A....SH.A.Pilur	0	300,000	300,000	600,000
<b>7</b>	A.... SH.A Dhërmi	0	300,000	300,000	600,000
<b>8</b>	A.... SH.A.Vuno	0	300,000	300,000	600,000
<b>9</b>	T... A... SH.A. Ftera 1448	114,600	114,600	114,600	343,800
<b>10</b>	T... A... SH.A. Ftera 0901	59,050	54,500	54,500	168,050
<b>11</b>	T...A...SH.A.Pilur 1414	178,750	178,750	0	357,500
	<b>Totali</b>	<b>1,193,150</b>	<b>2,388,600</b>	<b>1,794,100</b>	<b>5,375,850</b>

**Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve.**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 49/2016 “Për disa ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/ bashkive” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 20.7.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari” dhe Urdhrit nr. 3700, datë 09.09.2021;

Grupi i punës i ngritur nga drejtorja e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, zyra e pyjeve dhe kullotave, Bashkia Himare ka përpiluar evidencën e kërkesave dhe listën e kullotave dimërore që do të kontratohen për vitin 2021- 2022 që janë paraqitur Kryetarit të Bashkisë Himarë për miratim. Për Administrative Lukovë janë lidhur 53 kontrata për kullota dhe janë arkëtuar 1,787,995 lekë në total. Njësia Administrative Hor-Vranisht 68 kontrata në shumën 906,100 lekë total dhe për Himarën janë lidhur dhe arkëtuar për 24 kontrata në shumën 395,600lekë. Sa më sipër janë lidhur konform kërkesave ligjore.

**Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa progresive për vitin 2021.**

Vlera e stokut të borxhit tatimor në 01.01.2021 në mënyrë progresive është në vlerën 136,782,293 lekë, janë shtuar dhe pakësuar gjatë vitit dhe gjendja në fund të vitit rezulton se vlera e borxhit në 31.12.2021 në mënyrë progresive është në vlerën 287,712,000 lekë nga të cilat; 914 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 252,053 mijë lekë, 5012 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 5,819 mijë lekë, 5,852 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 29,840 mijë lekë, Totali i detyrimeve të krijuara për vitin 2021 paraqitet në vlerën 150,929,707 lekë ose me një rritje 47.5% të totalit të stokut ku peshën më të madhe e zënë detyrimet e biznesit, më pas vinë familjarët për tarifatat vendore si: Pastrim, gjelbërim, ndriçim, taksë ndërtese etj. Fakt është se tarifimi i tyre vijon të bëhet sipas regjistrimit të gjendjes civile dhe jo sipas një adresari të azhornuar saktë. Gjithsesi konstatohet se rritja e borxhit dhe mos arkëtimi në kohë përbën risk duke ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Himarë, efekte që shtrihen në mungesë të shërbimeve dhe investime në infrastrukturë etj.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Në 000/lekë

Emërtimi	Viti 2021	
	Vlera	Nr. Subjekte
<b>Debitorë progresiv ne total</b>	<b>252,053</b>	<b>914</b>
Biznesi i vogël	183,619	855
Biznesi i Madh	68,434	59

**- Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave dhe masat e marra shtrënguese për arkëtimin e debisë nga tatimpaguesit dhe uljen e borxhit tatimor.**

Drejtoria Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, me ndryshime.

Për periudhën objekt auditimi, kanë bllokuar llogaritë e subjekteve debitorë me urdhër bllokime në bankë për 14 subjekte debitorë për një vlerë prej 17,701,029 lekë, nga të cilat kanë paguar detyrimet 5 subjekte debitorë ose 36% e subjekteve me vlerë 6,859,911 lekë dhe kanë njoftuar për detyrimet 144 subjekte debitorë për vlerën 62,817 mijë lekë ose 15% të subjekteve debitorë, kjo tregon për punë të pamjaftueshme pasi nga të dhënat rezultojnë subjektet të cilat janë debitorë vazhdojnë të jenë aktiv.

Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku thuhet se: *Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Paga e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masë*

100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar, dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematik debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2021, janë gjithsej debitorë për vlerën 35,659 mijë lekë lekë. Për taksë toke 2,175 familje për vlerën 5,819 mijë lekë dhe për taksë ndërtese dhe tarifa vendore 5852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë.

### **Debitorë për tokën bujqësore**

Në 000/lekë

Nr	Njësit Administrative	Sipërfaqe Tokës në ha	Numri i familjeve	Debitorë 31.10.2021 000/lekë
1	Himarë	82.1	2175	1,492
2	Lukova	1397	1598	3,420
3	Hor -Vranisht	802	1239	907
	<b>Totali</b>		<b>5012</b>	<b>5,819</b>

Dhe për mos pagesën e detyrimeve për taksë ndërtese dhe tarifa vendore për 5852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë sipas pasqyrave si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	Njësit Administrative	Numri I familjeve	Debitorë 31.12.2021 000/lekë
1	Himarë	2037	11,890
2	Lukova	2779	14,788
3	Hor -Vranisht	1036	3,162
	<b>Totali</b>	<b>5852</b>	<b>29,840</b>

Taksat Familjare të arkëtuara nëpërmjet agjentit tatimor Ujësjetës SH.A për vitin ushtrimor 2021 sipas tabelës përmbledhëse:

Në 000/lekë

	Taksa	Vlera e faturuar	Vlera e Arkëtuar	Debitor
1	Tarife Ndriçimi, Gjelbërimi dhe Shërbime	6635	5231	1404
2	Takse Toke Bujqësore	3284	2585	699
3	Tarife Pastrimi	8831	6959	1872
4	Takse Ndërtese Banimi	7419	6174	1245
5	Takse Trualli	105	86	19
	<b>Totali:</b>	<b>26,274</b>	<b>21,035</b>	<b>5,239</b>

### **Titulli i gjetjes 7: Performancë e ulët në arkëtimin e të ardhurave vendore**

**Situata:** Detyrimet e papaguara total në progresiv nga viti 2011-2021 paraqiten në vlerën 287,712,000 lekë, ku vetëm për vitin 2021 janë evidentuar 136,782, 293 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Himarë.

**Kriteri:** Aktet ligjore të sistemit të taksave dhe tarifave vendore, paketa fiskale miratuar me VKB, -Ligji nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, neni 90 “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, neni 93 “Sekuestrimi i pasurisë” neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”.

**Ndikimi:** Mungesë e të ardhurave në buxhetin e bashkisë, për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë për Taksat dhe Tarifat vendore dhe Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandimi:**a) Drejtoria e të Ardhurave Vendore Himarë, të marrë masa ligjore ndaj subjekteve debitorë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe të zbatojë procedurat ligjore për realizimin dhe arkëtimin e tyre.

b) Të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në momentin që lind detyrimi me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

### **Konkluzione:**

1) Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, konstatohet se me datë 31.12.2021 janë gjithsej **debitorë 914 subjekte për vlerën 252,053,121 lekë**. Nga Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, për subjektet debitorë përveç se janë dërguar bankave urdhër bllokime, në asnjë rast nuk kemi ndjekje të plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

2) Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2021, janë gjithsej **debitorë për vlerën 35,659 mijë lekë**. Për taksë toke **2,175 familje për vlerën 5,819 mijë lekë** dhe për taksë ndërtese dhe tarifa vendore **5852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë**.

3) Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi, u konstatua se nuk kanë shlyer detyrimet për 11 kontrata të lidhura, **në vlerën 5,375,850 lekë**.

4) Nga auditimi u konstatua se 8 subjekte, të cilët ushtrojnë veprimtari për shitjen e karburantit nuk janë pajisur me licencën për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe nuk kanë likuiduar **vlerën prej 8,000,000 lekë**.

5) Nga auditimi në lidhje me ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për ndërtimet pa leje në mënyrë progresive deri me datë 31.08.2021, u konstatua se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **59 persona dhe subjekte me vlerë 3,851,173 lekë**.

Për veprimet dhe mos veprimet e cituara mbajnë përgjegjësi ; z. K..K.. me detyrë ish/Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave Vendore dhe z. L..M.. në cilësinë e Drejtorit të Financës.

**Aktiviteti i Bashkisë Himarë në fondin pyjor lidhur me: “Shtrimin e rrjeteve/linjave, tubacioneve dhe ndërtime infrastrukturore të tjera të përkohshme ose të përhershme, nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve etj.”**

### **Baza Ligjore**

- Ligj nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar;
- Ligj nr. 57/2020 “Për pyjet”
- Ligj nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligj nr. 5/2016, datë 04.02.2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (ndryshuar
- VKM nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar;
- VKM nr.438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor”;
- VKM nr. 435, datë 08.06.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM nr. 1374/2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”;
- VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, i ndryshuar;
- VKM nr. 434 datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe paraqitjes së kërkesave, mbajtjen e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”;
- VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”, i ndryshuar;
- Udhëzim nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.
- Udhëzim nr. 6756, datë 03.09.2015 “Për zbatimin e VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

Bashkisë Himarë i janë transferuar me VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” e ndryshuar, 927 prona. Nga auditimi u konstatua se në territorin e bashkisë Himarë kanë ushtruar aktivitet 19 subjekte private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri pllakë, gurë gëlqerorë, gëlqeror mermer dhe gëlqerorë masiv, referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej **207.65 ha**, detyrimi dysHEME/minimal është përllogaritur përafërsisht **14,090,740 lekë/vit**, për 18 subjekte” .

Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësisve të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Ligji i fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për NJQV është ligji nr. 20/2020. “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” në neni 37 përcakton se: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, ky proces duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021. Në bashkinë Himarë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Himarë;

2) Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;

3) Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore.

Përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme që shfrytëzohen nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet mineral, në sipërfaqet ku funksionon lejet minerare aktive (jo infrastruktura lidhëse apo depozituese), nuk ka asnjë impak në situatën financiare të Bashkisë Himarë. Niveli i të ardhurave të Bashkisë nga qiratë e kësaj pasurive të paluajtshme (që nga viti 1995, kur janë aktive lejet minerare, Referuar AKBN) deri më sot, Janë në vlerë 0 lekë. Për një sipërfaqe **207.65**ha, Bashkia Himarë nuk merr asnjë të ardhur nga qeraja.

Grupi i auditimit i është referuar lejeve minerale aktive të paraqitura në faqen zyrtare të AKBN-së dhe listës dhe konfirmimit nga Bashkia Himarë, nga ku konstatohen lejet e paraqitura në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Nr.	Nr. Lejes	Data	Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit	Sip. km2	Sip. Ha
1	582/1	22/02/2018	“A...” Shpk	Gur gëlqeror	0.081	8.10
2	683/1	22/05/2013	“F... – F...” Shpk	Gur gëlqeror	0.0428	4.28
3	965	05/09/2006	“Z...-Z...” Shpk	Ranor silicor	0.088	8.80
4			“Z...Z...” Shpk	Ranor silicor	0.05	5
5	1634	13/06/2013	“D.... – 0....” Shpk	Gur gëlqeror	0.1	10
6	1730	08/04/2010	“S... C...” Shpk	Gur gëlqeror	0.074	7.40
7	226	26/12/1995	“I... B...” Shpk	Gur gëlqeror	0.182	18.20
8	661/1	19/11/2012	“P...” Shpk	Gur gëlqeror	0.107	10.70
9	662/1	28/08/2012	“A...” Shpk	Gur gëlqeror	0.05	5
10	870	17/06/2005	“I...” Shpk	Argjilë	0.15	15
11	1370	22/06/2009	“I...” shpk	Argjilë	0.07	7
12	1774	03/11/2015	“M...” Shpk	Ranor silicor	0.218	2.18
13	965/1	06/06/2016	“S...V...” Shpk	Ranor silicor	0.088	8.80
14	1730	08/04/2010	“S...C...” Shpk	Gur gëlqeror	0.074	7.40
15	1023	13/06/2007	“D... G...” Shpk	Ranor silicor	0.34	34
16	1361	19/06/2009	“G... ..” Shpk	Ranor silicor	0.1499	14.99
17	1795	11/04/2016	“S. M. V...” Shpk	Ranor silicor	0.368	36.10
18	1743/1	23/02/2015	“D...” Shpk	Gur gëlqeror	0.04	4
						<b>207.65</b>

Nga auditimi rezulton se në zonën Pyjore e Kullosore pronë/aset i Bashkisë Himarë janë aktive leje minerare që kryejnë aktivitetin shfrytëzim (Gur gëlqeror; Ranor silicor e Argjilë) 18 subjekte si më poshtë:

**1.Subjekti “A..” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 582/1, datë 22.02.2018, për sipërfaqe 0.081 km<sup>2</sup>, vendburimi Përroi Iliasit.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE “A..” Shpk”, për sipërfaqen 8.10 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “A..” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti “ushton veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “A..” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 8.10 ha, në Bashkinë Himarë është **502,200 lekë/vit. Në përllogaritje nuk është përfshirë vlera e tarifës minimale për karrierë**, (pasi sipërfaqet të jenë hequr nga fondi pyjor kullosor me VKM) dhe nuk ushton veprimtarinë minerare.

**2. Subjekti “F....” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 683/1, datë 22.05.2013, për sipërfaqe 0.0428 km<sup>2</sup>, vendburimi Përroi i Vishës Himarë.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“F...” Shpk, për sipërfaqen 4.28 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “F...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti “ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “F...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 4.28 ha, në Bashkinë Himarë është **265,360 lekë.**

**3. Subjekti “Z...-Z...” Shpk**, ka marrë dy leje shfrytëzimi për ranor me nr. 965, datë 05.09.2016, për sipërfaqe 0.1308 km<sup>2</sup>, vendburimet Qafë e Pëllumbit Vranisht e Vumblo, Pilur.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“Z...-Z...” Shpk”, për sipërfaqen 13.08 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “Z...-Z.” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “Z...-Z...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 8.10 ha, në Bashkinë Himarë është **810,960 lekë.**

**4. Subjekti “D... – 0...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për ranor me nr. 1634, datë 13.06.2013, për sipërfaqe 0.10 km<sup>2</sup>, vendburimi Palasë Himarë.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“D... – 0...” Shpk”, për sipërfaqen 10 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “D... – 0...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “D... – 0...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 10 ha, në Bashkinë Himarë është **620,000 lekë.**

**5. Subjekti “S.. C..” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 1730, datë 08.04.2010, për sipërfaqe 0.074 km<sup>2</sup>, vendburimi Kudhës.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“S... C...” Shpk, për sipërfaqen 7.40 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “S... C...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “S... C...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 7.40 ha, në Bashkinë Himarë është **458,800 lekë.**

**6. Subjekti “I... B...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 226, datë 26.12.1995, për sipërfaqe 0.182 km<sup>2</sup>, vendburimi Lukovë.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“I... B...” Shpk, për sipërfaqen 18.20 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “I... B...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.



Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “I. B...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 18.20 ha, në Bashkinë Himarë është **1,128,400 lekë**.

**7. Subjekti “P...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 661/1, datë 19.12.2012, për sipërfaqe 0.107 km<sup>2</sup>, vendburim Vollodrem i Sipërm.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“P...” Shpk, për sipërfaqen 10.70 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “P...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “P...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 10.70 ha, në Bashkinë Himarë është **663,400 lekë**.

**8. Subjekti “A...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 662/1, datë 28.08.2012, për sipërfaqe 0.05 km<sup>2</sup>, vendburim Hamalloi.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“A...” Shpk, për sipërfaqen 5 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “A...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “A...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 5 ha, në Bashkinë Himarë është **310,000 lekë**.

**9. Subjekti “I...” Shpk**, ka marrë dy leje shfrytëzimi për argjilë me nr. 870, datë 17.06.2005, dhe nr. 1370, datë 22.06.2009 për sipërfaqet 0.22 km<sup>2</sup>, për vendburimet Krekez e Gjashtë.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“I...” Shpk, për sipërfaqen 22 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “I...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “I...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 22 ha, në Bashkinë Himarë është **1,364,000 lekë**.

**10. Subjekti “M...” Shpk**, marrë leje shfrytëzimi për ranor silicor me nr. 870, datë 17.06.2005, dhe nr. 1774, datë 03.11.2015 për sipërfaqet 0.218 km<sup>2</sup>, për vendburimin Vranisht.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“M...” Shpk, për sipërfaqen 21.80 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullostr.

Në lidhje me veprimtarinë e “M...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “M...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 21.80 ha, në Bashkinë Himarë është **1,351,600 lekë**.

**11. Subjekti “S.V...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për ranor silicor me nr. 965/1, datë 06.06.2016, për sipërfaqen 0.088 km<sup>2</sup>, për vendburimin Qafë Pëllumbi Vranisht.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për

të paguar nga OE“S..V..” Shpk, për sipërfaqen 8.80 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “S..V..” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “S..V..” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 8.80 ha, në Bashkinë Himarë është **545,600 lekë**.

**12. Subjekti “S.C.” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 1730, datë 08.06.2010, për sipërfaqen 0.074 km<sup>2</sup>, për vendburimi Kudhës.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“S.V.” Shpk, për sipërfaqen 7.40 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “S.V.” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “S.V.” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 7.40 ha, në Bashkinë Himarë është **458,800 lekë**.

**13. Subjekti “D. G.” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për ranor silicor me nr. 1023, datë 13.06.2007, për sipërfaqen 0.34 km<sup>2</sup>, për vendburimi Tërbaç.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“D... G...” Shpk, për sipërfaqen 34 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “D. Group” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “D.Group” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 34 ha, në Bashkinë Himarë është **2,108,000 lekë**.

**14. Subjekti “G.” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për ranor silicor me nr. 1023, datë 13.06.2007, për sipërfaqen 0.1499 km<sup>2</sup>, për vendburimi Tërbaç.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“ G.” Shpk, për sipërfaqen 14.99 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “G... ” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “G.” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 14.99 ha, në Bashkinë Himarë është **929,380 lekë**.

**15. Subjekti “S. M.V.” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për ranor silicor me nr. 1795, datë 11.04.2016, për sipërfaqen 0.368 km<sup>2</sup>, për vendburimi Kuç.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE“ S. M.V” Shpk, për sipërfaqen 36.80 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kullosr.

Në lidhje me veprimtarinë e “S... M... V...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “S... M... V...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 36.80 ha, në Bashkinë Himarë është **2.281,600 lekë**.

**16. Subjekti “D...” Shpk**, ka marrë leje shfrytëzimi për gur gëlqeror me nr. 1743/1, datë 23.02.2015, për sipërfaqen 0.04 km<sup>2</sup>, për vendburimi Borsh.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk na u paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me llojin e pasurisë ku ushtrohet veprimtaria minerare (pyje/kullota), statusin e pasurisë dhe vlerën e përllogaritur për të paguar nga OE “D...” Shpk, për sipërfaqen 4 ha ku ushtrohet veprimtaria minerare, pasi sipërfaqja të hiqej nga fondi pyjor/kulloso.

Në lidhje me veprimtarinë e “D...” Shpk, grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokumentacion në lidhje me statusin e pronës ku subjekti ushtron veprimtarinë minerare.

Vlera minimale e qirasë për vitin 2021, që duhet të paguante OE “D...” Shpk për ushtrimin aktivitetin minerar të zhvilluar në sipërfaqen 4 ha, në Bashkinë Himarë është **248,000 lekë**.

### **Konkluzion:**

- Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Himarë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Himarë), në përputhje me pikën 4 të nenit 4, ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “*Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*” me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr. 134/2014 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*

- Për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/20 “*Për Pyjet*” (nenin 17 “*Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar*” të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, të ndryshuar.)

Bashkia Himarë nuk ka lidhur kontrata me subjektet që ushtrojnë veprimtari të nxjerrjes, prodhim dhe depozitim materialeve inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor.

Sa më sipër nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 “*Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar*” të ligjit nr. 57/2020 “*Për pyjet*”.

-Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kulloso, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosove ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe.

-Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “*Për Fondin Kulloso*”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “*Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor*”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “*Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kulloso*”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

**Vlera 14,090,740 lekë/vit, përbën të ardhur** (minimale pasi është konsideruar që nuk funksionon shfrytëzimi në karrierë), përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Himarë.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. J...G... me detyrë Kryetar i Bashkisë Himarë, z. I. D..., z. L..M..., z. K...M...*

**Titulli i gjetjes 8:** *Parregullsi në procedurat e ndjekura nga Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në shfrytëzimin për veprimtari ekonomike në fondin pyjor.*

**Situata:** Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njësisë të qeverisjes vendore (NJQV) është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Ligji i fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për NJQV është ligji nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” i cili në nenin 37 përcakton se: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021.

Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Himarë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Himarë;
2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;
3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore.

Nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit u audituan veprimtaria e subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Himarë të administruara nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave.

-Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullativ si vijon: Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar.

**Ndikimi:** Bashkia Himarë nuk ka kontroll mbi veprimtarinë ekonomike që zhvillohet nga subjektet private që përdorin sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor pronë e saj.

**Shkaku:** Mos respektimi e kuadrit ligjor nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 207.65 ha, duke aplikuar tarifatat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**14,090,7400 lekë/vit**, për 18 subjekte).

4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrime vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. J.. G.. me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë, z. I... D..., z. L..M.. dhe z. K... M...*

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2021.**

Për vitin 2021 nga "Bashkia Himarë" është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3 dhe 61 të ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr.10296, datë 8/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nenit 10 dhe 11 të ligjit nr.25, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabile" pjesa e parë "Rregulla të përgjithshme" kapitulli i parë "Mbajtja e kontabilitetit" dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme.

#### 1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në lidhje me auditimin mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2021, në Bashkinë Himarë konstatohet se: Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Himarë, për periudhën 2021, Formati nr.1, janë depozituar në Degën e Thesarit Vlorë sipas shkresës nr. 1526 prot, datë 28.03.2022. Është plotësuar Bilanci për vitin 2021 dhe pasqyrat anekse të tyre, e konkretisht me përbërjen si vijon:

-Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);

-Formati 2- Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;

-Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare;

-Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;

-Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;

#### Mungon

-Formati 6- Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;

-Formati 7- Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; (formati 7/a, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), formati 7/b, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).

-Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2021, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia publike Bashkia Himarë. Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë si dhe hartuesi i PF L.M. (Nëpunës zbatues).

Mbajtja e kontabilitetit viti 2021.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2021, të pozicionit financiar Bashkia Himarë;

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Himarë, mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi excel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njesisë dhe njësive të vartësisë. Drejtoria e Financës në Bashkia Himarë regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare, për të cilat mban përgjegjësi z. L.M.. në cilësinë e nëpunësit zbatues. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3 pika 15, neni 11 ku citohet se;

*“Bartës informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Qëllimi i pasqyrave financiare. 1.Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njësive ekonomike. 2.Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.*

**Titulli i gjetjes 9:***Mos mbajtja e regjistrimeve kontabël me bartës informatik.*

**Situata:** Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Himarë, mbahet në mënyrë manuale, që e bën më risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi excel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njesisë dhe njësive të vartësisë. Drejtoria Ekonomike në Bashkia Himarë dhe sektorët e financës në njësitë vartëse, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe

vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare për të cilat mban përgjegjësi z. L..M.. në cilësinë e nëpunësit zbatues.

**Kriteri:** Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se; “Dokument kontabël” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë.

“Bartës informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.” me nenin 11 ku citohet se:

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njëjësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Ndikimi:** Paraqitje e riskut për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar në vendimmarrjen e drejtimit të Bashkisë Himarë.

**Shkaku:** Mungesa e implementimit të sistemit informatik për proceset e kontabilitetit.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandime:** Titullari i Institucionit dhe Nëpunësi Zbatues i Njësisë Vendore të marrin masa për të siguruar dhe instaluar sisteme informatike kontabiliteti të pamanipulueshme me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë kontabël.

**Pasqyra e pozicionit financiar** të Bashkisë Himarë në 31.12.2021, sipas **formatit F1**, është paraqitur në *(Aneksin nr.1)* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivit, si më poshtë:

#### ➤ **AKTIVET**

##### **I. Aktivet Afat shkurtra.**

**Nën/rubrika, “mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”,** Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2021, në vlerë 627,822,241 lekë, e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm për:

-Gjendjen e mjeteve në ruajtje në vlerën 46,136,181 lekë,

-Grante dhe të ardhura të papërdorura 581,686,060 lekë.

Kjo llogari rakordon me aktrakordimin i mbajtur me Degën e Thesarit Vlorë për gjendjen e fondeve në fund të periudhës ushtrimore më hollësisht sipas Formatit nr. 3 si më poshtë:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi se llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” ka si kundër parti llogarit 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” dhe llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” duke i zbritur “Ndryshimin e gjendjes së inventarit”. Nga analiza e formatit nr. 2 të pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 85 Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” është në vlerën 381,033,824lekë, e kuadruar me të dhënat e Degës së Thesarit në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ,i ndryshuar. Këtu vlen të theksohet se për vitin 2021 edhe pse ka patur gjendje likuidetesh, pagesa e faturave të pa likuiduara nuk është kryer.

-Nga auditimi, u konstatua se : Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

## **2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”**

Llogaritë e inventarëve paraqiten; në fillim të vitit 2021 paraqiten në vlerën 14,936,603 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2021 paraqitet në vlerën 15,255,772 lekë, me rritje për vlerën 292,169 lekë si pasojë e blerjeve me pagesë gjatë vitit ushtrimor.

- *Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”* paraqitet për vitin 2020 paraqiten në vlerën 3,819,406 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2021 paraqitet në vlerën 4,138,575 lekë, më shumë për vlerën 319,169 lekë.(*ndryshim i gjendjes së inventarit*).

- *Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”* paraqitet për vitin 2020 paraqiten në vlerën 11,117,197 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2021 paraqitet në vlerën 11,117,197 lekë, diferenca 0 lekë.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Himarë .**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procedurat e inventarizimit, konstatohet se:

Nuk është kryer inventarizimi pasi nuk ekziston asnjë urdhër për fillimin dhe afatet e inventarit, vendin dhe llogaritë e përfshira në proces. Për sa më sipër, inventarizimi i aktiveve për vitin 2021, nuk është kryer, nuk është as i dokumentuar me dokumente ligjorë e kontabël për rrjedhojë; llogaritë e pasqyrave financiare, për këto llogari, nuk janë të besueshme, rezultojnë vetëm urdhra për zëvendësimet e komisioneve të përhershme dhe konkretisht;

Ka dalë urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 199, 200 dhe 201 datë 19.11.2021 “Për Zëvendësime në komisionin e përhershëm të inventarizimit të aktiveve” në Bashkinë **Himarë** për vitin 2021 i përbërë nga 6 anëtarë si vijon; L...V..., E... K..., K... B..., A...G..., A... H..., dhe M... S.....

Për Njësinë Administrative Lukovë si dhe për Njësinë Administrative Horë- Vranisht. Nuk dokumentohen veprime të mëtejshme për të vërtetuar kryerjen e procesit të Inventarizimit, mbi gjendjen fizike të Aktiveve të Paqëndrueshme të Patrupëzuara, Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve Qarkulluese, ku sipas të dhënave analitike kontabël për këto llogari nxjerrja e pasqyrave financiare vlera kontabël e llogarive financiare me gjendjen fizike është e pa rakorduar.

-Inventarizimi i aktiveve duke qenë se është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, i cili kryhet për të vërtetuar **saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre**, që kryhet nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues sipas procedurave të miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar, nuk është marrë me seriozitetin e duhur, pasi:

-Komisionet e kryerjeve të inventarizimeve fizike **nuk kanë përpiluar raporte lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes se tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës**, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, **siç cilëson pika 85/ c, e Udhëzimit.**



**Titulli i gjetjes 10:** *Mos kryerje e inventarizimit sipas kërkesave ligjore*

**Situata:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procedurat e inventarizimit, konstatohet se:

Nuk është kryer inventarizimi pasi nuk ekziston asnjë urdhër për fillimin dhe afatet e inventarit, vendin dhe llogaritë e përfshira në proces. Për sa më sipër, inventarizimi i aktiveve për vitin 2021, nuk është kryer, nuk është as i dokumentuar me dokumente ligjorë e kontabël, për rrjedhojë; llogaritë e pasqyrave financiare, për këto llogari, nuk janë të besueshme dhe nuk japin siguri të arsyeshme mbi raportimin financiar vjetor 2021.

**Kriteri:** UMF Nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, **Kreu III, pika 30 ku citohet:** “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.” dhe pika 74, Kap. IV të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

**Ndikimi:** Paraqitje jo të saktë e të besueshëm të informacionit kontabël mbi aktivet që i përkasin Bashkisë Himarë.

**Shkaku:** Mos kryerja e Inventarizimit.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandime:** Titullari i Institucionit dhe Nëpunësi Zbatues i Njësisë Vendore të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale të aktiveve si fizikisht po ashtu dhe kontabël.

### **3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

“Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 147,474,195 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2021 në vlerën 371,009,876 lekë, ku kemi rritje duke e krahasuar me vitin paraardhës si rezultat i i rritjes së llogarisë 4342.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit

**- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** paraqitet me vlerë kontabël 137,747,839 lekë në fillim të vitit 2021 dhe 287,712,000 lekë në fund të vitit 2021. Gjendja e kësaj llogarie ka pësuar rritje nga në vlerë 149,964,161 lekë, si pasojë e mos pagesës dhe mos arkëtimit të detyrimeve nga taksat dhe tarifatat vendore nga subjekte (biznes i madh dhe i vogël, taksë toke bujqësore, familjarë etj). Kjo llogari është e analizuar si vijon:

Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, konstatohet se me datë 31.12.2021 janë gjithsej debitorë 914 subjekte për vlerën 252,053,121 lekë.

Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë, janë gjithsej debitorë për vlerën 35,659 mijë lekë.

Taksë toke bujqësore 5,012 familje dhe për vlerën 5,819 mijë lekë dhe për taksë ndërtesë dhe tarifa vendore 5,852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë.

Konstatohet se: Nga Bashkia Himarë (nga auditimi i kaluar) është konstatuar se veç këtyre debitorëve, **nuk janë kontabilizuar debitorë të tjerë për 14 raste të gjobave të vendosura nga**

**APPP për shumën totale 3,240,000 lekësi dhe debitorë të tjerë sipas rekomandimeve të KLSH-së për 54 subjekte fizikë dhe juridikë për vlerën totale 80,145,955 lekë.** (Më hollësisht të dhënat sipas Aneksit nr.3/2 dhe 3/3 bashkëlidhur të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në këtë rast, **vlera totale e debitorëve të pa kontabilizuar** në pasqyrat financiare, **është për shumën totale 83,385,955 lekë** (fakt që është konstatuar edhe në auditimin e kaluar).

**Titulli i gjetjes 11:** Mos kontabilizim dhe arkëtim i detyrimeve dhe dëmeve ekonomike të konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme

**Situata:** Nuk janë kontabilizuar dhe detyrimet e auditimit të periudhës 2017 deri 30.09.2019, në vlerën **29,030,035 lekë**.

Nuk janë kontabilizuar debitorët e taksave e tarifave vendore me datë 31.12.2020, për 652 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, **në vlerën 103,574,000 lekë duke sjellë mos pasqyrim të saktë në bilancin kontabël të periudhës ushtrimore.**

Konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas Vendimit të Kryetarit të dërguara në Bashkinë Himarë. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

Nga Bashkia Himarë, nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore duke bërë kërkesë padi në gjykatë, për arkëtimin e shumave debitorë.

**Kriteri:** Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93.

**Ndikimi:** Mos zbatimi i procedurave ligjore në kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve, çojnë në mungesë të ardhurash për Bashkinë Himarë.

**Shkaku:** Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në Bashkinë Himarë, në zbatimin e akteve ligjore/nënligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Socialtë marrin masa për kontabilizimin e masave shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dërguar në Bashkinë Himarë me shkresat me nr. 366/13 Prot. Tiranë, më 25.12.2019 “Vendim i Kryetarit të KLSH” Nr. 158, Datë 25.12.2019 (Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 30.9.2019), të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të regjistrojë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit 2022, detyrimet debitorë të pa kontabilizuar për 67 raste në shumën 103,574,000 lekë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë pa shpresë arkëtimi.

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Operacione me shtetin (të drejta)” për vitin 2021 paraqitet në shumën 83,297,876 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 7,439,529 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 448,144 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,215,235 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën

303,199 lekë, llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 62,449,493 lekë dhe llog. 475 “Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse” në vlerën 10,442,276 lekë.

#### **Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :**

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 74,770,620 lekë. **Për vitin 2021** gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv **rakordon** me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit për vlerën 74,770,620 lekë.

Emërtimi	Celje 01.01.2021	Shtesa	Pagesa	Gjendje 31.12.2021
Lëvizja e llogarisë 486	75,170,102	64,085,907	64,273,395	74,770,620

*Burimi: Drejtoria e financës*

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.

## **II. AKTIVET AFATGJATA**

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 23I “Investime”) në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,546,096,321 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 2,346,053,814 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

**Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale”** që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në çelje të vitit 2021 në vlerën 37,117,772 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 35,550,106 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në çelje të vitit 2021 me vlerë 122,092,960 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 122,092,960 lekë. Sipas Formatit 7/b të PF gjendja e kësaj llogarie paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesa gjatë vitit 2021		Gjendja ne fund viti 2021		
		kosto historike 31.12.2020	Amortizim I akumu luar	Teprica Neto	kosto historike	Amortizimi	Kosto historike 2021	Amortizim i akumuluar	Teprica Neto 2021
	I. Të Pa Trupëzuara	122,092,960	84,975,188	37,117,772	0	5,567,666	122,092,960	90,542,854	31,550,106
201	Prime të emis. e rimb. të huav	0	0	0	0	0	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	122,092,960	84,975,188	37,117,772	0	5,567,666	122,092,960	90,542,854	31,550,106

### **Titulli i gjetjes 12: Mos pasqyrim i saktë i veprimeve kontabël**

**Situata:** Kjo llogari në bilanc është raportuar më shumë për vlerën 2,319,059 lekë vlerë e cila është e pa analizuar.

Në debi të kësaj llogarie, është kontabilizuar edhe vlera e Planit të Përgjithshëm Vendor në shumën 47,454,000 lekë.

-Nuk është kryer inventarizim mbi gjendjen fizike të këtyre studimeve dhe projekteve në ngarkim të personave që i administrojnë këto studime dhe projekte.

Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua se në totalin e llog 202- *Studime dhe kërkime*, nga 31 projekte që janë në këtë llogari një pjesë e projekteve dhe studimeve janë vënë në zbatim ose kanë përfunduar gjatë viteve të mëparshme dhe gjatë vitit ushtrimor 2021, nuk i janë shtuar kostos totale

të objekteve, megjithëse vlerat respektive të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë rritur në kontabilitet, në këto llogari nuk janë shtuar kostot e projekteve përkatëse. Konstatohet se Drejtoria e Financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021.

**Kriteri:** Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

**Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si:** programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”

**Kreu II.** “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

**Ndikimi:** Nuk paraqet një panoramë të qartë të pasqyrave financiare.

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjorë për sistemin e llogarive

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të marrë masa për sistemin e llogarisë (202) “Studime dhe kërkime”, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Për projektet të cilat kanë përfunduar, vlerat të kapitalizohet sipas objekteve përkatëse dhe regjistrohen në llogaritë përkatësisë, si pjesë e kostos totale të objektit.

**Aktivet Afatgjata Materiale”** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 1,514,546,215 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,223,960,854 lekë. U audituan

gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

**Llog 210 “Toka, troje terrene”** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Himarë dhe për njësitë administrative, në fund të 2020 rezulton në vlerën 28,563,121 lekë, ndërsa në fund 2021 rezulton në vlerën 28,563,121 lekë ose me rritje ose pakësim në vlerën 0 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 31.12.2020 (D)	28,563,121
Gjendja në 01.01.2021	28,563,121
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	0
Pakësim gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	28,563,121

Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet, mungojnë të dhëna mbi përmbajtjen e kësaj llogarie të trojeve, terrene dhe objekteve të investuara etj.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

**-Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”** për vlerën kontabël **0 lekë**, e cila nuk ka ndryshime gjatë vitit ushtrimor.

Përsa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave me VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 58. Sipërfaqet pyjore dhe kullotave, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Himarë, janë sipas shtojcës 56, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 927 (nëntëqind e njëzet e shtatë)., kjo gjë nuk ka ndodhur.

Për sa më sipër llog. (211) “Pyje, Kullota, Plantacione” nuk paraqet gjendjen reale për pasqyrat financiare të vitin 2021 pasi nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Himarë, të transferuara me VKM Nr 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

**Titulli i gjetjes 13:** Mbi kontabilizimet në llog. 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 0 lekë, gjendje e cila nuk është inventarizuar.

**Situata:** Në llog. (211) “Pyje, kullota, plantacione” nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Himarë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 58, shtojca nr.56 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Himarë, me nr nga 1 (një) deri (nëntëqind e njëzet e shtatë). Nuk ka inventarizim dhe vlerësim të këtyre aseteve.

**Kriteri:** UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

**Ndikimi:** Mungesa e analizës që i përket llog.211 “Pyje, Plantacione” ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:** Nga Bashkia Himarë nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite me qëllim evidentimin e vlerësimit e gjendjes aktuale dhe statusin e pyjeve e plantacioneve sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të transferuar për nxjerrjen e të dhënave për veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

**-Llogaria 212** “Ndërtime konstruksione” paraqitet në çelje të vitit 2021 në vlerë neto 768,202,754 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 729,792,616 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në çelje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,043,693,693 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,043,693,693 lekë e pa ndryshuar.

Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet sipas objekteve si; Shkolla, Qendra Shëndetësore, mure rrethues etj. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

**-Llogaria 213** “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet në vlerë neto në çelje të vitit 2021 në vlerën 583,420,521 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 466,736,417 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në çelje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 799,475,042 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 799,475,042 lekë. Ndryshimi ka ardhur nga llogaritja e amortizimit.

Nuk na u paraqitën të dhëna kontabël nëse është bërë kalim i kapitalit për Ujësjetës Kanalizimet sha si është akti i dorëzimit të këtyre aseteve etj. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

**-Llogaria 214** “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune” paraqitet në vlerë neto në çelje të vitit 2021 në vlerën 7,790,726 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,232,581 lekë me ndryshim -1,558,145 lekë amortizim. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në çelje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 13,878,553 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 13,878,553 lekë. Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet.

Këtu janë përfshirë edhe marrjet në dorëzim të trashëguara nga ish Komuna Lukovë asete në vlerën 6,973,512 lekë dhe nga ish Komuna Vranisht për vlerën 200,009 lekë të cilat janë të pa analizuar në përmbajtjen e tyre.

**-Llogaria 215** “Mjete transporti” paraqitet në vlerë neto në çelje të vitit 2021 në vlerën 28,117,272 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 32,453,818 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në çelje të vitit 2021 paraqitet në vlerën

49,502,084 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 59,462,084 lekë me një diferencë në rritje prej 9,960,000 lekë që përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i blerjeve.

Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet sipas vlerës së mjeteve.

Për llogarinë inventariale 215 “Mjete transporti” me vlerën kontabëlhistorike 42,502,084 lekë, nuk është e analizuar në kontabilitet, nuk u paraqitën kartelat dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre.

Nga Drejtori i Shërbimeve dhe Mirmbajtjes u paraqitën aktet e marrjes në dorëzim të mjeteve në përdorim për personat si më poshtë;

1-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Mercedes-Benz, Targa AA 226 AD më datë 15.04.2016, marrësi J.G.

2-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Tip. Chevrolet, Marka Spark, Targa AA ... AL më datë 15.04.2016, marrësi R. H.

3-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Tip. Chevrolet, Marka Spark, Targa AA .... AL më datë 15.04.2016, marrësi B. Al.

4-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Marka Mitsubish, Targa AA ... UX më datë 14.06.2018, marrësi G.B.

5-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Marka Mitsubishi, Targa TR .... U më datë 14.06.2018, marrësi A.B.

6-Akti i marrjes në dorëzim të Skrap i Ri tip. Volvo EC.... D më datë 20.10.2018, marrësi I. M.

7-Akti i marrjes në dorëzim të Skrepit Marka JCB, Targa P 1325 më datë 15.05.2019, marrësi N.. M.

8-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip TOYOTA CRUISER, Targa AA ... ZC më datë 17.01.2020, marrësi K.B.

9-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip IVEKO MAGIRUS, Targa s’ka, më datë 15.05.2019, marrësi A L..me detyrë Përgjegjës i Zjarrfikëses.

10-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip IVEKO, Targa s’ka më datë 15.05.2019, marrësi A.L. me detyrë Përgjegjës i Zjarrfikëses.

11-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip Benz Mercedes, Targa AA 954 VY më datë 15.05.2019, marrësi A.. L. me detyrë Përgjegjës i Zjarrfikëses. Çmim nuk ka dhe kartelë inventariale nuk ka.

12-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip VOLVO Veturë, Targa s’ka, më datë 15.05.2019, marrësi A... .. me detyrë Përgjegjës i Zjarrfikëses.

13-Akti i marrjes në dorëzim të mjetit Tip Furgon Benz MERCEDES, Targa s’ka, më datë 15.05.2019, marrësi A.. L... me detyrë Përgjegjës i Zjarrfikëses.

14-Flet dalje nr.310, datë 22.12.2020 në dorëzim të mjetit Tip Benz Atego, Targa s’ka më, evidentohet vetëm marrësi A... B... dhe Çmimi 5,923,854 lekë.

15-Akti i marrjes në dorëzim më datë 15.04.2016 të Autoveturë-Toyota, marrësi B. A. Targa s’ka. Si dhe lista e Mjeteve të cilat nuk janë në përdorim si më poshtë.

Nr	Emërtimi i Mjetit	Vendndodhja
1	Hyundaj VL ... C	Bashkia Himarë
2	Mercedes Benz	NJ/Administrative Vranisht
3	Mercedes Benz AA ... FR	Nj/Administrative Lukovë
4	Mercedes Benz	Nj/Administrative Lukovë
5	Opel AA...IU	Bashkia Himarë

-Konstatohet se për këto automjete nuk ka kartela inventariale dhe munngon çmimi i tyre.

**-Llogaria 218** “Inventar ekonomik” në datën 31.12.2020 është në vlerën neto 21,389,838 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,489,313 lekë. Ndërsa sipasFormatit nr.7/B “Gjendja dhe

ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” paraqitet në çelje të vitit 2021 në vlerën 44,163,077 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 47,610,011 lekë me rritje në vlerën 3,446,934 lekë si rezultat i shtesave të krijuara me pagesë.

**Titulli i gjetjes 14:** *Mangësi mbi të dhënat analitike kontabël mbi përmbajtjen ekonomike të tyre si dhe mungesa e dokumentacionit kontabël justifikues mbi të cilën është bazuar regjistrimi kontabël.*

**Situata:** Nga Bashkia Himarë, nuk është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të aseteve të saj dhe të dy Njësi Administrative ish-komunat, Horë-Vranisht dhe Lukovë për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Himarë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2021 rezulton se; nga Bashkia Himarë nëpunësi zbatues i njësisë publike, i caktuar nga titullari i njësisë publike në cilësinë e nëpunësi zbatues, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Himarë dhe njësitë në varësi, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Himarë, u konstatua se për vitin 2021, nuk është kryer inventarizimi mbi gjendjen fizike të Aktiveve të Paqëndrueshme të Patrupëzuara, Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve Qarkulluese, ku sipas të dhënave analitike kontabël për këto llogari. Nxjerrja e pasqyrave financiare pa i rakorduar vlerat kontabël të llogarive financiare me gjendjen fizike nuk jep siguri të arsyeshme mbi raportimin dhe saktësinë që paraqet bilanci kontabël. Veprim për të cilin mban përgjegjësi z. L.M. në cilësinë e nëpunësit zbatues. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33 në të cilin ndër të tjera citohet se:

*Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*

**Kriteri:** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26,28,30,33,74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5.

**Ndikimi:** Mos paraqitje e qartë e pasqyrave financiare.

**Shkaku:** Mos kryerja e Inventarizimit, vlerësimit të aktiveve dhe nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe mbajtjen e regjistrimit historik të Aktiveve në qarkullim, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.



**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandime:** Drejtoria e Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike.

Formati 7/b i bilancit, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” është paraqitur në pasqyrën emë poshtë:

Nr. Reference Llogarie	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
<b>b</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
20	37,117,772	-	5,567,666	-	-	122,092,960	90,542,854	31,550,106
201	-	-	-	-	-	-	-	-
202	37,117,772	-	5,567,666	-	-	122,092,960	90,542,854	31,550,106
203	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>21- 28</b>	<b>1,668,762,582</b>	<b>13,406,934</b>	<b>167,623,301</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,223,960,854</b>	<b>709,414,639</b>	<b>1,514,546,215</b>
210	28,563,121	-	-	-	-	28,563,121	-	28,563,121
211	-	-	-	-	-	-	-	-
212	768,202,754	-	38,410,138	-	-	1,043,693,693	313,901,077	729,792,616
213	583,420,521	-	116,684,104	-	-	799,475,042	332,738,625	466,736,417
214	7,790,726	-	1,558,145	-	-	13,878,553	7,645,972	6,232,581
215	28,117,272	9,960,000	5,623,454	-	-	59,462,084	27,008,266	32,453,818
216	-	-	-	-	-	-	-	-
217	-	-	-	-	-	-	-	-
218	21,389,838	3,446,934	5,347,460	-	-	47,610,011	28,120,699	19,489,313
24	-	-	-	-	-	-	-	-
28	231,278,350	-	-	-	-	231,278,350	-	231,278,350
<b>Totali</b>	<b>1,705,880,354</b>	<b>13,406,934</b>	<b>173,190,967</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,346,053,814</b>	<b>799,957,493</b>	<b>1,546,096,321</b>

➤ **Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2021.**

Për vitin 2021, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.7 “Amortizimi”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. Nga auditimi i Bilancit, Formatit 7, a dhe b: “Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)”, u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Lushnjë për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2021 paraqitet për vlerën 626,766,526 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 799,957,493 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore, shtesën e koston së blerjes dhe zbritjen e vlerës kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivitetit. Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2021 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%

Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.

### 3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën 231,278,350 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme.

**Llogaria. 231** “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 790,181,410 lekë dhe 2021 paraqitet në vlerën 1,328,610,027lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, për vitin 2021 ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likuidime për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23 në të cilën përcaktohet: “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:

- Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve.

- Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23, “Investime”.

- Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar. Grupi 23, “Investime” ndahet në dy llogari tre shifrore që më tej klasifikohen në nivele shtatë shifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.

- Llog.230, “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, të analizuar në llogari shtatë shifrore; dhe

- Llog. 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, të analizuar në llogari shtatë shifrore.”

Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.”

## **PASIVET:**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në datën 31.12.2021, shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, të 436 “Sigurime shoqërore”, është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin”

401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	62,449,493	0
42	Detyrime ndaj personelit	7,439,529	6,975,725
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	448,144	390,050
435	Sigurime Shoqërore	2,215,235	2,044,612
436	Sigurime Shëndetësorë	303,199	283,742

**Llogaria 401-408** “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në çelje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 62,449,493 lekë.

**Llogaria 42** “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në vlerën 7,439,529 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 431** “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat” paraqitet në vlerën kontabël 448,144 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 435** “Sigurime shoqërore” paraqitet në vlerën 2,215,235 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

**Llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqitet për vlerën kontabël 303,119 lekë.

Gjendja e llogarisë 437,438 “Organizma të tjera shtetërore” paraqitet për vlerën kontabël 0 lekë.

#### **-Detyrime të tjera afatshkurtra:**

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.

**Llogaria 466** “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël **46,136,181 lekë** dhe është sipas rakordimit me Degën e Thesarit, shtuar gjatë vitit (21,037,938 + 26,283,567) = 47,321,505 lekë dhe pakësuar në shumën 1,185,324 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën **20,859,786** lekë, për periudhën para vitit 2021 dhe për 48 objekte në vlerë 26,055,773 lekë deri në fund të vitit 2021.

Në këtë rast, për diferencën  $21,037,938 - 20,859,786 = 178,152$  lekë pasqyruar më pak në llogaritë e çeljes të vitit 2021 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. (Më hollësisht analiza e llogarisë 466 sipas **Aneksit 3/4 dhe 3/5 bashkëlidhur RPA.**)

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në vite. Konkretisht në 51 raste për vlerën e ngurtësuar 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, në 9 raste për vlerën 2,780,421 lekë u përkasin ngurtësimeve për vitin 2019 dhe 19 raste për vlerën 6,633,807 lekë u përkasin ngurtësimeve të vitit 2020.

Konstatohet se: Për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

#### **Titulli i gjetjes 15: Mos zhblllokimi i fondeve të ngurtësuar për garanci punimesh**

**Situata:** Nga auditimi i kësaj llogarie për procedurat mbi ngurtësimin e 5% të vlerës së situacionit, u konstatua se në çdo rast të pagesave është ndalur vlera e garancisë. U konstatua se në vitin 2020, vlera e ngurtësuar nga subjekti 2.. K... për shumën 239,803 lekë, është pasaktësi pasi kjo vlerë është ndalur sipas pagesës;

-Me Urdhër Shpenzimin nr. 311 datë 20.07.2020 për subjektin A...SHPK paguar për objektin: “Rikonstruksion i Qendrës së Tërbaçit” U audituan praktikat e tjera si më poshtë vijon vlerat e ngurtësimit janë si në pasqyrën analitike të llogarisë 466:

-Me urdhër shpenzimin nr. 311 datë 20.07.2020 paguar subjekti A... shpk për 4,796,054 - 5% 239,803 = 4,556,251 lekë për “Rikonstruksion i qendrës së Tërbaçit”. Bashkëngjitur është fatura nr. 26 datë 19.06.2020. Kontrata nr. 218, datë 14.10.2019 për vlerën 4,796,340 lekë me TVSH me afat 150 ditë . Akt kolaudimi datë 19.06.2020.

-Me u. shpenzimi nr. 177 datë 7.5.2020, është paguar subjekti K.G.K. me Nipt L.....V Paguar për shumën 1,657,017 lekë - 5% 82851 = 1,547,166 lekë. Paguar për “Mirëmbajtje dhe pastrim i kanaleve vaditëse”. Referuar Kontrata nr. 150 datë 6.05.2019. Fatura nr. 10 datë 20.05.2019 e cila është për vlerën totale 6,930,936 lekë. Certifikatë e marrjes në dorëzim të përkohshëm datë 20.05.2019.

-Me urdhër shpenzimi nr. 179 datë 07.05.2020 është paguar Subjeti M... SHPK për “Rikonstruksion i shkollave KUZ & KUB Stefane Himarë” Paguar për vlerën 9,922,322 - 5% 496,116 = 9,426,206 lekë. Kontrata nr. 109 date 2.04.2019.Fatura nr. 2 datë 11.3.2020 për vlerën 9,922,322 lekë. Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim nr. 109 prot., datë 2.04.2019.

-Me urdhër shpenzimi nr. 184 datë 7.5.2020 është paguar E... SHPK për 1708,275 - 5% 85,414 = 1,622,861 lekë. Për objektin: “Sistemim dhe rrethim i oborrit të shkollës 9 vjeçare Lukovë”. Fatura tatimore nr. 2 datë 6.02.2020. Kontrata nr. 233 datë 6.09.2018. Certifikatë e marrjes së përkohshme të punimeve datë 10.02.2020.

-Me u. shpenzimin nr. 248 datë 18.06.2020 është paguar C... SHPK 1,024,440- 5% 51,222 = 973,218 lekë paguar për “Linja unazore e ujit Potam” Fatura tatimore nr. 24 datë 12.10.2018 për shumën 1,024,44 lekë. Kontrata nr. 177 datë 20.7.2018. Situacioni përfundimtar për vlerën totale 3,288,060 lekë. Sipas aktit të koloadimit afati i punimeve është 30 ditë. Fillimi i punimeve është 20.09.2018. Njoftim përfundim i punimeve është datë 15.10.2018. Kontrata nr. 177 datë 20.07.2018.

-Me u. shpenzimin nr. 249 datë 18.06.2020 është paguar Subjekti C... shpk 9,599,880 - 5% 479.994 = 9,119,886 lekë për mirëmbajtje kanale vaditëse. Fatura tatimore nr. 24 datë 31.05.2020 për shumën 9,599,880 lekë. Kontrata nr. 57 datë 20.5.2020. Situacioni përfundimtar datë 31.05.2020. Kontrata nr. 177 datë 20.07.2018.

**Kriteri:**Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

**Ndikimi:** Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

**Shkaku:**Mangësi në analizimin dhe çlirimin e garancive të fondeve të ngurtësuara ose përdorimin e tyre për interes publik.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi:**Drejtorja e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtorja e Financës, për këto

raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Vlorë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

*Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Z. L..M.., me detyrë Nëpunës Zbatues për periudhën 01.01.2021-31.12.2021.*

#### **4. Llogari të pagueshme**

*Teste thelbësore*

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, konstatohet se në këtë llogari në pasqyrat financiare të për vitin 2021, janë kontabilizuar detyrimet për vlerën totale 74,770,620 lekë.

*Në lekë*

Emërtimi	Çelje 01.01.2021	Shtesa	Pakësime	Gjendje 31.12. 2021
Llogaria 467	75,170,102	64,085,907	64,273,395	74,770,620

Krahasuar me vitin 2020 detyrimet kreditore janë ulur për diferencën (75,170,102 – 399,482) = 74,770,620 lekë Kjo llogari është e analizuara në mënyrë kontabël për 28 subjekte kreditore të gjitha detyrime të lindura në vitin 2020-2021. Më hollësisht si në pasqyrën që vijon:

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**

Nr	Nr.Fature	Data	Emertimi kontrates	Shuma/lekë
	327	07.07.2020	G&L C... SHPK mbikqyrje punimesh KUZ POTAM	40,000
	31	02.10.2020	TED N... Person Fizik	120,000
	124	14.10.2020	M. SHPK	770,400
	116	18.08.2020	FERIT M...Blerje materiale hidraulike	790,962
	02	20.06.2020	K&F C...Mbikqyrje puimesh Rik I Qendres Terbac	11,880
	28	21.12.2020	E. shpk sherbim kolaudimi Ndricimi me llamba led	25,729
			Energj Elektrike	8,925,742
	114	21.12.2021	Rikonstruksioni i ujesjellesit Barmush,	35,371
	64	19.11.2021	Ndertimi i ujesjellesit Pigeras E... S... SHPK	3,288,864
	64	01.11.2021	Permiresimi i sistemit te furnizimit me uje Dhermi GJ... SHPK	15,705,920
	52	17.11.2021	Ndertimi i ujesjellesit Vranisht <b>K..G..K..</b>	26,257,856
	69	29.12.2021	Supervizim ujesjellesi Dhermi H.& S. ..	1,000,000
	326	17.12.2021	Supervizim ujesjellesi Terbac H...&S... ..	200,000
	7	30.09.2021	K&F C...Mbikqyrje punimesh mirembajtje kanale vaditese	119,880
	47	15.11.2021	Pastrimi i zonave turistike K..G...	578,534
	21	18.11.2021	Permiresimi i ndricimit Borsh I. E... SHPK	1,974,600
	439	23.12.2021	Mbikqyrje ujesjellesi Vranisht N...-G.. SHPK	631,958
	33	23.12.2021	Materiale ndertimi S...	1,968,400
	17	03.12.2021	Mirembajtje kanale vaditese K... K...	40,000
	1	13.12.2021	Blerje dru zjarri O... 2...	797,000
	40	09.12.2021	A.-S... Festat e Nentorit	322,000
	43	24.12.2021	A. S... Blerje ndricues dhe dekor qyteti	576,000
	419	31.12.2021	Shtypshkronja e letrave me vlere	43,200
	131-133	29.12.2021	C.... SHPK Blerje makinash	9,960,000
	24	29.12.2021	K.. K... Superv I rrugeve rurale	108,000
	25	30.12.2021	K.K... Superv punimesh ndertim ujesjellesi	395,074
			K.K... kolaudim ujes Terbac	83,250
			<b>TOTALI</b>	<b>74,770,620</b>

Teste substanciale

U audituan pagesat për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, ku u konstatua se disa fatura të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin viti 2020, *nuk janë kontabilizuar si detyrim në kredi të llogarisë 467, në çelje të vitit 2021 për 6 raste në vlerën totale 62,958,572 lekë, konkretisht:*

-Me u. Shpenzimi nr. 58 datë 16.02.2021 është paguar Subjekti S... SHPK shuma 5,611,147 lekë “Rikonstruksion për përshtatjen e godinës së shkollës në Eko-Museum Projekti Co.CO Tuor. Llogaria ekonomike 230. Referuar fatura tatimore nr. 261 datë 31.12.2020.

***Për vlerën 5,611,147 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i mbartur nga viti 2020.***

-Me u. Shpenzimi nr.160 datë 29.03.2021 është paguar Subjekti S... SHPK shuma 9,372,268 lekë “Rikonstruksion për përshtatjen e godinës së shkollës në Eko- Museum Projekti Co.CO Tuor. Llogaria ekonomike 230. Referuar fatura tatimore nr. 158 datë 02.10.2020.

***Për vlerën 9,372,268 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i mbartur nga viti 2020.***

-Me u. Shpenzimin nr. 38, datë 09.02.2021, janë paguar shpenzime për energji elektrike për muajin Dhjetor 2020, referuar aktit të rakordimit me OSHEE Vlorë në muajin Dhjetor 2020 për shumën e paguar 1,229,537 lekë.

***Për vlerën 1,229,537 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i pa paguar nga viti 2020.***

-Me u. Shpenzimin nr. 15 datë 07.01.2021, është paguar B.. & I... shpk për 13,000 lekë vendime gjyqësore urdhër ekzekutimi nr. 841 datë 23.09.2020, protokolluar me nr. 3063 datë 28.09.2020.

***Për vlerën 152,135 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i mbartur në llogarinë 467 në çelje të vitit 2021.***

Për vlerën 46,593,485 lekë si detyrim i prapambetur për objektin “ Ndërtimi i rrugës së fushës së sportit Himarë” kategoria Investim me fondet e veta, kryer para vitit 2015. Është konstatuar se ky detyrim nuk është përcjellë në raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe as nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2021 duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të PF të vitit 2021 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve. Për pasojë është nën vlerësuar llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerë -62,958,572 lekë. Vlerë e cila duhej të paraqitej në shumën 137,729,192 lekë në fund të vitit 2020 dhe 120,364,105 lekë në mbyllje të vitit 2021.

Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2021 për vlerën **-46,593,485** lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimet e MFE **nr. 8**, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3/c.d** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

**Titulli i gjetjes 16:** Mos paraqitje e saktë e detyrimeve të prapambetura

**Situata:** Për vlerën **46,593,485** lekë si detyrim i prapambetur për objektin “ Ndërtimi i rrugës së fushës së sportit Himarë” kategoria Investim me të ardhurat e veta, kryer para vitit 2015. Është konstatuar se ky detyrim nuk është përcjellë në raportimin periodik në MFE dhe as në raportin vjetor të monitorimit. Kjo vlerë e detyrimeve të prapambetura nuk është përfshirë në mbyllje të pasqyrave financiare të viti 2021 dhe as në buxhetin e miratuar të vitit 2021 duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të PF të vitit 2021 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve.

Për pasojë është nën vlerësuar llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerë **-46,593,485** lekë në mbyllje të vitit 2021. Vlerë e cila ka sjelle paraqitje jo të saktë të informacionit kontabël dhe që duhej të paraqitej në shumën **120,364,105** lekë.

**Kriteri:** Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. Pika, 1 e nenit 54 seksioni “Raportimi financiar” i ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ku ka përcaktuar se: Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore publikon treguesit financiarë në një aneks të veçantë të projektbuxhetit vjetor dhe raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe pika 2, paragrafi f) që përcakton llojin detyrimeve financiare të papaguara në kohë ndaj të tretëve ndaj të ardhurave të përgjithshme;

**Ndikimi:** Nën vlerësim i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” ndikon në informacionin kontabël si në saktësi dhe paraqitjen përfundimtare të Pasqyrave Financiare në mbyllje të vitit ushtrimor.

**Shkaku:** Mos parashikimi në buxhetin vjetor të Bashkisë për kryerjen e pagesave të detyrimeve të krijuara në vitet paraardhëse.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë së bashku me Nëpunësin Zbatues të marrin masa menjëherë që në zbatimin e buxhetit të vitit 2023, të hartojë e propozojë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet për sa i përket detyrimeve të prapambetura. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve tu nënshtrohen rregullave të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të ligjit 68/2017. Po ashtu të Nëpunësi Zbatues i kësaj njësie vendore të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022 të sistemojë saktë vlerat e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe në kundërparti në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

## **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”(Kapitali i nënshkruar)në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,721,782,503 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,668,177,580 lekë ose me rritje në vlerën 904,607,695 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” (Humbja/fitimi i ushtrimit)në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 244,248,411 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 381,352,993 lekë ose me rritje në vlerën 137,104,582 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Llogaritë 105 “Teprica e Granteve kapitale të brendshme” dhe 106 “Teprica e Granteve kapitale të huaja”, si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 692,470,689 lekë.

Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Pasqyra e performancës financiare në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Aneksin nr.9** bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.

Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:

- a. Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);
- b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;
  - i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
  - ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*);
  - iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 "Instrumentet Financiare"*);
  - iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.

Pasqyra e performancës tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumatat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre. Sa më sipër është konform standardit.

## **Të Ardhurat**

### **1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:**

Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 264,993,986 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 489,666,719 lekë ose me rritje në vlerën 224,672,733 lekë.

Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën** më poshtë:

Nr.		VITI 2021	VITI 2020
<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>742,789,871</b>	<b>667,128,543</b>
<b>70</b>	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>489,666,719</b>	<b>264,993,986</b>
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>3,409,747</b>	<b>5,551,822</b>
7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	3,409,747	5,551,822
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurinë</b>	<b>27,935,218</b>	<b>20,297,046</b>
7020	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme	27,935,218	20,297,046
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>458,321,755</b>	<b>239,145,118</b>
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	458,321,755	239,145,118
<b>75</b>	<b>II. KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>2,980,879</b>	-
751	NGA PUNEDHENESI	2,980,879	-
<b>71</b>	<b>III. TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>52,750,488</b>	<b>45,468,516</b>
<b>710</b>	<b>1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>1,556,232</b>	<b>3,656,400</b>
7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare	1,556,232	3,656,400
<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>51,194,256</b>	<b>41,812,116</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	47,941,910	37,718,212
7114	Te ardhura nga biletat	3,252,346	-
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		4,093,904
<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>197,391,785</b>	<b>213,139,727</b>
720	1.Grant korent i Brendshëm	197,391,785	213,139,727
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	51,214,389	67,257,001
7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	135,771,289	136,156,370
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	10,406,107	9,726,356



	<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	-	143,526,314
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	-	143,526,314

Sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë të ardhura financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) në shumën **197,391,785** lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo njësi vendore në vlerën 742,789,871 lekë nga të cilat: të ardhura tatimore në vlerën **489,666,719** lekë dhe të ardhura jotatimore në vlerën **52,750,488**lekë. Përfshirja në këtë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhurnuar nga Drejtoria e taksave e tarifave vendore. Gjendja e secilës llogari të të ardhurave rakordon në PF me vlerat e paraqitura në llogarite analitike të aktit të rakordimit me degën e thesarit Vlorë. Në mënyrë analitike të dhënat e të ardhurave paraqiten në (*Aneksin 3/6*) bashkëlidhur Raportit të Auditimit. Totali i të ardhurave në vlerë është 742,789,871 lekë dhe totali shpenzimeve është 361,436,878 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 381,352,993 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

### ➤ **SHPENZIMET**

#### **1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:**

Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 102,741,364 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 117,074,297 lekë ose me rritje në vlerën 14,332,933 lekë.

Llogaria 601 “*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*”, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 17,107,681lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 18,721,173 lekë ose me rritje në vlerën 1,613,492 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Himarë me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqitur në **Pasqyrën e më poshtë:**

LLOGARITË	EMËRTIMI	31.12.2021	31.12.2020
<b>6001</b>	Paga, personel i përhershëm	117,074,297	102,741,364
<b>6010</b>	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	18,721,173	17,107,681
<b>TOTALI</b>		<b>135,795,470</b>	<b>119,849,045</b>

- Zëri “**Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale**” formati 6 e plotësuar për shumën 13,406,934 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

*Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

*Sa më sipër për mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi Z. L..M., me detyrë Nëpunës Zbatues (Drejtor Finance).*

## 2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Në Bashkinë Himarë, u audituar zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore e nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, sipas çështjeve të trajtuara. Nga ana e Autoriteteve Kontraktore (AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së.

Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al. AK kanë përgatitur regjistrin e veprimtarive të prokurimit të kryera, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja.

Për periudhën objekt auditimi (01.06.2021 – 31.12.2021)

- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

- Ndryshimet në regjistrat e prokurimeve

- Shkresat dërguar në APP

- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

- Miratimin nga Thesari.

Realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB, për vitin 2021.

**Për vitin 2021** (01.06.2021 – 31.12.2021): Bashkia Himarë ka zhvilluar gjithsej **18** (tetëmbëdhjetë) procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit **410,266,467** (katërqindë e dhjetë milion e dyqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqindë e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa Tvsh**, vlerë të kontratës **394,085,593** (treqindë e nëntëdhjetë e katër milion e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqindë e nëntëdhjetë e tre) **lekë pa Tvsh**, diferencë midis tyre prej **16,180,874** (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqindë e tetëdhjetë mijë e tetëqindë e shtatëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh**.

Kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 38 (gjithsej) OE dhe BOE janë skualifikuar 5 (pesë) operator ekonomik.

- "Tender i Hapur", 6 (gjashtë) procedura, me fondin limit në total prej **335,142,964** (treqindë e tridhjetë e tre milion e njëqindë e djetë e dy mijë e nëntëqindë e gjashtëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh**, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej **333,704,319** (treqindë e tridhjetë e tre milion e shtatëqindë e katër mijë e treqindë e nëntëmbëdhjetë) **lekë pa Tvsh**, duke kursyer shumën prej **1,438,645** (një milion e katërqindë e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqindë e dyzetë e pesë) **lekë pa Tvsh** ose në masën 0,4% të fondit limit.

- "E hapur e thjeshtuar" 12 procedura, me fondin limit në total prej **75,123,503** (shtatëdhjetë e pesë milion e njëqindë e njëzete e tre mijë e pesëqindë e tre) **lekë pa Tvsh**, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej **60,381,274** (gjashtëdhjetë milion e treqindë e tetëdhjetë e një mijë e dyqindë e shtatëdhjetë e katër) **lekë pa Tvsh**, duke kursyer shumën prej 14,742,229 (katërmëdhjetë milion e shtatëqindë e dyzetë e dy mijë e dyqindë e njëzete e nëntë) **lekë pa Tvsh** ose në masën 19.6 % të fondit limit.

Për periudhën objekt auditimi 01.06.2021 – 31.12.2021 nga subjekti Bashkia Himarë janë zhvilluar gjithsej procedura prokurime me vlera të larta (procedurat e hapura), si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/Lekë	Në % ndaj fondit
<b>Fondet prokuruar gjithsej</b>	343,476,297	
<i>Nga të cilat</i>		
- Në fushën e ndërtimit	335,142,964	97.6%
- Në fushën e shërbimeve/blerjeve	8,333,333	2.4%

Financime nga Bashkia/Grande	275,443,055 AKUMI Grande 68,033,242 Bashkia të vetat	80 % AKUM 20% Bashkia
Financim nga FZHR	S'ka	
Financim me grande specifike	-	

### Procedurat e audituara janë:

1. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Rikonstruksion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë, Bashkia Himarë”, me vlerë të fondit limit 6,666,663lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate, 6,285,550 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 381,113 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “A..A..C” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 1 (një) OE.
2. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me objekt: “Mirëmbajtje shkollash”, me vlerë të fondit limit 8,329,878lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate, 7,034,633 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 1,295,245 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “J..” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 3 (tre) OE/BOE.
3. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur”, me objekt: “Ujësjiellësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”, me vlerë të fondit limit 35,231,372 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate, 33,441,800 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 1,789,572 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “A..A..C” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 2 (dy) OE.
4. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur”, me objekt: “Rikonstruksioni i ujësjiellësit Piqeras”, me vlerë të fondit limit 75,765,820lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate, 72,556,615 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 3,209,205 lekë pa Tvsh, dhe fitues BOE “E.S.” & “D... C..” & “B... B...” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 2 (dy) OE/BOE.
5. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur”, me objekt: “Rikonstruksioni i ujësjiellësit Piqeras”, me vlerë të fondit limit 22,200,095 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate 21,970,868,50 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 229,226.50 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “L...” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 1 (një) OE.
6. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me objekt: “Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje lerash”, me vlerë të fondit limit 5,831,946 lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate,4,967,800 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 864,146 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “A..A..C” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 1 (një) OE.
7. - Është audituar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, me vlerë të fondit limit 5,799,700lekë pa Tvsh, dhe vlerë kontrate, 4,967,800 lekë pa Tvsh, ose më pak se vlera ekonomike e prokuruar 119,061 lekë pa Tvsh, dhe fitues OE “L..” Shpk. Në prokurim ka marrë pjesë 1 (një) OE.

	Objekt prokurimi	OE Fitues	Kontrata	
			Nr/ datë	pa Tvsh
	<b>Viti 2021</b>			
1	Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç	“L...” Shpk	474;16.11.21	5,799,700
2	Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës së lumit Borsh	BOE “K..I.”	460;15.12.21	9,257,221
3	<b>Rikonstruksion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë</b>	“A..A..C” Shpk	385;08.11.21	6,285,550
4	Mirëmbajtje rrugë rurale	“A..A..C” Shpk	461; 15.12.21	7,398,385
5	Servisi i automjeteve të PMNZSH dhe automjeteve të Bashkisë	“M../S..” Shpk	471;21.12.21	1,666,667
6	Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural	“J..-K...” Shpk	473;21.12.21	1,826,270
7	Supervizim Rikonstruksioni i ujësjiellësit Piqeras	BOE “A...-S..”	392; 17.11.21	1,402,217
8	Mbikqyrje Ndërtimi i ujësjiellësit Vranisht	“G...B...C..E....g”	333;15.10.21	2,289,703

**I:“Rikonstrukcion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë”, Bashkia Himarë.**

<b>1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë”, Bashkia Himarë viti 2021</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 59 datë 18.09.2020	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. O..V.. 2. A..G.. 3. U..D..	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 60, datë 22.09.2021:</b> 1. K..K.. (Kryetar) 2. A..B.. (Anëtare) 3. E..M.. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 6,666,663lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “A..A..C” Shpk, vlera e ofertës, 6,285,550 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 381,113 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 06.10.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i bashkisë (të ardhurat + transferata e pakushtëzuar)	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> OE “A..A..C” Shpk
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,Nuk ka</b>
<b>b. Kontrata 385 prot., datë 08.11.2021</b>		
<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>7,542,660</b>	

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 59 e nr. 269 Prot., datë 22.09.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D...

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 60 e nr. 279 Prot., datë 22.09.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A.B.(Kryetar); z. E..M.. (Anëtar) e z. K.K. (Anëtar).

**Hartimi fondit limit:** Projekt zbatimi, grafiku i punimeve, project preventive dhe përlllogaritja e fondit limit është realizuar, nga Ing. S..K.. dhe ing. Topograf E..M., miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. J.G.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me nr. 271 prot., datë 22.09.2021, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT.

Duke ju referuar buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021 për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së Institucionit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 66, datë 21.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021” fond limit **6,666,663 (tetë milion e treqindë e njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë)lekë pa Tvsh**për objektin: “Rikonstrukcion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë”, Bashkia Himarë.

Me Procesverbalin nr. 272 prot., datë 22.09.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP.

**Ndryshime në DT: Shtojca 7, datë 05.10.2021 në SPE.**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 28.09.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstrukcioni pjesor i shkollës 9-vjeçare Himarë”, me fond limit 6,666,663 lekë pa Tvsh, autoritetit kontraktor **Bashkia Himarë në lidhje me procedurën me REF-06106-09-22-2021, në lidhje me disa konstatime në DT.**

**Titulli i gjetjes 17:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

## **Situata: Hartimi i kriterëve:**

**1. Në Pikën 2.3.2/1,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008: “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

*NP-1A, NP-2A, NP-3A.*

*NS-4A, NS-6A, NS-7A, NS-8A, NS-18A, NS-19A”.*

Kërkesa për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahen përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Vendosja e tyre kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, e nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në Pikën 2.3.3,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve për periudhën; e tre mujorit të fundit, të jetë jo më pak se 30 punonjës.*

*a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën tre mujorit të fundit.*

*b) Listepagesat dhe mandat pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhë tre mujorit të fundit”.*

**3. Në Pikën 2.3.5,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje (për stafin të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj) sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës; dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën e mësipërme.*

*- Inxhinier Ndërtimi (me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) 1 (një)*

*- Inxhinjer Arkitekt (i paisur me Licencë Restaurues) 1 (një)*

*- Inxhinjer Elektrik 1 (një)*

*- Inxhinjer Gjeoded (topografë) - 1 (një)*

*- Inxhinjer Hidro - 1 (një)*

*- Inxhinjer Mjedisi (Ing. mjedisi profil energjetik) 1 (një)*

*- Agranom (me licencë nga MT) dhe QKL 1 (një)”.*

Kriterit për inxhinierët dhe agranom, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**4. Në Pikën 2.3.6, të Kapacitetit Teknik,** në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se në listpagesat e periudhës e tremujorit të fundit të rezultojnë të punësuar personel teknik, të kualifikuar nga subjektet e licencuara për certifikimin e tyre si dhe të jenë të pajisur me kartela sigurie në punë të vlefshme i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:*

*- Punëtori e specializuar Karpetier (me certifikatë) 2 (dy)*

*- Punëtori e specializuar hidraulik (me certifikatë) 2 (dy)*

*- Inxhinier (Me certifikat “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) 1 (një)*

*- Inxhinier (Me certifikat “Specialist ndërtimi) 1 (një)*

*- Punëtori e specializuar me makineri, (manovratorë me certifikatë) 4 (katër)*

*- Mjek 1 (një)”.*

Kërkesat për fuqinë punëtore (dhe inxhinierët e përfshirë) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat e pikave 4 e 5 nuk janë në përputhje me:

*- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”*

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”.

Në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Sigurimi i shërbimit mjekësor ligjërisht lejohet

**5. Në Pikën 2.3.6,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një **Inxhinier** që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, të shoqëruar me **kontratë pune noteriale të vlefshme. Libre të pune, Diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë**”.*

Kërkesa për *Inxhinier me certifikimin “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune”,* kërkuar në Pikën 2.3. 6 të Kapacitetit Teknik, është e tepërt pasi do të mjaftonte punonjësi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, referuar përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**6. Në Pikën 2.3.7,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimin me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:*

*b. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi apo me qera një ambient për prodhimin e inerteve, parafabrikate, granil dhe të garantojnë furnizimin me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit si dhe të jetë i pajisur me licencë QKL Kodi IV.1.B.2.*

*c. Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje, e mbetjeve urbane”.*

*d. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 si dhe një nyje të prodhimit të inerteve të paisur me QKL Kodi IV.1.B.2”.*

OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit/materialit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatave të cilësisë, mund t’i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Kriteri për disponimin e licencë të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomikë të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve nuk nevojitet kërkesa e sipërcituar.

**7. Në Pikën 2.3.8,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik të ketë një **agranom** si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të jetë i paisur me licencë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës dhe të jetë në listpagesë për periudhën e mësipërme (kjo e vërtetuar me anë të listpagesave të shoqërisë)”.*

Kërkesa për “**agranom** si drejtues teknik në licencë...” kërkuar në Pikën 2.3.89 të Kapacitetit Teknik, është e tepërt, referuar përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**8. Në Pikën 2.3.9,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Një prej Inxhinierëve të Mjedisit të jet i paisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin të ndikimit në mjedis dhe i pajisur me licencë QKL III.2.A “Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. (Auditim mjedisor. Ndikim në mjedis),*

për të siguruar auditimin mjedisor gjatë procesit të zbatimit kontratës, për hartim ekspertize për probleme mjedisore, ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të jetë në listpagesat e shoqërisë”.

Kërkesa për Ing. Mjedisi, është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77 të LPP, që “...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, si dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**9.Në Pikën 2.3.10,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Një nga drejtuesit teknik të mësipërm të jetë auditues energjie të pajisur me certifikatë për auditues energjie në proçese për auditimin e pajisjeve të punës;

*Deklaratë nga administratori i shoqërisë që drejtuesat teknik të shoqërisë/shoqërive pjesëmarrëse në tender nuk janë të punësuar në asnjë institucion publik apo SHA, deklarimi i rremë përbën vepër për penalizim konform parashikimeve të nenit 13 të LPP”.*

Kërkesa për Auditues Energjie, referur komponentët në lidhje me efincencën e energjisë janë ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77 të LPP, që: “Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, si dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**10. Në Pikën 2.3.11,**të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqes dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

**Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:**

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion mbi 18 m3	<b>3 copë</b>	Pronësi ose me qera
Kamionçinë deri në 7.5 ton	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Auto Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Eskavator me kovë 0.25 m <sup>3</sup>	<b>3 copë</b>	Pronësi ose me qera
Vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Fadroma	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Depozitë uji deri në 500 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë uji	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi per ngjitje tub plastik kokë më kokë	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	100 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	<b>2 copë</b>	Pronësi ose me qera

Mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen, mjetet e kërkuara (në sasinë dhe llojin e kërkuar), janë të tepërta. Konstatohet gjithashtu që kërkohet “Aparat saldimi per ngjitje tub plastik kokë më kokë”, kur në preventiv nuk ka zë ”FV tubo plastike”.

**11. Në Pikën 2.3.13** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar “Operatori, duhet të ketë :

- Çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën **45001 2018 Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- *Çertifikatën 99 2012 Sistem i Integruar i Menaxhimit të Kompanisë lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

- *Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik secili operator duhet t'i disponojë çertifikatat e mësipërme ISO.*

- *Rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt Bashkisë Himarë si: gjoha, debi të ndryshme, moszbatim në kohe dhe sipas kushteve përkatëse të kontratave të mëparshme, të dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, do të përbëjnë kusht për s'kualifikim të operatorit/operatorëve ekonomik përkatës”.*

Vendosja e kërkesës, së mësipërme nuk përmbush përcaktimet pikës 3 të nenit 44 nëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet që “*Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.*

Përcaktimin se “*në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatat ISO*”, referuar sipas nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, **sipas zërave të punimeve/shërbimeve/ mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.**

Detyrimet kundrejt Bashkisë Himarë, nuk mund të jetë kusht për skualifikimin e OE në një procedurë prokurimi, në zbatim të Pikës 1, neni 108, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet: “*Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 78, të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratësapo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë”.*

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A..G., z. O..V. e z. U..D...**

**Ndikimi:** Kufizimi ipjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikimet teknike; të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**- Zhvillimi i procedurës.**

Me nr. 336/1 Prot., datë 15.10.2021 Procesverbali për hapjes së procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë 1 (një) OE me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1.OE “ASI-2A” Shpk(me NIPT: K.....C), me ofertë ekonomike në vlerën 6,285,550 (gjashtë milionë e dyqindë e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqindë e psëmbëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh.**

- Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit, me nr. 336/3 prot., datë 15.10.2021 formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP dhe KVO-së.

*Njësia e Prokurimit i ka formuluar/nënshkrar kur është hapur procedura.*

- Procesverbali i KVO me nr. 336/2 prot., datë 15.10.2021 “Për vlerësimin e dokumentacionit të OE **pjesëmarrës**, nga ku ka rezultuar se është pjesëmarrës 1 (një) OE dhe kualifikuar.

- Raporti përmbledhës me nr. 337 prot., datë 15.10.2021, miratuar nga Titullarit i AK.

- Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 338 prot., datë 15.10.2021.



**Lidhur me OE të shpallur fitues “A..A..C” Shpk**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Titulli i gjetjes 18:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** -Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “A..A..C” Shpk dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në zbatim të: Neni 2 “Qëllimi”, pika 1, gërma “c”, neni 3 “Parime të përgjithshme” pika 1, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 1, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 5, neni 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” pika 3, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi i ligjit”.

**OE “A..A..C” Shpk, ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur në SPE.**

**I. Pikë 2.2/1** “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar”.

1. Bilanci i vitit 2018, është deklaruar online më datë 28.03.2019, me nr. 4747 prot., datë 04.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E...&..V... S...” Shpk.

2. Bilanci i vitit 2019, është deklaruar online më datë 21.04.2020, me nr. 4245 prot., datë 23.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E...&..V ..S...” Shpk.

Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L...F... më Korrik 2020

2. Bilanci i vitit 2020, është deklaruar online më datë 14.04.2020, ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E&V S.” Shpk, të njehsuara në sistemin tatimor C&TS më datë 14.04.2021. Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L. F. më Korrik më datë 19.05.2021.

**Pika 2.2/3** “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar)”;

1. Vërtetim me nr. 13 prot., datë 02.09.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier, për vitin 2020.

2. Vërtetim me nr. 156 prot., datë 28.10.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kavajë, për vitin 2020.

**Gjatë vitit 2020 OE “A..A..C” Shpk, ka ushtruar aktivitet edhe në NjQV por nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore:**

1. Bashkia Kolonjë, Bashkia Durrës; Bashkia Vlorë: Bashkia Peqin: Bashkia Mallakastër: Bashkia Selenicë.

**II. Pikës 2.3.11 të DT:**

1. Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa MK....A, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 deri më datë 13.05.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 “Kontratë qiraje automjete” e lidhur ndërmjet OE “S..0..” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk.

Për mjetin “Kamion”; Targa MK4439A; Marka Volvo; Tip FM12; Shasia YV2J4DPG22A539290; Viti i prodhimit 2001.

Cetrifikatë me nr. 17, datë 01.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Mallkastër për mjetin Volvo me targë MK4439A për OE “S... 0...” Shpk. Kapaciteti 20 ton (32,000 -12,000).

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Certifikata e transportit për mjetin Volvo me targë MK4439A është për OE “S... 0...” Shpk.

Mjetit i mungon; Leje transporti dhe Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse.

**2.** Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa AA430KP, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 210 Rep., nr. 91 Kol., datë 19.01.2021, deri më datë 19.01.2028

Në SPE është paraqitur me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Kontratë qiraje automjesh” e lidhur ndërmjet Jorgen Dashi dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA430KP; Marka Iveco Fiat; Tip 410E42; Shasia EJM4CS800C081046; Viti i prodhimit 2000. Me kapacitet **24.15 ton** (40,000-15,850)

Cetrifikatë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Licencë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

**b.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA023IY; Marka Iveco Fiat; Tip 354C13A; Shasia ZCFC3591005466506; Viti i prodhimit 2004. Kapaciteti **1.025 ton** (3,500 -2,475).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash.

Çertifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore kanë përfunduar më datë 21.05.2021.

**3.** Për Kamionçinë 1.5-2 ton, me Targa FR1814D, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 2410 Rep., nr. 1424 Kol., datë 20.07.2017, deri më datë 20.07.2022.

Në SPE është paraqitur me nr. 2410 Rep., e nr. 1424 Kol., datë 31.07.2017 “Kontratë qiraje mjesh” e lidhur ndërmjet Rrapi Shehu dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA448CF; Marka Man; Tip 412069/FAK; Shasia 41206960696; Viti i prodhimit 1981. **3.7 ton** (11,000-7,300).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Çertifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore. Nuk ka Foto të mjetit.

**b.** Për mjetin “Kamion”; Targa FR1814D; Marka Mercedes Benz; Tip 611318/408D; Shasia EDB61113181P031654; Viti i prodhimit 1990. **1.15 ton** (3,500-2,350).

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Taksat vjetore. Nuk ka Foto të mjetit.

**4.** Për Fadrom me Goma; JVC MOD 406, dhe Cekic Pnematik H 608 S/N Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1712 Rep., nr 723 Kol., datë 14.05.2015, deri më datë 13.05.2025.

Në SPE është paraqitur me nr. 1712 Rep., e nr. 723 Kol., datë 14.10.2016 “Kontratë qiraje automjete” e lidhur ndërmjet OE “R...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Skrep i përdorur me zinxhirë”, Marka Caterpillar, Tip 951C; Shasia 96H564, Viti i prodhimit 1976. Vërtetim zhdoganimi datë 20.12.2006. Deklarata doganore nr. 9480, datë 18.12.2006.

**b.** Për mjetin “Fadrom i përdorur me zinxhirë”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1703, datë 30.10.2009.

**c.** Për mjetin “Çekiç pnematik i përdorur për riparim (pjesë sonde)”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1630, datë 26.11.2007.

**d.** Për mjetin me “Fadromë me goma” Model JVC Mod. 406; Shasia 632321, Viti i prodhimit 1989. Deklarata doganore nr. R 4966, datë 12.05.2009.

**e.** Për mjetin me “Kamion i përdorur për mallra” Marka Volvo; Tipi F89; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton. Deklarata doganore nr. R8523, datë 20.12.2006.

Kohëzgjatja e kontratës është deri më datë 14.10.2021.

-Vërtetim zhdoganimi për mjetin “Skrep-Caterpillar” më datë 20.12.2006.

- Deklarata doganore për kamionin Volvo- Vërtetim zhdoganimi 19.12.2006

**5.** Për Mini Fadromë Bobcat AEMT20, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1808 Rep., nr 769 Kol., datë 23.06.2018, deri më datë 23.06.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1808 Rep., e nr. 769 Kol., datë 23.06.20218 “Kontratë qiraj e mjeti” e lidhur ndërmjet OE “R.&G.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

**a.** Për mjetin “MT”; Bobcat; Tip-S300; Shasia 531116185; Viti i prodhimit 2007; targa AEMT20.

**6.** Për Autobetoniere, me Targë AA793BV, Kontratën e Qerasë (noterisë) me nr 1216 Rep., nr 691 Kol., datë 14.04.2018, deri më datë 13.04.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1216 Rep., e nr. 691 Kol., datë 18.04.2018 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet OE “F. F.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa AA793BV, Marka MAN, Tip 33-372; Shasia EMAF099059M156682, Viti i prodhimit 1993.

**Mungon:** Certifika e pronësisë së mjetit; Certifikatën e transportit; Leja e transporti; Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse; Taksa e vjetore të mjetit dhe fotot (24,000-11,700).

**7.** Me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Prokurë e posaçme” e lidhur ndërmjet OE “A...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

1. Për mjetin “Autobot”; Targa AA203EZ; Marka Mercedes Benz; Tip 813D; Shasia 31805114159565; Viti i prodhimit 1986. 24 ton (7,490-4,660)

**8. Eskavator me Goma** LU 9705 B Nr 4115 Rep Nr 2413 Kol 04.12.2017 03.12.2022

Në SPE është paraqitur me nr. 4115 Rep., e nr. 2413 Kol., datë 04.12.2017 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet PF N...L... dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa LU9705B, Marka JCB, Tip 3CX97TP; Shasia 0475423, Viti i prodhimit 1998. Është paraqitur vetëm leja e qarkullimit nr. LU0004150.

**9.** Me nr. 4005 Rep., e nr. 2346 Kol., datë 14.10.2017 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet PF K. C.dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

1. Për mjetin “APV”; Targa AA147RB; Marka Astra; Tip BM21F/BM21; Shasia 41623; Viti i prodhimit 1977. Leje qarkullimi me nr. VL.....6.

Siguracioni ka përfunduar më datë 07.06.2021. Kontrolli Teknik ka përfunduar më datë 25.06.2021. Certifikata e Kontrollit Teknik (tahografit) ka përfunduar më datë 09.06.2021.

2. Për mjetin “Kamion”; Targa AA672IV; Marka Iveco Fiat; Tip A1HC/135-17; Shasia VF5A1HC0001105334; Viti i prodhimit 1985. **8 ton** (13,300-5,300).

Cetrtifikatë me nr. 108, datë 12.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Vlorë për mjetin Iveco Fiat me targë AA672IV + Foto.

**Foto e mjetit** “Kamion Iveco” me targë AA672IV.

**Foto e mjetit-auto vinç- ASTRA me targë AA147RB - (vetëm foto).**

**10.** Me nr. 289 Rep., e nr. 126 Kol., datë 26.01.2021 “Kontratë qiraje – Pasuri të luajtshme” e lidhur ndërmjet PF I... F...dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

1. Për mjetin “Kamion” Marka Volvo; Tipi FL6; Viti i prodhimit 2009; Shasia YV2TN12A59B548691; Kapaciteti 12 ton.

2. Për mjetin “Eskavator Bobcat” Tipi 341; Seria 14208; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

3.Për mjetin me “Minieskavator” Marka Janmar; Tipi B22-2; Shasia 31055B. Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

Cetrtifikatë me nr. 066, datë 09.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Fier për mjetin Volvo FL6 me targë AB310CA për “A..A..C” Shpk **Foto nuk ka.**

**Në këto kushte ky OE** nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari i AK nuk duhet të ishte miratuar procedura.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO **z.A.B., z. E.M. e z. K.K.**

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **6,285,550 lekë** pa Tvsh.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues **OE “A.A.C” Shpk**, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **7,542,660 lekë me TVSH**.

**Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 385 prot., datë 08.11.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B... B.. dhe Operatorit Ekonomik **OE “A.A.C” Shpk** me përfaqësues ligjor z. A.G., me objekt: “Rikonstruksion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **7,542,660 (shtatë milion e pesëqind e dyzetë e dy mijë e gjashtë qind e gjashtëdhjetë)lekë me Tvsh**.

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “A.A.C” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **6,285,550 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët **NJHDT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.dhe KVO: z.A.B. , z. .M.. e z. K.K.**

## **II.“Mirëmbajtje shkollash”, Bashkia Himarë.**

<b>2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje shkollash”, Bashkia Himarë, viti 2021</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 36 datë 06.08.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A..G.. (Ing. Ndërtimi) 2. O..V.. (Jurist) 3. U..D.. (Financier)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 40, datë 06.08.2021:</b> 1. A..B.. (Kryetar) 2. K..K.. (Anëtare) 3. E..M.. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 8,329,878lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “J..” Shpk, vlera e ofertës7,034,633 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,295,245 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 07.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “J..” Shpk 2. OE “A..A.C” Shpk 3.OE “E.. – VL” Shpk
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</b>
<b>b. Kontrata nr. 278 prot., datë 27.09.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 27.09.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>8,441,559.60</b>

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 36 e nr. 185 Prot., datë 06.08.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 40 e nr. 189 Prot., datë 06.08.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A.B. (Kryetar); z. E.M. (Anëtar) e z. K.K.(Anëtar).

**Hartimi fondit limit:**

Detyra e projektimit është është realizuar nga Ing. E. T. dhe ing. K..K., miratuar me nr. 2703 prot., datë 05.07.2021 nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. J.G.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit e dokumenteve të tenderit nr. 191 prot., datë 10.08.2021, nga anëtarët e NJP. Duke ju referuar buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021 për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së Institucionit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 66, datë 21.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021” fond limit **8,329,878** (tetë milion e treqindë e njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) **lekë pa Tvsh** për objektin: “Mirëmbajtje shkollash”, Bashkia Himarë.

Procesverbali nr. 192 prot., datë 10.08.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike”, është i paraqitur në SEP të APP-së.

### **Ndryshime në DT: Shtojca 7, datë 31.08.2021 në SPE.**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 17.08.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “*Mirëmbajtje Shkollash*”, me fond limit **8,329,878.00 lekë pa Tvsh**, autoritetit kontraktor **Bashkia Himarë në lidhje me procedurën me REF-02560-08-10-2021**, në lidhje me disa konstatime në DT.

### **Titulli i gjetjes 19: Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.**

AK në hartimin e DT, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata:**

**1. Në Pikën 2.3.2** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar kërkuar: “*Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:*

*N.P. 2- Klasifikimi - A*

*NP. 12 – Klasifikimi - A*

*Dhe*

*N.S.1 – Klasifikimi - A*

*N.S. 6- Klasifikimi - A*

*NS.7 – Klasifikimi - A*

*N.S.18- Klasifikimi - A*

*N.S.19- Klasifikimi – A*

Kërkesa për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahen përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Vendosja e tyre kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertes të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, e nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në Pikën 2.3.4** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm për zbatimin e kontratës. Një punësim mesatar prej 40 punëtorësh për periudhën Qershor 2020 deri Maj 2021 të vërtetuar me:*

*Vërtetim të lëshuar nga administrate tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Qershor 2020 deri Maj 2021.*

*Listpagesat sipas formatit të Formularëve E-SIG shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore së bashku me faturat përkatëse”.*

Lidhur me kriterin që ofertesit duhet të disponojnë një numër relativisht të lartë punonjësish, **prej 40** punonjës, nuk është i justifikuar sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit

39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që *çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës*, si edhe nenit 78, që *kriteret duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërish*. Marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet, volumet e punimeve, mjetete makineritë dhe kohëzgjatëje e realizimit të kontratës.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”.

**3. Në Pikën 2.3.5 të Kapacitetit Teknik**, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në licensën e shoqërisë:*

- *1 (një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontratë noteriale, me eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet, i cili të disponojë licencë individuale në zbatim dhe në projektim.*
- *1 (një) Inxhinier Elektrik*
- *1 (një) Inxhinier Mekanik*
- *1 (një) Inxhinier Topograf*
- *1 (një) Inxhinier Gjeolog*
- *1 (një) Inxhinier Mjedisi*

*Për secilin Inxhinier të listuar më sipër, të paraqitet diplomë, kontratë noteriale pune, cv, librezë pune. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.3, janë të pa angazhuar në kontrata të tjera. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.*

*Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit:*

- *Restaurator 1 (nje)*

*i paisur me licencë personale restaurimi për kategorieëAZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 i cili të jetë në listpagesat e shoqërisë në gjithë periudhën e përshkruar më lart (tre mujore).*

- *Arkitekt 1 (një) të jetë në listpagesat e shoqërisë në gjithë periudhën e përshkruar më lart (tre mujore)*”.

Kërkesat për inxhinierët e përfshirë i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat e pikave 4 e 5 nuk janë në përputhje me:

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*”

*Po këtu: “Të ketë në listpagesa ose të kontraktuar:*

- *1 inxhinier Ekspert për dhënie e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave të vërtetuar me dokumenta, Kontratë Pune, Diplomë, dhe të jetë në listpagesa për periudhën e kërkuar (tre mujore).*

- *1 inxhinier Kordinator për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë një nga drejtuesit teknike të shoqërisë dhe duhet të jetë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar (tre mujore).*

- *1 inxhinier i certifikuar për punimet në lartësi, i cili të jetë një nga drejtuesit teknik të shoqërisë dhe duhet të jetë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar (tre mujore).*

- *një inxhinier mjedisi vlerësues i ndikimit në mjedis i cili të jetë në listpagesa të paktën tre muajt e fundit*”.

Kërkesa për *Inxhinier me certifikimin “, janë të tepërta pasi do të mjaftonte punonjësi përgjegjës për dhënie e ndihmës së parë përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.*

**4. Në Pikën 2.3.6/7 të Kapacitetit Teknik**, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar të paktën:*

- *Inxhinjerë të stafit 3 (tre) me kategori V*

*Punonjësit e certifikuar duhet të kenë eksperiencë me kompaninë, të rezultojnë në listpagesat e-sig për një periudhë minimumi 3-mujore dhe të shoqërohen me kontratë pune*”.

Kërkesa nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**5. Në Pikën 2.3.7 të Kapacitetit Teknik,** në DT është kërkuar: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek ndërmarrjeje të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e Kontratës së Punës së mjekut, diplomën, licencën e ushtrimit të profesionit dhe CV. dhe të jetë në listpagesa për periudhën e kërkuar”.*

Në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Sigurimi i shërbimit mjekësor ligjërisht lejohet.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A..G., z. O..V. e z. U..D...**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me nr. 224 prot., datë 07.09.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë me vlerë ekonomike e të ofruar:

**1. OE “J..” Shpk** (me NIPT:J...K).Oferta, me vlerë ekonomiketë ofertës **7,034,633** (shtatë milion e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “A..A..C” Shpk** (me NIPT: K.....C).Oferta, me vlerë ekonomiketë ofertës**7,176,918** (shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) **lekë pa Tvsh.**

**3. OE “E... – V..” Shpk** (me NIPT: K.....Ë). Oferta, me vlerë ekonomiketë ofertës **0 (zero) lekë.** Në dosjen e procedurës së prokurimi gjenden me nr. 225 prot., datë 07.09.2021 “Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes”, formular/nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe dhe KVO.

Procesverbali i KVO me nr. 226 prot., datë 07.09.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar OE, dhe është shpallur oferta e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT, paraqitur nga OE “J..I” Shpk.

**Raporti Përfundimtar** me nr. 227 prot., datë 07.09.2021, miratuar nga përfaqësuesi i Titullarit të AK znj. B.B.

Formulari i Njoftimit të kontratës së nënshkruar me nr. 278 prot., datë 27.09.2021.

**Lidhur me OE të shpallur fitues “J..” Shpk,** pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Titulli i gjetjes 20:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “J...” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** -Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “J...” Shpk. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “J...” Shpk dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në zbatim të: Nenit 2 “Qëllimi”, pika 1, gërma “c”, neni 3 “Parime të përgjithshme” pika 1, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 1, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 5, neni 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” pika 3, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi i ligjit”.

**OE “J...” Shpk, ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur në SPE.**

Operatori Ekonomik “J...” Shpk plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2020:

- Vërtetim me nr. 2918 prot., datë 23.06.2020 që ka shlyer detyrimet në Bashkinë Roskovec.

- Vërtetim datë 21.05.2020 që ka shlyer detyrimet në Bashkinë Fier.

- Vërtetim me nr. 114 prot., datë 24.03.2021 që ka shlyer detyrimet në Bashkinë Fier.

Faturën nr. 85, datë 29.07.2021, nga Bashkia Selenicë për detyrimin në vlerën 42,500 lekë, bashkangjitur fatura bankare për pagesën në Degën e Thesarit Vlorë për detyrimin.

Nga auditimi i trasaksionet në Thesar që OE J...” Shpk ka kryer gjatë vitit 2020 konstatohet që ka kryer veprimtari në Bashkitë: Tiranë, Kavajë, Lushnje, Vlorë, Himarë e Këlcyrë, nga të cilat nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve dhe taksave dhe tarifave vendore.

**Mjete me qera:**

- Autobot me targa AA302GH, me Leje qarkullimi FRF0350118, Nr. Shasie EDB6690021P020310, Me kontratë qeraje nr. 734 Rep., nr. 297/2 kol., datë 19.05.2018 pa afat.

- Kamiocinë me Targa AA102FJ. Leje qarkullimi FRD0426320; Nr. Shasie EDB6760121K092639. Me kontratë qeraje nr. 1430 Rep., nr. 6524 kol., datë 08.10.2020 deri më datë 07.10.2023.

- Fadromë me goma me targa AEMT211; me Leje qarkullimi FRD0975818; Nr. Shasie 2013369. Me kontratë qeraje nr. 2815 Rep., nr. 1090 kol., datë 15.12.2018. pa afat.

- Kamioçinë me targa AA663VN; me Leje qarkullimi FRD1106818; Nr. Shasie EFOFXTTAU67265. Me kontratë qeraje nr. 311 Rep., nr. 99 kol., datë 06.02.2019 deri më datë 05.02.2022/

- Gjenerator Me kontratë qeraje nr. 1888 Rep., nr. 541 kol., datë 10.07.2018

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. A.B., z. E.M. e z. K.K.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **7,034,633 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues OE “J...” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **8,441,559.60lekë me TVSH.**



### Lidhja e kontratës:

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 380 prot., datë 05.11.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B...B... dhe Operatorit Ekonomik OE “J...” Shpk me përfaqësues ligjor z. I. P., me objekt: “Mirëmbajtje shkollash”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **8,441,559.60 (dyzetë milionë e njëqindë e tridhjetë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë) lekë me Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kritereve, ku evidentohet kritere jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “J...” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **7,034,633 lekë pa Tvsh**, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët NJHDT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D.. dhe KVO: z.A..B., z. E..M.. e z. K..K....

### III. “Ujësjellësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”, Bashkia Himarë.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ujësjellësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”, Bashkia Himarë, viti 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 44 datë 18.08.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A..G.. (Ing. Ndërtimi)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-</b> Urdhër nr.45, datë 16.08.2021:
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”	2. O..V.. (Jurist)	1. A..B.. (Kryetar)
	3. U..D.. (Financier)	2. K..K.. (Anëtar)
		3. E..M.. (Anëtar)
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 35,231,372lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “A..A..C” Shpk, vlera e ofertës, 33,441,800 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,789,572 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 08.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> AKUM	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “A..A..C” Shpk 2. OE “2... K...” shpk
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</b>
<b>b. Kontrata nr. 321 prot., datë 12.10.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 12.10.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>40,130,160</b>

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 44 e nr. 203 Prot., datë 16.08.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondit limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 45 e nr. 204 Prot., datë 16.08.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A..B.. (Kryetar); z. E..M.. (Anëtar) e z. K..K.. (Anëtar).

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është realizuar nga Ing. K..K.. me licencë N. 6594/2 dhe Ing. Topograf J... G... me licencë TZ0687. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Përlllogaritja e vlerës së fondit limit në procedurën e prokurimit nuk është argumentuar dhe dokumentuar** sipas përcaktimeve të nenit 76, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kritereve nr. 206 prot., datë 16.08.2021, nga anëtarët e NJP. Duke ju referuar buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021 për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në

fushën e veprimtarisë së Institucionit, miratuar me fondet buxhetore të transferuara 2020-2022, për programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, në bazë të shkresës nr. 769 Prot., datë 12.04.2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjetillës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, me fond limit **35,231,372 (tridhjetë e pesë milionë e dyqindë e tridhjetë e një mijë e treqindë e shtatëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh** për “Ujësjetillësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”, Bashkia Himarë.

Procesverbali me nr. 207 Prot., datë 16.08.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike”.

- Me nr. 205 prot., datë 16.08.2021, Noftimi i shkurtuar i kontratës.

### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 24.08.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Ujësjetillësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”, me fond limit **35,231,372 lekë pa TVSH**, autoritetit kontraktor **Bashkia Himare, në lidhje me procedurën** me REF-02989-08-16-2021, në lidhje me disa konstatime në DT.

**Titulli i gjetjes 21:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e DT nuk ka formuluar Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.**

### **Situata: Hartimi i kriterëve:**

**1. Në Pikën 4**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Maj 2021– Korrik 2021** stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) inxhinierë Ndërtimi
- 2 (dy) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidër/Gjeomatik.
- 2 (dy) inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) inxhinier Mjedisi (Profili energjistik)
- 2 (dy) inxhinier Gjeolog
- 2 (dy) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinierë Mekanik

Kërkesa përdrejtues teknik në licencën e shoqërisë **Inxhinier Mjedisi, inxhinier Mjedisi (Profili energjistik), Inxhinier Gjeolog dhe Inxhinier Elektrik**, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërcituar. Referuar tipologjisë dhe volumit të punimeve është e tepërt kërkesa për dy inxhiniera (Topograf/Gjeodet/Markshaidër/Gjeomatik; Hidroteknik; Mjedisi; Gjeolog e Elektrik).

Kriteret për inxhinierët (pesëmbëdhjetë), nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**2. Në Pikën 5**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Krahas stafit të mësipërm të ketë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist**
- 2 (dy) punonjës teknik Ndërtimi
- 1 (një) punonjës teknik Hidraulik

- 1 (një) punonjës teknik Gjeometer
- 1 (një) punonjës teknik Mekanik
- 1 (një) punonjës teknik Topograf
- 1 (një) punonjës elektrikist

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata **noteriale** e punës e vlefshme dëftes e shkollës profesionale/ose vërtetim i lëshuar nga shkolla profesionale **shtetërore** për secilin punonjës. Stafit i mësipërm të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020– Janar 2021\***Mosparaqitja e kontrave të nënshkruara për para noterit mes palëve kontratore do të jetë kusht skualifikues**”.

**Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të lidhur para noterit, për punonjësit e kërkuar**, referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij kodi përcaktohet se “*Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar*”.

Kërkesa që diplomat e punonjësve të jenë të lëshuara nga shkolla profesionale **shtetërore**, kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e OE ofertues që disponojnë punonjës të kualifikuar, me diplomat përkatëse, të vlefshme, të lëshuara nga institucione të tjera, jo shtetërore.

**3. Në Pikën 6**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

<i>Punonjës Karpentier</i>	2 (dy)
<i>Punonjës Murator</i>	3 (tre)
<i>Punonjës Hekur kthyes</i>	1 (një)
<i>Specialiste ndërtimi</i>	1 (një)
<i>Hidraulik</i>	3 (tre)
<i>Punëtori e specializuar elektrikist (me certifikatë)</i>	2 (dy)
<i>Punëtori e specializuar me makineri, (automakinist) (me certifikatë)</i>	2 (dy)
<i>Punëtori e specializuar me makineri, (eskavatorist) (me certifikatë)</i>	3 (tre)
<i>Punëtori e specializuar hidraulik (me certifikatë)</i>	2 (dy)
<i>Inxhinier (Me certifikat “Përgjegjës për sigurin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë)</i>	1 (një)
<i>Inxhinier (Me certifikat “Specialist Ndërtimi)</i>	1 (një)
<i>Punëtori e specializuar me makineri, (manovratorë me certifikatë)</i>	4
	(katër)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), dëshmitë e afësisë profesionale dëftesë/certifikatë/ diplomësi dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020– Shtator 2020.*

Kërkesat për fuqinë punëtore (pika 4 e 5, dhe inxhinierët e përfshirë) i shërben AK për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të OE, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Kërkesat e pikave 4 e 5 nuk janë në përputhje me:

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “...*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”.

**4. Në pikën 7**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht: 5 (pesë) eskavatorist/manovrator, 2 (dy) automakinist, 5 (pesë) shoferë, Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020– Janar 2021*”.

Kriteri që 5 (pesë) eskavatorist/manovrator, 2 (dy) automakinist, 5 (pesë) shofere, të disponohen në listëpagesa **për periudhën Janar 2020– Janar 2021**, nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë *në pronësi ose me qera*. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në

listpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

**5. Në Pikën 8**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një) mjek** të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual të profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Maj 2021– Korrik 2021**. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij **1 (një) mjek** të përgjithshëm. (Në mbështetje të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 OE pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.”

Në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Sigurimi i shërbimit mjekësor ligjërisht lejohet me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

**6. Në Pikën 9** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një **Inxhinier** që përmbush kriteret për të qenë koordinator për **realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve**, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.te shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Librezë pune, Diplome, CV si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë”.

Kërkesa për Inxhinier me certifikimin “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”, kërkuar në pikën 9 të Kapacitetit Teknik, është e tepërt pasi do të mjaftonte punonjësi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, referuar përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**7. Në Pikën 11**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”.

- **Autobot për KUZ (shoqëruar dhe me QKL Kodi III.1.A)”**.

Kërkesa nuk lidhet me objektin e prokurimit, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**8.NëPikën 12**. të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar:“Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme: (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike secili nga operatorët duhet të zoterojë certifikatat e mëposhtme në përputhje me punimet e marra përsipër).

Për të garantuar punime me cilësi dhe me seriozitet operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme (ose të njëvlefshme me to):

- **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit “lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, për mbrojtjen e mjedisit dhe të sistemit.
- **ISO 1452-1:2009** mbi “Ndërtimin e sistemeve të tubacioneve për transportimin e ujit, mbi dhe nën tokësore” për pjesën e kanalizimeve me presion mbi tokë për tubat.
- **BS ISO 39001:2012** mbi “Sigurinë në trafikun rrugor”.
- **ISO BS EN 13331-1: 2002** Realizimi i punimeve për veshjet e kanaleve dhe skrapatave të ndryshme.
- **ISO DS CET/TR 15128:2005** Realizimi i riparimeve kanalizuese për shkarkime dhe kullime të ujrave.
- **ISO 3834-4 2005 mbi Sistem i Menaxhimi i Sigurisë për Saldimet (e vlefshme).**

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të

prokurimit” ku përcaktohet që “*Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

**9. Në Pikën 13**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatorët ekonomikë, duhet kenë apo që mund t’i vihen në dispozicion .*

*1 (një) nje thyerje materiale inert e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B,*

*1 (një) fabrike betoni e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B*

*Në rastin kur ka një kontratë qiraje/furnizimi me prodhuesin, bashkë me lejen mjedisore të prodhuesit, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit evlefshme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë 1 (një) agranom me licenc sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI me eksperienc mbi 10 vjet e dëshmuar me Licencë, Librezë pune, Diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

*Operatori ekonomik të ketë të punësuar një ekspert zjarrëfikse të shoqëruar me: kontratë noteriale pune, certifikaten e zjarrfiksit, librezë pune, cv, të jetë në listë pagesa për periudhën 12 muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrëfikës të jetë të i pajisur me Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL (kjo pikë kërkohet duke qenë se në objektet do përdoret praimer/bitum këto materiale konsiderohen lëndë e rrezikshme për zjarr) ”.*

Inertet gjenden lehtësisht në treg, kërkesa për paraqitjen e lejeve mjedisore i përket të tretëve (I njëjti arsytim qëndron edhe për fabrikën e betonit).

Në lidhje me vendosjen e kriterit për licencën Kodi 1.2.A për mbrojtjen nga zjarri, dhe agranom me eksperiencë 10 vjet nuk kanë asnjë ngjashmëri me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

- ekspertiza profesionale në fjalë është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacioneve teknike, për rrjedhojë rekomandojmë që AK, të rivlerësojë nevojën për vendosjen e kërkesës së mësipërme.

- garantimi i realizimit të punimeve respektive në fazën e zbatimit, **nëse kërkohet**, mund të përmbushet edhe nëpërmjet disponimit nga ofertuesit të ekspertit individ të certifikuar.

Kërkesat e sipërcituara nuk janë në përputhje me-përcaktimet e nenit 77 Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që përcakton se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa për licencën e mësipërme duhet të përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

**10. Në Pikën 14**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:*

*a. Tubo HDPE dhe PVC. Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi Kodi III.1.B (riciklim plastik), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.2.B (përpunimi i plastikës) dhe certifikatën e cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme dhe katalogu përkatës, leje mjedisore Kodi III.1.B (riciklim plastik), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.2.B (përpunimi i plastikës), certifikatën e cilësisë ISO9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*b. Pllaka granili dhe bordure kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi III.1.A dhe certifikatë ne cilësisë ISO 9001/ ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme dhe katalogu përkatës, leje mjedisore kodi III.1.A, certifikatën e cilësisë ISO9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit”.*

OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për

paraqitjen e certifikatave të cilësisë, mund t'i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

**11. Në Pikën 15** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.1.A në mbështje të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 dhe Ligj nr. 104448, Datë 09.6.2011*”.

Kriteri për disponimin e licencë me Kodin III.1.A, Për stacionim transferimi mbetje jo të rrezikshme, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve, do të penalizoheshin vetëm për faktin që nuk disponojnë stacion transferimi mbetjesh. Nga ana e AK përcaktohet vendi i hedhjeve të mbetjeve.

**12. Në Pikën 16** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin nr. 10081 datë 23.02.2003, nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.*

Kriteri për disponimin e licencë të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve nuk nevojitet kërkesa e sipërcituar.

**13. Në pikën 18** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Çdo ofertues do të paraqesë Planin e sigurisë në kantier*”.

*Për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 datë 06.11.2003. sipas kërkesa, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rrugë kalimet, tabelat e sigurimit teknik etj”.*

Kërkesa për paraqitjen e **Plan-organizimi i punimeve në objekt**, si kërkesa të veçanta për kualifikim, nuk i përmbahet përcaktimeve të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pasi nuk është e qartë si do shërbejë për kualifikimin e ofertuesve, ndërkohë që kriteri i përzgjedhjes së fituesit është çmimi më i ulët.

Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.**

**19. Në pikën 19** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Një Inxhinier Mjedis si që është drejtues teknik, në mbështje të VKM nr. 268 datë 24.04.2003 “Për ndikimin në mjedis dhe auditimin mjedisor të paraqitet, Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin të ndikimit në mjedis, për hartim ekspertize për probleme mjedisore, ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të jetë në listpagesat e shoqërisë.”*

**Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt.** Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.**

**B.Kritere që krijojnë probleme për plotësim nga OE konkurues dhe mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.**

**1. Në Pikën 2.2.1,** të Kapacitetit Ligjor/Profesional, në DT është kërkuar:“*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar*”.

**Ky kriter nuk është në përputhje me** përcaktimet e nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet që “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.

Në lidhje me kërkesën për Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.

**2. Në Pikën 2.3,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e madhe se dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Kërkesa nuk është në përputhje me parashikimeve të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku përcaktohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor **kërkon:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të madhe se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e madhe se dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

(Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme).

Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, ku përcaktohen vlerat kufi që mund të përcaktojnë në kriter AK, operatorët ekonomikë mund të paraqesin vlera edhe më të mëdha se vlera kufi minimale.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A.G, z. O.V. e z. U.D.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të përmbajë detyrimisht **specifikimet tekniketë** shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Hartimi i kërkesave për kualifikim nuk janë në përputhje me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin rregullat të prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga z. A.G., z. O.V. e z. U.D.. si dhe z. B.B. Titullar i AK, në cilësinë e miratuesit të tyre.

### **- Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me nr. 231 prot., datë 18.09.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 (dy) OE kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofruara:

**1. OE “A..A..C” Shpk** (me NIPT: K..C). Oferta ekonomike me vlerë **33,441,800** (tridhjetë e tre milionë e katërqindë e dyzetë e një mijë e tetëqindë) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “2.. K...” Shpk**, (me NIPT: J..K). Oferta, në vlerë ekonomike **35,195,200**(tridhjetë e pesë milionë e njëqindë e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqindë) **lekë pa Tvsh**.

Në dosjen e procedurës së prokurimit gjenden me nr. 232 prot., datë 15.09.2021 “formulari deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit” nga anëtarët e **Njësisë së Prokurimit** dhe dhe KVO.

Procesverbali i KVO me nr.233 prot., datë 15.09.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar të 2 OE, është shpallur oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga OE “A.A.C” Shpk.

**Raporti përmbledhës** me nr. 235 prot., datë 16.09.2021, miratuar nga i titullarit të AK znj. B.. Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 236 prot., datë 16.09.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 321 prot, datë 12.10.2021. Vlera totale përfundimtare e kontratës: **40,130,160** (dyzetë milionë e njëqindë e tridhjetë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë) **lekë me Tvsh**.

Në dosjen e prokurimit gjendet procesverbali me nr. 228 prot., datë 03.09.2021 mbi vizitën e organizuar në kantier nga përfaqësuesi i OE “A.A. C.” Shpk nënshkruar nga ing. E.M. dhe miratuar nga Titullari i AK z. J.G.

Proces verbali me nr. 228 prot., datë 03.09.2021 në kantierin e ndërtimit zbatim të veprës me objekt: “*Ujësjetësi i zonës Bramush, Horë Vranisht*”, mbi organizimin e vizitës në kantier formuluar/nënshkruar nga ing. E.M. dhe përfaqësuesi i OE “A.A.C” Shpk, z. A. G.

**- Vlerësimi i procedurës:**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se OE “A..A..C” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e DT, konkretisht; Nuk plotëson kriteret e:

**Lidhur me OE të shpallur fitues “A.A.C” Shpk**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Titulli i gjetjes 22:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A.A.C” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** -Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “A..A..C” Shpk dhe duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në zbatim të: Nenit 2 “Qëllimi”, pika 1, gërma “c”, neni 3 “Parime të përgjithshme” pika 1, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 1, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 5, neni 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” pika 3, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi i ligjit”.

**OE “A..A..C” Shpk,ka mangësi në dokumentacioni e paraqitur në SPE.**

**I. Pikë 2.2/1** “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar”.



1. Bilanci i vitit 2018, është deklaruar online më datë 28.03.2019, me nr. 4747 prot., datë 04.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E.V .S.” Shpk.

2. Bilanci i vitit 2019, është deklaruar online më datë 21.04.2020, me nr. 4245 prot., datë 23.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E.V. S.” Shpk.

Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L. F. më Korrik 2020

2. Bilanci i vitit 2020, është deklaruar online më datë 14.04.2020, ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E. V. S.” Shpk, të njehsuara në sistemin tatimor C@TS më datë 14.04.2021.

Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L.F. më Korrik më datë 19.05.2021.

**Pika 2.2/3** “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar)”;

1. Vërtetim me nr. 13 prot., datë 02.09.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier, për vitin 2020.

2. Vërtetim me nr. 156 prot., datë 28.10.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kavajë, për vitin 2020.

**Gjatë vitit 2020 OE “A. A.C” Shpk, ka ushtruar aktivitet edhe në NjQV por nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore:**

1. Bashkia Kolonjë, Bashkia Durrës; Bashkia Vlorë: Bashkia Peqin: Bashkia Mallakastër: Bashkia Selenicë.

## **II. Pikës 2.3.11 të DT:**

1. Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa MK4439A, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 deri më datë 13.05.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 “Kontratë qiraje automjetesh” e lidhur ndërmjet OE “S... 0...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

Për mjetin “Kamion”; Targa MK4439A; Marka Volvo; Tip FM12; Shasia YV2J4DPG22A539290; Viti i prodhimit 2001.

Cetrifikatë me nr. 17, datë 01.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Mallakastër për mjetin Volvo me targë MK4439A për OE “S... 0...” Shpk. Kapaciteti 20 ton (32,000 -12,000).

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Certifikata e transportit për mjetin Volvo me targë MK4439A është për OE “S.. 0...” Shpk.

Mjetit i mungon; Leje transporti dhe Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse.

2. Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa AA430KP, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 210 Rep., nr. 91 Kol., datë 19.01.2021, deri më datë 19.01.2028.

Në SPE është paraqitur me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Kontratë qiraje automjetesh” e lidhur ndërmjet J... D... dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

a. Për mjetin “Kamion”; Targa AA430KP; Marka Iveco Fiat; Tip 410E42; Shasia ÈJMJ4CS800C081046; Viti i prodhimit 2000. Me kapacitet **24.15 ton** (40,000-15,850)

Cetrifikatë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Licencë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

b. Për mjetin “Kamion”; Targa AA023IY; Marka Iveco Fiat; Tip 354C13A; Shasia ZCFC3591005466506; Viti i prodhimit 2004. Kapaciteti **1.025 ton** (3,500 -2,475).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash.

Certifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore kanë përfunduar më datë 21.05.2021.

3. Për Kamionçinë 1.5-2 ton, me Targa FR1814D, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 2410 Rep., nr. 1424 Kol., datë 20.07.2017, deri më datë 20.07.2022.

Në SPE është paraqitur me nr. 2410 Rep., e nr. 1424 Kol., datë 31.07.2017 “Kontratë qiraje mjete” e lidhur ndërmjet R... S...dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA448CF; Marka Man; Tip 412069/FAK; Shasia 41206960696; Viti i prodhimit 1981. **3.7 ton** (11,000-7,300).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Çertifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore.

Nuk ka Foto të mjetit.

**b.** Për mjetin “Kamion”; Targa FR1814D; Marka Mercedes Benz; Tip 611318/408D; Shasia ĒDB61113181P031654; Viti i prodhimit 1990. **1.15 ton** (3,500-2,350).

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Taksat vjetore. Nuk ka Foto të mjetit.

**4.** Për Fadrom me Goma; JVC MOD 406, dhe Cekic Pneumatik H 608 S/N Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1712 Rep., nr 723 Kol., datë 14.05.2015, deri më datë 13.05.2025.

Në SPE është paraqitur me nr. 1712 Rep., e nr. 723 Kol., datë 14.10.2016 “Kontratë qiraje automjete” e lidhur ndërmjet OE “R...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Skrep i përdorur me zinxhirë”, Marka Caterpillar, Tip 951C; Shasia 96H564, Viti i prodhimit 1976. Vërtetim zhdoganimi datë 20.12.2006. Deklarata doganore nr. 9480, datë 18.12.2006.

**b.** Për mjetin “Fadrom i përdorur me zinxhirë”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1703, datë 30.10.2009.

**c.** Për mjetin “Çekiç pneumatik i përdorur për riparim (pjesë sonde)”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1630, datë 26.11.2007.

**d.** Për mjetin me “Fadromë me goma” Model JVC Mod. 406; Shasia 632321, Viti i prodhimit 1989. Deklarata doganore nr. R 4966, datë 12.05.2009.

**e.** Për mjetin me “Kamion i përdorur për mallra” Marka Volvo; Tipi F89; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton. Deklarata doganore nr. R8523, datë 20.12.2006.

Kohëzgjatja e kontratës është deri më datë 14.10.2021.

-Vërtetim zhdoganimi për mjetin “Skrep-Caterpillar” më datë 20.12.2006.

- Deklarata doganore për kamionin Volvo- Vërtetim zhdoganimi 19.12.2006

**5.** Për Mini Fadromë Bobcat AEMT20, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1808 Rep., nr 769 Kol., datë 23.06.2018, deri më datë 23.06.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1808 Rep., e nr. 769 Kol., datë 23.06.20218 “Kontratë qiraj e mjeti” e lidhur ndërmjet OE “R.&G.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

**a.** Për mjetin “MT”; Bobcat; Tip-S300; Shasia 531116185; Viti i prodhimit 2007; targa AEMT20.

**6.** Për Autobetoniere, me Targë AA793BV, Kontratën e Qerasë (noterisë) me nr 1216 Rep., nr 691 Kol., datë 14.04.2018, deri më datë 13.04.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1216 Rep., e nr. 691 Kol., datë 18.04.2018 “Kontratë qiraje mjete” e lidhur ndërmjet OE “F. F.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa AA793BV, Marka MAN, Tip 33-372; Shasia ĒMAF099059M156682, Viti i prodhimit 1993.

**Mungon:** Certifika e pronësisë së mjetit; Certifikatën e transportit; Leja e transporti; Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse; Taksa e vjetore të mjetit dhe fotot (24,000-11,700).

**7.** Me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Prokurë e posaçme” e lidhur ndërmjet OE “A.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

**1.** Për mjetin “Autobot”; Targa AA203EZ; Marka Mercedes Benz; Tip 813D; Shasia 31805114159565; Viti i prodhimit 1986. **24 ton (7,490-4,660)**

**8. Eskavator me Goma** LU 9705 B Nr 4115 Rep Nr 2413 Kol 04.12.2017 03.12.2022

Në SPE është paraqitur me nr. 4115 Rep., e nr. 2413 Kol., datë 04.12.2017 “Kontratë qiraje mjete” e lidhur ndërmjet PF N... L... dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa LU9705B, Marka JCB, Tip 3CX97TP; Shasia 0475423, Viti i prodhimit 1998. Është paraqitur vetëm leja e qarkullimit nr. LU0004150.

**9.** Me nr. 4005 Rep., e nr. 2346 Kol., datë 14.10.2017 “Kontratë qiraje mjete” e lidhur ndërmjet PF K. C. dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**1.** Për mjetin “APV”; Targa AA147RB; Marka Astra; Tip BM21F/BM21; Shasia 41623; Viti i prodhimit 1977. Leje qarkullimi me nr. VLF0600316.

Siguracioni ka përfunduar më datë 07.06.2021. Kontrolli Teknik ka përfunduar më datë 25.06.2021. Certifikata e Kontrollit Teknik (tahografit) ka përfunduar më datë 09.06.2021.

2. Për mjetin “Kamion”; Targa AA672IV; Marka Iveco Fiat; Tip A1HC/135-17; Shasia VF5a1HC0001105334; Viti i prodhimit 1985. **8 ton** (13,300-5,300).

Cetrifikatë me nr. 108, datë 12.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Vlorë për mjetin Iveco Fiat me targë AA672IV + Foto.

**Foto e mjetit** “Kamion Iveco” me targë AA672IV.

**Foto e mjetit-auto vinç- ASTRA me targë AA147RB-(vetëm foto).**

**10.** Me nr. 289 Rep., e nr. 126 Kol., datë 26.01.2021 “Kontratë qiraje – Pasuri të luajtshme” e lidhur ndërmjet PF I. F..dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

1. Për mjetin “Kamion” Marka Volvo; Tipi FL6; Viti i prodhimit 2009; Shasia YV2TN12A59B548691; Kapaciteti 12 ton.

2. Për mjetin “Eskavator Bobcat” Tipi 341; Seria 14208; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

3.Për mjetin me “Minieskavator” Marka Janmar; Tipi B22-2; Shasia 31055B. Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

Cetrifikatë me nr. 066, datë 09.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Fier për mjetin Volvo FL6 me targë AB310CA për “A..A..C” Shpk **Foto nuk ka.**

**Në këto kushte ky OE** nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar.

Duke shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **33,441,800 lekë pa Tvsh.**

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z.A..B.. (Kryetar), z. E..M.. (Anëtar) e z. K..K.. (Anëtar).**

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO **z.A..B.. , z. E..M.. e z. K.K.**

**Ndikimi:**Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **33,441,800 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues OE “A.A.C” SHPK, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **40,130,160 lekë me TVSH.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “A..A..C” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **33,441,800 lekë pa TVSH,** duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: **z. A..G.., z. O..V.. e z. U..D.. dhe KVO: z.A..B.. , z. E..M.. e z. K..K...**

**Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 321 Prot., datë 12.10.2021 është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B...B... dhe Operatorit Ekonomik OE “A..A..C” Shpk me përfaqësues ligjor z. A... G..., me objekt: “Ujësjetësi i zonës Bramush, Horë Vranisht”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit,

specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **40,130,160** (dyzetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e një qind e gjashtëdhjetë)lekë me Tvsh.

#### **IV. “Rikonstruksioni i ujësjellësit Piqeras”, Bashkia Himarë.**

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ujësjellësit Piqeras”, Bashkia Himarë, viti 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 38 datë 06.08.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A..G.. (Ing. Ndërtimi) 2. O..V.. (Jurist) 3. U..D.. (Financier)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër nr.46, datë 20.08.2021: 1. A..B.. (Kryetar) 2. K..K.. (Anëtare) 3. E.M. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 75,765,820lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> BOE “E. S.” & “D. C.” & “B. B” Shpk, vlera e ofertës <b>72,556,615</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 3,209,205 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 13.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i bashkisë (të ardhurat + transferata e pakushtëzuar)	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE E.. S..” shpk 2. OE “P.. V..” Shpk
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</b>
<b>b. Kontrata nr. 332 prot., datë 15.10.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 05.10.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>87,067,938</b>

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 38 e nr. 187 Prot., datë 06.08.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondit limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D...

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 46 e nr. 204 Prot., datë 20.08.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A..B.. (Kryetar); z. E..M.. (Anëtar) e z. K..K.. (Anëtar).

**Hartimi fondit limit:** Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 26.06.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Preventivi është formuluar nga ing. K.K. Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

Referuar buxhetit të Bashkisë për vitin 2021, për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit, miratuar me fondet buxhetore të transferuara 2020-2022, për programin me ujë dhe kanalizime”, në bazë të shkresës nr. 769 prot., datë 12.04.2021 të MIE, Agjensisë Kombëtare e Ujësijellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, me fond limit: 75,765,820 (shtatëdhjetë e pesë milionë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqindë e njëzetë) lekë pa Tvsh, për objektin: Rikonstruksioni i ujësjellësit Piqeras”, Bashkia Himarë.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të Dokumenteve të Tenderit me nr. 210 prot., datë 20.08.2021, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT.

Me Procesverbalin nr. 211 prot., datë 20.08.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP. **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP në DT.**

#### **Titulli i gjetjes 23: Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.**

AK në DT ka kërkuar vizitë në kantier pa e formuluar në njoftimin e shkurtuar të kontratës, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat

direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata: Hartimi i kriterëve:**

**1. Në Pikën 2.3** Kapaciteti Teknik: Nën-pika “ii” në DT është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të kategorive NP 1 - B; NP 2 - A; NP 4 - A; NP 7 - C; NP 12 - A; NS 4 - A; NS 8 - A; NS 9 - A; NS 14 - A; NS 16 - A; NS 18 - A”.

Kërkesa nuk është në përputhje me përcaktimet e pikes 2, të nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në Pikën 2.3** Kapaciteti Teknik: Nën-pika “iv” është kërkuar: “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV për 2 (dy) inxhinier ndërtimi, 2 (dy) inxhinier mekanik, 2 (dy) inxhinier hidroteknik, 2 (dy) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier topograf. Staf i mësipërm, duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar – Maj 2021 si dhe te figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i cili duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar – Maj 2021.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH/ekuivalente për 1 (një) specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili duhet te jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Janar – Maj 2021.

3. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, të paktën një inxhinier mjedisi, drejtues teknikë, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë për ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit dhe të punësuar 1 Mjek, me kontratë individuale pune të lidhur para noterit, referuar VKM Nr.742, datë 6.11.2003 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”, shoqëruar me kontratë noteriale pune, diplomë dhe licensë.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë/certifikatë të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente për 2 (dy) teknik ndërtimi, 4 (katër) hidraulikë, 4 (katër) elektrikist, 4 (katër) muratorë, 2 (dy) mekanikë, 2 (dy) karpentier, 1 (një) bojaxhi, 3 (tre) specialistë për montim tubash; 5 (pesë) automakinist/manovratore. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Kërkesa për Inxhinier me certifikimin “..koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, është e tepërt pasi do të mjaftonte punonjësi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, referuar përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**Ndikimi i zbatimit të kontratës në mjedis, konsiderohet i realizuar në projekt.** Vendosja e kërkesës së sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për rregullat e prokurimit publik”, **çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.**

Në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Sigurimi i shërbimit mjekësor ligjërisht lejohet me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Kriteri që 5 (pesë) eskavatorist/manovrator, (**kur në DT kërkohen mbi 35 makineri të rënda**), nisur nga fakti se makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë operatori ekonomik për ekzekutimin e kontratës, kërkohen të jenë në pronësi ose me qera. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriteri i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listpagesat e shoqërisë është i tepërt, pasi ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

**3. Në Pikën 2.3 Kapaciteti Teknik: Nën-pika”v”** në DT është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë

- 7 (shtatë) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës  $\geq 18$  ton;
- 4 (katër) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5 ton deri 18 ton;
- 2 (dy) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 ton deri 10 ton;
- 2 (dy) kamionë me vinq;
- 4 (katër) autobetoniere;
- 4 (katër) eskavatorë me zinxhirë me kompresor, me cekic;
- 2 (dy) eskavatorë me goma;
- 2 (dy) skrep/fadroma;
- 1 (një) asfaltoshtruese;
- 1 (një) autobitumatriçe;
- 2 (dy) autobot uji;
- 2 (dy) rimorkiator për lëvizjen e mjeteve që nuk lëvizin në rrugë;
- 3 (tre) motogjenerator/gjenerator,
- 1 (një) motosaldatrice/saldatrice,
- 3 (tre) aparatura për bashkim tubacionesh me metoden “Elektro Fusion Joint”,
- 2 (dy) sistem ëllpoint/ekuivalent për heqje ujrash,
- 1 (një) frezë asfalti,
- 1 (një) sharrë asfalti,
- 1 (një) sondë për shpime horizontale për kalim tubash nën trasenë e rrugës,
- 1 (një) sondë për shpime vertikale për kalim tubash nën trasenë e rrugës,
- 1 (një) aparaturë me ultratinguj për testim/matjen e rrjedhjes ose prurjes,
- 1 (një) makineri për veshjen e kanalit me beton në mënyrë Automatike (molding machine, Chanel making machine.).

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat) dhe foto përkatëse.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirasë duhet të paraqitet leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat) dhe foto përkatëse.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi të paraqitet dokument i vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Në lidhje me numrin e pajisjeve/makinerive të kërkuar, duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, ofertuesi të disponojë një numër relativisht të lartë nuk është i *argumentuar*, referuar përcaktimit të pikës 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që *çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin Teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët makinerish se ai i vendosur në këtë kriter.*

**4. Në Pikën 2.3.6.** të Kapacitetit Teknik në DT është kërkuar: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

1. *Operatorët ekonomikë, duhet kenë 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jenë të pajisura me dokument pronësie dhe leje mjedisore kodi III.1.B. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.*

2. *Operatorët ekonomikë, duhet kenë 1 (një) nyje fraksionimi intertresh, e cila duhet të jenë të pajisura me dokument pronësie dhe leje mjedisore Kodi III.1.A, lëshuar nga QKL ose leja mjedisore lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.*

3. *Tube HDPE dhe PVC. Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike) dhe certifikatën e cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme dhe katalogu përkatës, leje mjedisore kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), certifikatën e cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit|”.*

**Materialet ndërtimore gjenden lehtësisht në treg.** OE konkurues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatave të cilësisë, mund t’i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

**5. Në Pikën 2.3.7.** të Kapacitetit Teknik në DT është kërkuar: “Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. *ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*

2. *ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.*

3. *ISO 45001(Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*

4. *ISO EN 3834-2:2006 “(Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike), ose ekuivalente.*

5. *DS CEN 15128 (Sistemi i standardeve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit), ose ekuivalente.*

6. *BS EN 13331-1 2002 ( Sistemet për veshjen e kanaleve), ose ekuivalente.*

7. *ISO 1452-1:2009 (Sistemi i tubacioneve plastike), ose ekuivalente”.*

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “për miratimin e rregulave të prokurimit” ku përcaktohet që “*Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

**6. Në Pikën 2.3.8**të Kapacitetit Teknik në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për transportin e mbetjeve, lëshuar nga QKL.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit”.*

Kriteri për disponimin e licencë të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B “për transportim e mbetjeve, sjellë kufizim të panevojshëm, pasi operatorët ekonomik të cilët mund të disponojnë të gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme për zbatimin me sukses të punimeve nuk nevojitet kërkesa e sipërcituar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A..G., z. O..V. e z. U..D..**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, nuk duhet të kërkojë vizitë në kantier, pa e deklaruar në Njoftimin e Kontratës, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Me nr.245 prot., datë 20.09.2021 Procesverbali për hapjes së procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy OE me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. BOE “E... S...” Shpk & “D... C...” Shpk & “B... B...” Shpk me NIPT:** (me NIPT-e respektive: L...I; K...J e K...H), me ofertë ekonomike në vlerën **72,556,615** (*shtatëdhjetë e dy milionë e pesëqindë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqindë e psëmbëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

**2. OE “P... V...” Shpk,** (me NIPT:L...2C), me ofertë ekonomike në vlerën **75,603,190**(*shtatëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqindë e tre mijë e njëqindë e nëntëdhjetë*) **lekë pa Tvsh.**

- Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes, me nr. 246 prot., datë 20.09.2021 formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP dhe KVO-së.

- Procesverbali i KVO me nr.242 prot., datë 05.08.2021 “Për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë pjesëmarrës 2 (dy) OE dhe kualifikuar të dy.

- Raporti përmbledhës me nr. 274 prot., datë 22.09.2021, miratuar nga Titullarit i AK.

- Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr. 275 prot., datë 22.09.2021.

### **Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 3342 prot., datë 15.10.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B...B... dhe BOE “E... S...” Shpk & “D... C...” Shpk & “B... B...” Shpk me përfaqësues me prokurë të posaçme nga OE “E.. S...” Shpk, me administrator z. Q.. T.. me objekt: “Rikonstruksion i ujësjellësi Piqeras”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **87,067,938**(*tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëdhjetë mijë e nëntë qind e tridhjetë e tetë*) **lekë me Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “E... S...” Shpk & “D... C...” Shpk & “B... B...” Shpk. duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët **NJHDT: z. A..G., z. O..V. e z. U..D.**



## V. “Vepra e marrjes dhe e shtesës së linjës kryesore të ujësjellësit Kuç”, Bashkia Himarë.

<b>5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Vepra e marrjes dhe e shtesës së linjës kryesore të ujësjellësit Kuç”, Bashkia Himarë, viti 2021</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 47 datë 24.08.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A..G.. (Ing. Ndërtimi) 2. O..V.. (Jurist) 3. U..D.. (Financier)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-</b> Urdhër nr.48, datë 24.08.2021: 1. A..B.. (Kryetar) 2. K..K.. (Anëtare) 3. E..M.. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b>  E Hapur”		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 22,200,095 lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “L..” Shpk, vlera e ofertës, 21,970,868 lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 229,226 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 15.09.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i bashkisë (fondet buxhetore të transferuara)	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “L...” Shpk
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata nr. 380 prot., datë 05.11.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 15.10.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>26,365,042</b>

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 47 e nr. 213 Prot., datë 24.08.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondit limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 48 e nr. 214 Prot., datë 24.08.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A.B..(Kryetar); z. E.M. (Anëtar) e z. K.K.(Anëtar).

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është realizuar nga “A.V. E.” Shpk

Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit e dokumenteve të tenderit nr. 215 prot., datë 24.08.2021, nga anëtarët e NJP. Duke ju referuar buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021 për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së Institucionit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 66, datë 21.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021” fond limit **22,200,095 (njëzetë e dy milionë e dyqindë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh** për objektin: “Vepra e marrjes dhe e shtesës së linjës kryesore të ujësjellësit Kuç”, Bashkia Himarë.

Procesverbali i datë 24.08.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike”, është i paraqitur në SEP të APP-së.

- Me nr. 216 prot., datë 25.08.2021, Njoftimi i shkurtuar i kontratës.

### **Titulli i gjetjes 24: Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.**

AK në hartimin e DT nuk ka kërkuar vizitë në kantier pa u shpallur në Njoftimin e Kontratës vizita, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Situata: Hartimi i kriterëve:**

**1. Në Pikën 2.3.2** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: *Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar të paktën 50 punonjës për periudhen Janar 2021 – Prill 2021, e vërtetuar kjo me:*

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen Janar 2021 – Prill 2021.*

- *Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2021 – Prill 2021”.*

Në lidhje me numrin e kërkuar **50** (pesëdhjetë) punonjës, duke ju referuar tipologjisë së objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nga AK nuk është argumentuar e nuk është në përputhje me;

- Pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë Kapacitetin Teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kritereve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

**2. Në Pikën 2.3.3** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: “Operatoret ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense disponojnë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VK nr. 42 datë 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

**Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

N.P. 1 – A - Punime gjurmimi në tokë.

N.P. 2 – A - Ndërtime civile dhe industriale.

N.P. 4 – A - Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

N.P. 5 – A - Punime nëntoksore, ura e vepra arti.

N.P. 12 – A - Punime të inxhinierisë së mjedisit.

- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

N.S. 1 – A - Punime për prishjen e ndërtimeve.

N.S. 3 - A - Impiante ngritese dhe transportuese.

N.S. 4 – A - Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

N.S. 5 – A - Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

N.S. 6 – A - Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

N.S. 7 – A - Barriera dhe mbrojtje rrugore.

N.S. 8 – A - Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

N.S. 9 – A - Punime strukturorë speciale.

N.S. 10 – A - Shtresa dhe mbistruktura speciale.

N.S. 18 – A - Punime topogjeodezike.

N.S. 19 – A - Sistemet kundra zhurmës për infrastrukture.

**sipas modelit të lëshuar nga MPPT”.**

Referuar punimeve të përfshira në DT të procedurës, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojin e punimeve të përfshirë në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

**3. Në Pikën 2.3.4** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: **Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet.**

**a.** *Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm:*

- 1) *Inxhinier Ndërtimi - 1 (një)*
- 2) *Inxhinier Topograf/Markshajder - 1 (një)*
- 3) *Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)*
- 4) *Inxhinier Mekanik - 1 (një)*
- 5) *Inxhinier Gjeolog - 1 (një)*
- 6) *Inxhinier Elektrik -1 (një)*
- 7) *Arkitekt - 1 (një)*

*Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën Janar 2021 – Prill 2021.*

*Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma dhe CV.*

*Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshire në liçensën e shoqërisë, me eksperiencë pune minimumi 10 vjete dhe të deklaroje se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë punë e noterizuar (e vlefshme), Diplomë, CV si dhe librezë pune. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj deklaratën për përcaktimin e drejtuesit teknik të punimeve).*

*Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:*

- *1 (një) drejtues teknik i cili të disponojë çertifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.*
- *1 (një) punonjes specialist për dhënien e ndihmës së pare, dëshmuar me kontrate pune dhe certifikate të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptare.*
- *1 (një) drejtues teknik specialist ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dëshmuar me kontratë pune dhe çertifikata përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH.*
- *1 (një) drejtues teknik i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë”.*

*Për stafin e mësipërm duhet të paraqiten: Kontratë pune (e vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kerkuar.*

**b.** *Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij jo më pak se 20 punonjës të kualifikuar, nga të cilët të paktën:*

- *1 punonjës asfalti,*
- *2 punonjës saldator,*
- *1 punonjës hekurkthyes*
- *2 punonjës murator*
- *3 punonjes specialist ndertimi*
- *2 punonjës mekanik / elektromekanik*
- *2 punonjës karpentier*
- *1 punonjes hidroizolues*
- *1 punonjes ne lartesi*
- *1 punonjës elektrikist*
- *1 punonjes montator*
- *1 punonjes pompist*
- *1 punonjës hidraulik*
- *1 Specialist për montimin e tubave*

*Punonjësit duhet të jenë të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të loigjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit nr. 13/2013. Për punonjesit e sipërpermendur të paraqiten deshmite përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik, kontratat individuale të punës të vlefshme sidhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Janar 2021-Prill 2021.*

Gjithashtu, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) manovrator. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhen Janar 2021-Prill 2021.

c. Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Kodin III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportimin e mbetjeve urbane”; si dhe me kodin 1.2.A “Licensa për mbrojtjen nga zjarri” (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtarë duhet të ketë liçensat profesionale sa me sipër).

d. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1 (një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, i ndryshuar dhe të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e VKM nr. 742 datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Për të cilin duhet të paraqiten: Kontratë noteriale e punës, Diplomë, Urdhër Mjeku sidhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 12 muajt e fundit. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anetare duhet të ketë të siguruar mjekun e shoqërisë).

Në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër. Sigurimi i shërbimit mjekësor ligjërisht lejohet me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërcituar.

Kriteret për inxhinierët, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Lidhur me vendosjen e kriterit për licencat e sipërcituara, nga AK nuk është konsideruar:

- tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet,

- zbatimin e përcaktimeve të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa për licencat e mësipërme nuk përkonë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

- ekspertiza profesionale në fjalë është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacioneve teknike, për rrjedhojë vendosja e kërkesës së mësipërme është e nevojshme për realizimin e kontratës.

- garantimi i realizimit të punimeve respektive në fazën e zbatimit, **nëse kërkohet**, mund të përmbushet edhe nëpërmjet disponimit nga ofertuesit të ekspertit individ të certifikuar.

**4. Në Pikën 2.3.6** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: “Operatori / et ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikatën e cilësisë së punimeve:

-ISO 9001:2015 ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë); ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit); OHSAS 18001 / 45001:2007/2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë); PAS 99:2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar); ISO 39001:2012 (Certifikate për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor); ISO 1452-1:2009 (Sistemi i tubacioneve plastike); DS CEN 15128:2005 (Sistemi i standarteve europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimeve dhe kullimit); SA 8000:2014 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësisë shoqërore); ISO 28001:2007 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit); EN 13331-1 2002( Sistemet per veshjen e kanaleve); ISO 50001:2011 (Sistemi i menaxhimit të energjisë); ISO 3834-2:2006 (Sistemi i cilësisë për saldimin e materialeve metalike); ISO 27001:2013 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit); Rregullore (EU) nr. 333/2011 (Menaxhimi dhe trajtimi i hekurit, çelikut dhe aluminit per skrap). Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes) ”.

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit” ku përcaktohet që “*Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

**5. Në Pikën 2.3.9** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë noteriale shërbimi me një laborator testimi të materialeve të ndërtimit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012*”.

Kërkesa që nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kësaj kontrate, nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 44, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit”.

**6. Në Pikën 2.3.14** Për kapacitetin teknik: në Shtojcën 7 është kërkuar: “*Do të organizohet një vizitë në kantier 5 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 12:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e tubove të çelikut, të shoqëruara me raport testimet perkatese, si dhe me Certifikatën ISO 9001 të prodhuesit. Operoret ekonomik të interesuar gjatë vizitës do t’u japin informacione shtesë dhe shpjegime ku do të pajisen edhe me vertetim nga insitucioni, të cilat do të paraqiten në tender dhe përbëjnë kusht s’kualifikimi*”.

Kërkesë e pakuptimt, pasi Bashkia Himarë nuk ka asjë mënyrë për të testuar llojin e mostrave të tubove. Cilësia dhe raport testimet përkatëse moitorohen në zbatimin e kontratës.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, nuk duhet të kërkojë vizitë në kantier, pa e deklaruar në Njoftimin e Kontratës, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me nr. 280 prot., datë 29.09.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë me vlerë ekonomike e të ofruar:

**1. OE “L...” Shpk** (me NIPT: K...C).Oferta, me vlerë ekonomike **26,365,042.2** (njëzetë e gjashtë milionë e treqindë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyzetë e dy presje dy) **lekë pa Tvsh.**

Në dosjen e procedurës së prokurimi gjenden me nr. 281 prot., datë 29.09.2021 “Formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes”, formuluar/nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe dhe KVO.

Procesverbali i KVO me nr. 305 prot., datë 01.10.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar OE, dhe është shpallur oferta e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT, paraqitur nga OE “L...” Shpk.

**Raporti përmbledhës** me nr. 306 prot., datë 04.10.2021, miratuar nga i titullarit të AK znj. B.B.

Formulari i Njoftimit të kontratës së nënshkruar me nr. 339 prot., datë 15.10.2021.

Në dosjen e prokurimit gjendet vërtetimi me nr. 284 Prot., datë 24.09.2021 Me anë të cilit vërtetohet që: OE “L.” Shpk, ka depozituar pranë Bashkisë Himarë materialet për tubo çeliku të shoqëruar me dokumentacionin teknik.

Dokumentacioni i dorëzimit të mostrave dhe materialet tubo çeliku janë sipas kërkesave të percaktuara në DT.

#### **Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 380 prot., datë 05.11.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B.B. dhe OE “L.” Shpk me përfaqësues administrator z. J. L. me objekt: “Vepra e marrjes dhe e shtesës së linjës kryesore të ujësjellësit Kuç”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **26,365,042.20** (njëzetë e gjashtë milionë e treqindë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyzetë e dy pikë dy) **lekë me Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “L...” Shpk duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët **NJHDT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D..**

#### **VI. “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje lerash”, Bashkia Himarë.**

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje lerash”, Bashkia Himarë, viti 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 73 datë 12.10.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. A..G.. (Ing. Ndërtimi) 2. O..V.. (Jurist) 2. U..D.. (Financier)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër nr. 84, datë 28.10.2021:</b> <b>Urdhër nr.91, datë 19.11.2021</b> 1. K..K.. (Kryetar) 2. A..B.. (Anëtare) 3. E..M.. 3/1. L..M.. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar”</b>		
<b>5. Fondi Limit (pa Tvsh)</b> 5,831,946lekë	<b>6. Oferta fituese:</b> OE “A.A.C” Shpk, vlera e ofertës <b>4,967,800</b> lekë pa Tvsh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 864,146 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 12.11.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> (Buxheti i Shtetit dhe të ardhura)	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. OE “A.A.C” Shpk
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</b>
<b>b. Kontrata nr. 472 prot., datë 21.12.2021</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës 21.12.2021</b>	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	<b>5,961,360</b>

- Me Urdhërin e prokurimit me nr. 73 e nr. 327 Prot., datë 12.10.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 84 e nr. 366 Prot., datë 28.10.2021, ku KVO përbëhet nga: z/ A.B. (Kryetar); z. E.M. (Anëtar) e z. K.K. (Anëtar).

**Hartimi fondit limit:** Preventivi, relacioni teknik është realizuar nga Ing. S.K.e Topograf Sh. Ç., miratuar me nr. 4806 prot., datë 27.09.2021, nga Titullari i AK z. J.G.

Referuar buxhetit të Bashkisë për vitin 2021, për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit, me fond limit: **5,831,946** (pesë milion e tetëqindë e tridhjetë e një mijë e nëntëqindë e dyzetë e gjashtë) **lekë pa Tvsh**, për objektin: “Rikonstruksioni dhe mirëmbajtje lerash”, Bashkia Himarë.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të Dokumenteve të Tenderit me nr. 298 prot., datë 30.09.2021, formular/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT.

Me Procesverbalin nr. 367 prot., datë 28.10.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, formular/nënshkruar nga anëtarët e NJP.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 369 prot., datë 28.10.2021.

AK më datë 17.11.2021 ka hedhur në SPE

### **Ndryshimet në DT:**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 02.09.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Rikonstruksion dhe mirembajtje lerash”, me fond limit **5,831,946 lekë pa Tvsh**, AK **Bashkia Himarë në lidhje me** procedurën me REF-09828-10-28-2021, në lidhje me disa konstatime në DT.

AK më datë 17.11.2021 ka hedhur në SPE Shtojcën 7 të ndryshimeve në DT (personi përgjegjës z. O.V.), ku janë reflektuar pjesërësht rekomandimet e kordinatorit të APP.

**Titulli i gjetjes 25:** *Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.*

AK në hartimin e DT nuk ka formular Specifikimet Teknike, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:** Kriteret të veçanta, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte, sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët mund të disponojnë kapacitetet e mjaftueshme për ekzekutimin e kontratës.

**1. Në Pikën 2.3.2.** të Kapacitetit Ligjor e Profesional, në DT është kërkuar: “*Licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008: “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

*NP-1A, NP-2A, NP-3A.*

*NS-4A, NS-6A, NS-7A, NS-8A, NS-18A.*

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucioneve të autorizuar të Republikës së Shqipërisë”.*

Referuar punimeve të përfshira në preventivin e procedurës, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojin e punimeve të përfshirë në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në to.

Kriteret e sipërcituara sjellin kufizimin e pjesëmarrjes të OE ofertues të mundshëm, të cilët e kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, AK duhet t’i përmbahet përcaktimeve të nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**2. Në Pikën 2.3.3,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve për periudhën; e tre mujorit të fundit, të jetë jo më pak se 30 punonjës.*

*a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore për periudhën e tre mujorit të fundit*

*b) Listpagesat dhe mandat pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre mujorit të fundit”.*

Numrin e kërkuar **prej 30 punonjës**, duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, është relativisht i lartë dhe i paargumentuar.

Nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që cdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish.

**3.Në pikën 2.3.4,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje (për stafin të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjesve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj) sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës; dhe të figurojnë në listpagesat për periudhën e mësipërme:

- Inxhinier Ndërtimi (me certifikat “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë -1 (një)
- Inxhinjer Arkitekt (i paisur me Licencën Restaurues)-----1 (një)
- Inxhinjer Elektrik-----1 (një)
- Inxhinjer Gjeoded (topografe)---1 (një)
- Inxhinjer Hidro-----1 (një)
- Inxhinjer Mjedisi (Ing. mjedis profil energjetik ) -----1 (një)
- Agronom (me licencë nga MT) dhe OKL -----1 (një)”.

Në lidhje me kërkesën që inxhinieri i ndërtimit të zotërojë certifikat “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, referuar Ligjit nr. 10.237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, “Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe për rrjedhojë nuk është e domosdoshme që inxhinierët të kenë certifikimet përkatëse të kërkuara nga AK.

Kërkesa për 1 inxhinier i pajisur me licencë restaurues, 1 inxhinier elektrik, i inxhinier hidro, 1 inxhinier mjedisi me profil energjetik, 1 agronom me licencë nga MT dhe OKL, referuar punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërcituar. Kriteri për inxhinierët e sipërcituar, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Konstatimi qëndron edhe në lidhje me kërkesën për “Agronom”.

Kriter për arkitekt, inxhinierave dhe agronom, nuk i përmbahen përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Për rrjedhojë, sugjerojmë AK të rivlerësojë nevojën në lidhje me vendosjen e kërkesës për disponimin e inxhinierëve/stafit të sipërcituar.

**4.Në pikën 2.3.5** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se në listëpagesat e periudhës e tremujorit të fundit të rezultojnë të punësuar personel teknik, të kualifikuar nga subjektet e licensuara për certifikimin e tyre si dhe të jenë të pajisur me kartela sigurie në punë të vlefshme i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:

- Punëtori e specializuar me makineri,(automaknist) (me certifikatë) - 2 (dy)
- Punëtori e specializuar me makineri,(eskavatorist) (me certifikatë) - 3 (tre)
- Inxhinier (Me certifikat “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) 1 (një)
- Punëtori e specializuar me makineri, (manovratore me certifikatë) - 4 (katër)
- Mjek - 1 (një)”

Kërkesa për “Punëtori e specializuar me makineri”, kur AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e punonjësve të sipërcituar, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Kërkesa Inxhinier (me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”), referuar Ligjit nr. 10.237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, “Personi i



ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë”, për rrjedhojë nuk është e domosdoshme që inxhinierët të kenë certifikimet përkatëse të kërkuara nga AK, por mjafton një punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në lidhje me kërkesën për disponimin në listëpagesa të një mjeku, nuk është në përputhje me VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

**5. Në Pikën 2.3.6** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një Inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. të shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Libreze pune, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë”.*

Kërkesa e ripërsëritur për Inxhinier që përmbush kriteret, referuar Ligjit nr. 10.237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar, “*Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë*”, për rrjedhojë nuk është e domosdoshme që inxhinierët të kenë certifikimet përkatëse të kërkuara nga AK, por mjafton një punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë.

**6. Në Pikën 2.3.7** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:*

**b.** *Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi apo me qera një ambient për prodhimin e inerteve, parafabrikate, granit dhe të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit si dhe të jetë i pajisur me licencë QKL Kodi IV.1.B.2.*

**c.** *Operatori ekonomik duhet të ketë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081, datë 23.02.2003 , nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.*

**d.** *Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve si dhe një njeje të prodhimit të inerteve të paisur me QKL Kodi IV.1.B.2”.*

Materialet e nevojshme për realizimin e punimeve të kontratës janë lehtësisht të disponueshme në treg, mund të sigurohen edhe nëse operatori ekonomik ka kontratë furnizimi me impiante.

Kërkesa e pikës “c” nuk ka asnjë lidhje me realizimin e kontratës. Në lidhje me testimin e betonit është një proces që kontrollohet gjatë zbatimit të punimeve që monitorohet nga AK. Kërkesat për licencencat e QKL i referohen palëve të treta.

**7. Në pikën 2.3.8,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik të ketë një agronom si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të jetë i paisur me licencë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës dhe të jetë në listpagesë për periudhen e mësipërme (kjo e vërtetuar me anë të listpagesave të shoqërisë)”.*

AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e agronomit të sipërcituar. Kriteri për agronom e sipërcituar, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**8. Në pikën 2.3.9,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Një prej Inxhinjerëve të Mjedisit të jetë i paisur me Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin të ndikimit në mjedis për të siguruar auditimin mjedisor gjatë procesit të zbatimit kontratës, për hartim ekspertize për probleme mjedisore, ekspert i vlerësimit të ndikimit në mjedis si dhe të jetë në listpagesat e shoqërisë”.

Ekspertizat profesionale e Ing. Mjedisit është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive dhe Raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në pikën “a”, të nenit 1, të Ligjit nr. 10440, datë 7.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, *përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projektet të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim,* për rrjedhim shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve ndërtimore;

Kriteri nuk i përmbahet përcaktimeve të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa e sipërcituara nuk përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

**9. Në pikën 2.3.10,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Një nga drejtuesit teknik të mësipërm të jetë auditues energjie të pajisur me çertikatë për auditues energjie në proçese për auditimin e pajisjeve të punës”.

Kriteri nuk i përmbahet përcaktimeve të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa e sipërcituara nuk përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

**10. Në pikën 2.3.11,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqes dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik”.

**Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:**

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion mbi 18 m <sup>3</sup>	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë deri në 7.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Auto Betoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me kovë 0.25 m <sup>3</sup>	3 copë	Pronësi ose me qera
Vinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadroma	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi për ngjitje tub plastik kokë me kokë	1 copë	Pronësi ose me qera

Kriteret nuk i përmbahen përcaktimeve të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa e sipërcituara nuk përkojë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet.

**11. Në pikën 2.3.13,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori, duhet të ketë:

- Çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën **45001 2018 Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Çertifikatën **99 2012 Sistem i Integruar i Menaxhimit të Kompanisë** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik secili operator duhet t’i disponojë çertifikatat e mësipërme ISO.

- Rastet e detyrimeve të mëparshme kundrejt Bashkise Himarë si: gjoba, debi të ndryshme, moszbatim në kohë dhe sipas kushteve përkatëse të kontratave të mëparshme, të dokumentuara me njoftime, procesverbale etj, do të përbëjnë kusht për s'kualifikim të operatorit/operatorëve ekonomik përkatës”.

Kërkesat e sipërcituara nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Lidhur me kërkesën: “Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik secili operator duhet t’i disponojë certifikatat e mësipërme ISO”, secili OE duhet të plotësojë kërkesat për certifikatat, sipas natyrës dhe përqindjes së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshje.

Në lidhje me paragrafin e fundit, moszbatimi në kohe dhe sipas kushteve përkatëse të kontratave të mëparshme, gjoba apo debi, nuk mund të jetë kusht për skualifikimin e OE. Sjellim në vëmendje të AK se në nenin 108, të VKM nr.285, date 19.05.2021 parashikohet se: *Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 78, të LPP-së.*

Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.”.

B. Krite të krijojnë probleme për plotësim nga OE konkures dhe mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.

**1.Në pikën 2.2.2,** të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, në DT është kërkuar: “*Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik, të viteve 2018, 2019, 2020 lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*”.

Kriteri për vlerën e kërkuar të xhiros, nuk është në përputhje nenit 43, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ku përcaktohet që: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Për sa më sipër, nisur nga vlera e fondit limit të kësaj procedure, në lidhje me vlerën minimale të xhiros që u kërkohet operatorëve ekonomikë që ofertojnë, nuk është brenda vlerës kufi që është përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriteve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.**

**Ndikimi:** Kufizimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të përmbajë detyrimisht **specifikimet teknike;** të shmang aplikimin e kriteve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**-Zhvillimi i procedurës.**

Me nr. 416 prot., datë 24.11.2021, procesverbali për hapjes së procedurës së prokurimit, ku është konstatuar që në këtë procedurë kanë marrë pjesë një OE me vlerë ekonomike të ofruara:

**1.OE“A..A..C” Shpk** (me NIPT:K...C), me ofertë ekonomike në vlerë **4,967,800**(katër milion e nëntëqindë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqindë )**lekë pa Tvsh.**

- Formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes, me nr. 417 prot., datë 24.11.2021 formuluar/nënshkruar nga anëtarët e NJP dhe KVO-së.

- Procesverbali i KVO me nr. 424 prot., datë 25.11.2021 “Për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është pjesëmarrës 1 (një) OE dhe është kualifikuar.

- Raporti përmbledhës me nr. 449 prot., datë 08.11.2021, miratuar nga Titullarit i AK.

- Formulari i Njoftimit të Fituesi me nr.450 prot., datë 03.12.2021.

**Lidhur me OE të shpallur fitues “A..A..C” Shpk**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

**Titulli i gjetjes 26:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

**Situata:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “A..A..C” Shpk dhe duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e procedurës së prokurimit pasi asnjë prej OE pjesëmarrës në prokurim nuk plotësonin kushtet e DT. Për sa më sipër nga KVO nuk është siguruar mirëpërdorim i fondeve publike, nuk janë respektuar parimet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik dhe ofertës fituese. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në zbatim të: Nenit 2 “Qëllimi”, pika 1, gërma “c”, neni 3 “Parime të përgjithshme” pika 1, neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” pika 1, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 5, neni 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” pika 3, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 2 “Qëllimi i ligjit”.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se OE “A..A..C” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e DT, konkretisht; Nuk plotëson kriteret e:

**I. Pikë 2.2/1** “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar”.

**1.** Bilanci i vitit 2018, është deklaruar online më datë 28.03.2019, me nr. 4747 prot., datë 04.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E..V... S..” Shpk.

**2.** Bilanci i vitit 2019, është deklaruar online më datë 21.04.2020, me nr. 4245 prot., datë 23.04.2019 ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E..V.. S..” Shpk.

Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L... F... më Korrik 2020

**2.** Bilanci i vitit 2020, është deklaruar online më datë 14.04.2020, ka vulën e Sekretarisë së DRT Fier dhe Ekspertit Kontabël “E&V Studio” Shpk, të njehsuara në sistemin tatimor C@TS më datë 14.04.2021. Bashkangjitur “Raporti i audituesit të pavarur” L... F... më datë 19.05.2021.

**Pika 2.2/3** “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar)”;

**1.** Vërtetim me nr. 13 prot., datë 02.09.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier, për vitin 2020.

**2.** Vërtetim me nr. 156 prot., datë 28.10.2020, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kavajë, për vitin 2020.

**Gjatë vitit 2020 OE “A..A..C” Shpk, ka ushtruar aktivitet edhe në NjQV por nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore:**

1. Bashkia Kolonjë, Bashkia Durrës; Bashkia Vlorë: Bashkia Peqin: Bashkia Mallakastër: Bashkia Selenicë.

**II. Pikës 2.3.11 të DT:**

**1.** Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa MK4439A, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 deri më datë 13.05.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1714 Rep., e nr. 725 Kol., datë 14.05.2015 “Kontratë qiraje automjesh” e lidhur ndërmjet OE “S..O..” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

Për mjetin “Kamion”; Targa MK4439A; Marka Volvo; Tip FM12; Shasia YV2J4DPG22A539290; Viti i prodhimit 2001.

Cetrifikatë me nr. 17, datë 01.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Mallakastër për mjetin Volvo me targë MK4439A për OE “S..O..” Shpk. Kapaciteti 20 ton (32,000 -12,000).

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Certifikata e transportit për mjetin Volvo me targë MK4439A është për OE “S..O..” Shpk.

Mjetit i mungon: Leje transporti dhe Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse.

**2.** Për Kamion Vetshkarkues 10-12 ton, me Targa AA430KP, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 210 Rep., nr. 91 Kol., datë 19.01.2021, deri më datë 19.01.2028

Në SPE është paraqitur me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Kontratë qiraje automjesh” e lidhur ndërmjet J.. D... dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA430KP; Marka Iveco Fiat; Tip 410E42; Shasia EJMJ4CS800C081046; Viti i prodhimit 2000. Me kapacitet **24.15 ton** (40,000-15,850)

Cetrifikatë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Licencë me nr. 015, datë 08.10.2020 “Për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira brenda vendit” nga Bashkia Fier.

Kamioni nuk ka kapacitetin mbajtës (10-12 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

**b.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA023IY; Marka Iveco Fiat; Tip 354C13A; Shasia ZCFC3591005466506; Viti i prodhimit 2004. Kapaciteti **1.025 ton** (3,500 -2,475).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash.

Çertifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore kanë përfunduar më datë 21.05.2021.

**3.** Për Kamionçinë 1.5-2 ton, me Targa FR1814D, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 2410 Rep., nr. 1424 Kol., datë 20.07.2017, deri më datë 20.07.2022.

Në SPE është paraqitur me nr. 2410 Rep., e nr. 1424 Kol., datë 31.07.2017 “Kontratë qiraje mjesh” e lidhur ndërmjet R...S... dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Kamion”; Targa AA448CF; Marka Man; Tip 412069/FAK; Shasia 41206960696; Viti i prodhimit 1981. **3.7 ton** (11,000-7,300).

Kamionçina nuk ka kapacitetin mbajtës (1.5-2 ton) që kërkohet në pikën 11 te Shtojca 7.

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Çertifikata e kontrollit Teknik dhe Taksat vjetore.

Nuk ka Foto të mjetit.

**b.** Për mjetin “Kamion”; Targa FR1814D; Marka Mercedes Benz; Tip 611318/408D; Shasia EDB61113181P031654; Viti i prodhimit 1990. **1.15 ton** (3,500-2,350).

Nuk ka Licencë dhe Cetrifikatë për transport mallrash. Taksat vjetore. Nuk ka Foto të mjetit.

**4.** Për Fadrom me Goma; JVC MOD 406, dhe Cekic Pneumatik H 608 S/N Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1712 Rep., nr 723 Kol., datë 14.05.2015, deri më datë 13.05.2025.

Në SPE është paraqitur me nr. 1712 Rep., e nr. 723 Kol., datë 14.10.2016 “Kontratë qiraje automjete” e lidhur ndërmjet OE “R...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

**a.** Për mjetin “Skrep i përdorur me zinxhirë”, Marka Caterpillar, Tip 951C; Shasia 96H564, Viti i prodhimit 1976. Vërtetim zhdoganimi datë 20.12.2006. Deklarata doganore nr. 9480, datë 18.12.2006.

b. Për mjetin “Fadrom i përdorur me zinxhirë”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1703, datë 30.10.2009.

c. Për mjetin “Çekiç pneumatik i përdorur për riparim (pjesë sonde)”, Model H608 S/N 3420324/D000947, Viti i prodhimit 1975. Deklarata doganore nr. 1630, datë 26.11.2007.

d. Për mjetin me “Fadromë me goma” Model JVC Mod. 406; Shasia 632321, Viti i prodhimit 1989. Deklarata doganore nr. R 4966, datë 12.05.2009.

e. Për mjetin me “Kamion i përdorur për mallra” Marka Volvo; Tipi F89; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton. Deklarata doganore nr. R8523, datë 20.12.2006.

Kohëzgjatja e kontratës është deri më datë 14.10.2021.

-Vërtetim zhdoganimi për mjetin “Skrep-Caterpillar” më datë 20.12.2006.

- Deklarata doganore për kamionin Volvo- Vërtetim zhdoganimi 19.12.2006

5. Për Mini Fadromë Bobcat AEMT20, Kontratën e Qerasë (noterisë) nr. 1808 Rep., nr 769 Kol., datë 23.06.2018, deri më datë 23.06.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1808 Rep., e nr. 769 Kol., datë 23.06.20218 “Kontratë qiraje mjeti” e lidhur ndërmjet OE “R.&G.” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

a. Për mjetin “MT”; Bobcat; Tip-S300; Shasia 531116185; Viti i prodhimit 2007; targa AEMT20.

6. Për Autobetoniere, me Targë AA793BV, Kontratën e Qerasë (noterisë) me nr 1216 Rep., nr 691 Kol., datë 14.04.2018, deri më datë 13.04.2023.

Në SPE është paraqitur me nr. 1216 Rep., e nr. 691 Kol., datë 18.04.2018 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet OE “F. FH” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa AA793BV, Marka MAN, Tip 33-372; Shasia EMAF099059M156682, Viti i prodhimit 1993.

**Mungon:** Certifika e pronësisë së mjetit; Certifikatën e transportit; Leja e transporti; Licencë transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse; Taksa e vjetore të mjetit dhe fotot (24,000-11,700).

7. Me nr. 210 Rep., e nr. 91 Kol., datë 19.01.2021 “Prokurë e posaçme” e lidhur ndërmjet OE “A...” Shpk dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetin:

1. Për mjetin “Autobot”; Targa AA203EZ; Marka Mercedes Benz; Tip 813D; Shasia 31805114159565; Viti i prodhimit 1986. **24 ton (7,490-4,660)**

**8. Eskavator me Goma** LU 9705 B Nr 4115 Rep Nr 2413 Kol 04.12.2017 03.12.2022

Në SPE është paraqitur me nr. 4115 Rep., e nr. 2413 Kol., datë 04.12.2017 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet PF N... L... dhe OE “A..A..C” Shpk për mjetin me Targa LU9705B, Marka JCB, Tip 3CX97TP; Shasia 0475423, Viti i prodhimit 1998. Është paraqitur vetëm leja e qarkullimit nr. LU0004150.

9.Me nr. 4005 Rep., e nr. 2346 Kol., datë 14.10.2017 “Kontratë qiraje mjetesh” e lidhur ndërmjet PF K... C... dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

1. Për mjetin “APV”; Targa AA147RB; Marka Astra; Tip BM21F/BM21; Shasia 41623; Viti i prodhimit 1977. Leje qarkullimi me nr. VLF0600316.

Siguracioni ka përfunduar më datë 07.06.2021. Kontrolli Teknik ka përfunduar më datë 25.06.2021. Certifikata e Kontrollit Teknik (tahografit) ka përfunduar më datë 09.06.2021.

2. Për mjetin “Kamion”; Targa AA672IV; Marka Iveco Fiat; Tip A1HC/135-17; Shasia VF5a1HC0001105334; Viti i prodhimit 1985. **8 ton (13,300-5,300).**

Cetrtifikatë me nr. 108, datë 12.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Bashkia Vlorë për mjetin Iveco Fiat me targë AA672IV + Foto.

**Foto e mjetit** “Kamion Iveco” me targë AA672IV.

**Foto e mjetit-auto vinç- ASTRA me targë AA147RB - (vetëm foto).**

10. Me nr. 289 Rep., e nr. 126 Kol., datë 26.01.2021 “Kontratë qiraje – Pasuri të luajtshme” e lidhur ndërmjet PF L... F...dhe OE “A..A..C” Shpk, për mjetet:

1. Për mjetin “Kamion” Marka Volvo; Tipi FL6; Viti i prodhimit 2009; Shasia YV2TN12A59B548691; Kapaciteti 12 ton.

2. Për mjetin “Eskavator Bobcat” Tipi 341; Seria 14208; Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

3.Për mjetin me “Minieskavator” Marka Janmar; Tipi B22-2; Shasia 31055B. Viti i prodhimit 1989; Kapaciteti 12 ton.

Cetrifikatë me nr. 066, datë 09.07.2021 “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet” dhënë nga Fier për mjetin Volvo FL6 me targë AB310CA për “A..A..C” Shpk **Foto nuk ka.**

**Në këto rrethana ky OE** nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të DT.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me përgjegjësi: anëtarët e KVO z. **A..B..** , z. **E..M..** e z. **K..K.**

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **4,967,800 lekë pa Tvsh.**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues OE “A..A..C” Shpk, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **5,961,360 lekë me Tvsh.**

### **Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 456 prot., datë 08.11.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B...B... dhe Operatorit Ekonomik OE “A..A..C” Shpk me përfaqësues ligjor z. A.G., me objekt: “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje lerash”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **5,961,360 (pesë milion enëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tre qind e gjashtëdhjetë) lekë me Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “A..A..C” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **4,967,800 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët NJHDT: z. **A..G..**, z. **O..V..** e z. **U..D..** dhe KVO: z. **A..B..** , z. **L..M..** e z. **K..K...**

### **VII. “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë.**

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë, viti 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 70 datë 12.10.2021	2. Njësia e Prokurimit: 1. A..G.. 2. O..V.. 3. U..D..	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave- Urdhër nr. 78, datë 25.10.2021: 1. K..K.. (Kryetar) 2. A..B.. (Anëtare) 3. L..M.. (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 5,799,700lekë	6. Oferta fituese: OE “L...” Shpk, vlera e ofertës 5,680,639 lekë pa Tvsh	7. Diferenca me fondin limit 119,061 lekë
8. Data e hapjes së ofertave: 16.11.2021	9. Burimi Financimit: Nga buxheti i bashkisë (të ardhurat + transferata e pakushtëzuar)	10. Operatorët Ekonomikë OE “L...” shpk
11. Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka
b. Kontrata nr. 474 prot., datë 22.12.2021		
14. Lidhja e kontratës 22.12.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	6,816,767

Me Urdhërin e prokurimit me nr. 70 e nr. 324 Prot., datë 12.10.2021, ku është urdhëruar procedura e prokurimit, fondi limit, lloji i procedurës së prokurimit dhe Komisioni i Hartimit të DT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D..

- Urdhëri i Titullarit të AK për ngritje e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 78 e nr. 346 Prot., datë 25.10.2021, ku KVO përbëhet nga: z. A..B.. (Kryetar); z. E..M.. (Anëtar) e z. K..K.. (Anëtar).

- Urdhëri i Titullarit të AK për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave z. E..M.. me z. L..M..

**Hartimi fondit limit:** Projekt zbatimi, grafiku i punimeve, project preventive dhe përllogaritja e fondit limit është realizuar, nga Ing. S..K.. dhe ing. Topograf E..M., miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. J..G..

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të Dokumenteve të Tenderit me nr. 374 prot., datë 03.11.2021, formular/nënshkruar nga anëtarët e NJP. Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DT.

Duke ju referuar buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021 për nevojat e Autoritetit Kontraktor, bazuar në fushën e veprimtarisë së Institucionit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Himarë nr. 66, datë 21.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Himarë për vitin 2021” fond limit **5,799,700 (pesë milion e shtatëqindë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind lekë pa Tvsh** për objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë.

Me Procesverbalin nr. 348 prot., datë 03.1.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” formular/nënshkruar nga anëtarët e NJP.

**Ndryshime në DT: Shtojca 7, datë 05.10.2021 në SPE.**

Nga asistenca e APP i është dërguar më datë 09.11.2021, elektronikisht në lidhje me procedurën e prokurimit të shpallura në SPE me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, me fond limit **5,799,700 lekë pa Tvsh**, autoritetit kontraktor **Bashkia Himarë, në lidhje me procedurën me REF-10289-11-03-202**, në lidhje me disa konstatime në DT.

**Titulli i gjetjes 27:** Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës.

AK në hartimin e, kriteret nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

**Situata:**

**1.Në pikën 2.3.2/1**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

*Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencën e shoqërisë, e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

**Kategoria NP-11 Ndërtime për n/stacionet, kabina e transformimit etj. Klasifikimi A**

**Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike Klasifikimi A**  
*sipas modelit të lëshuar nga MPPT”.*

Referuar punimeve të përfshira në DT të procedurës, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojin e punimeve të përfshirë në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së



licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”.

**2. Në pikën 5/a**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori duhet të ketë pjesë të stafit: a. Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij, si drejtues teknik, nga muaji Janar 2021 – Gusht 2021 personelin si më poshtë:*

- 1 (një) inxhinier Elektriqe

- **1 (një) inxhinier Gjeodet**

- **1 (një) inxhinier Hidroteknik**

*Për inxhinierat pjesë e stafit si drejtues teknik, të cilët duhet detyrimisht të jenë të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme, duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohë të plotë) me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt **Diploma, Libreze pune dhe CV**”.*

Në lidhje me kërkesën përdrejtues teknik në licencën e shoqërisë inxhinier Gjeodete Inxhinier Hidroteknik duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërcituar.

Kriteret për inxhinierët, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

**3. Në pikën 2.3.6**, të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportimin e mbetjeve urbane” dhe Kodi 1.2.A “Licenca për mbrojtjen nga zjarri” (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, të paktën njeri nga anëtarët duhet të ketë licencën profesionale sa më sipër)”.*

Lidhur me vendosjen e kriterit për licencat e sipërcituara, nga AK nuk është konsideruar:

- tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet,

- zbatimin e përcaktimeve të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 që parashikon se “...çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje dhe i lidhur ngushtë me natyrën e kontratës”, e për rrjedhim, kërkesa për licencat e mësipërme nuk përkonë me tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet;

- ekspertiza profesionale në fjalë është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit dhe relacioneve teknike, për rrjedhojë vendosja e kërkesës së mësipërme është e nevojshme për realizimin e kontratës.

- garantimi i realizimit të punimeve respektive në fazën e zbatimit, **nëse kërkohet**, mund të përmbushet edhe nëpërmjet disponimit nga ofertuesit të ekspertit individ të certifikuar.

**4. Në pikën 4**, të Kapacitetit teknik, AK në DT është kërkuar: “*Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht jo më pak se 25 (njetetë e pesë) punonjës të siguruar për tre muajt e fundit të vërtetuar me;*

*Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e mësipërme.*

*Liste pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin nga muajt në periudhën e mësipërme”.*

Në lidhje me numrin e kërkuar **25 (njetetë e pesë)** punonjës, duke ju referuar tipologjisë së objektit të kontratës që prokurohet dhe punimet e përfshira në preventiv, nga AK nuk është argumentuar e nuk është në përputhje me;

- Pikën 1, të nenit 77 të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të “Për rregullat e prokurimit publik”, që çdo kriter duhet të jetë në përpjesëtim i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe faktin se, vendosja e këtij kriteri sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë Kapacitetin Teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter.

- Pikën 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “...Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

- Pikën 6/ç, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku parashikohet se: “*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”.

Kriteri për fuqinë punëtore i shërben autoritetit kontraktor për të provuar vetëm kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, që vlerësohen të nevojshme për të realizuar kontratën që prokurohet. Ky kriter nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit.

**5. Në pikën 5/b,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: **Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diplomë, CV si dhe librezë pune**”.*

Nuk është argumentuar, referuar Kreut I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku parashikohet se, për punime mbi 30,000,000 lekë është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohësi pranishëm në kantier.

**6. Në pikën 5/c,** të kapacitetit teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:*

*-1 (një) punonjës i cili të disponojë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, dëshmuar me kontratë pune (e vlefshme), si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit.*

*-1 (një) punonjës specialist për dhënien e ndihmes së parë, dëshmuar me kontratë pune dhe certifikatë të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptarë si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit.*

*-1 (një) punonjës specialist ekspert zjarrëfikues në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dëshmuar me kontratë pune dhe certifikatë përkatëse e dhënë nga Drejtoria MZSH si dhe të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit”.*

Referuarobjektit të kësaj kontrate dhe punimet konkrete që do të kryhen, të përfshira në preventivin e punimeve. Disponimi i punonjësve të cituar nuk është argumentuar domosdoshmëria dhe kualifikimi i punonjësve për realizimin e kontratës, veprim në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”.

*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

**7. Në pikën 5/d,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 10 punonjës elektrikistë të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshurara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001, i ndryshuar, nga të cilët, 3 punonjës të kenë grupin e IV-ët ose të V-të të sigurimit teknik, 4 punonjës grupin e III-të të sigurimit teknik dhe pjesa e mbetur grupin e I-rë ose të II-të të sigurimit teknik.*

*\*Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kartelat përkatëse të sigurimit teknik (të vlefshme) dhe kontratat individuale të punës. Këta punonjës duhet të figuroj në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit”.*

Përcaktimet specifike për kategoritë e punonjësve sipas grupeve, në vlerësim të faktit se:

- OE ofertues mund të disponojnë specialistët e kërkuar sipas profileve edhe në grupe/kategori më të larta se ato të përcaktuara në kriter;

- Kombinimi ndërmjet numrit të punonjësve dhe grupeve/klasifikimeve që ato duhet të disponojnë, sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se disponojnë kapacitetin përkatës të nevojshëm dhe mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Ky kriter nuk është argumentuar, e nuk është në përputhje me n e përcaktimeve të nenit 77, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, që cdo kriter i veçantë duhet të jetë në

përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, si dhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

**8. Në Pikën 5/e,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Në lidhje me manovratorët e makinerive të renda të paraqiten dëshmitë e drejtimit të lëshuar nga institucioni përkatëse, për të paktën 2 (dy) manovratorë. Gjithashtu të ketë dhe 2 (dy) shofer, për të cilët duhet të paraqiten edhe kontratat individuale të punës si dhe të jenë të përfshirë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit”.

Referuar vendosjen e kriterit që manovratori dhe shoferi të disponohen në listpagesa për periudhën 3 muajt e fundit, nuk është marrë në konsideratë mundësia që makineritë dhe pajisjet të cilat duhet të disponojë OE pjesëmarrës për ekzekutimin e kontratës, kërkohet të jenë në pronësi ose me qera. Rrjedhimisht, në rastin kur makineritë disponohen me qera, kriterit i disponimit të drejtuesve të mjeteve në listpagesat e shoqërisë, është i panevojshëm pasi ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.

**9. Në Pikën 5/f,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë, dhe ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar). Për të cilin duhet të paraqiten: Kontratë individuale të punës, Diplomë, Urdhër Mjeku si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit”.

Në lidhje me kërkesën për disponimin në listëpagesa të një mjeku, nuk i përmbahet përcaktimeve të VKM nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Kriteri për disponimin e mjekut në listëpagesa dhe vetëm nëpërmjet kontratës individuale të punës, nuk i përmbahet akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për sigurimin e këtij shërbimi me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

**10. Në pikën 2.3.5,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizat e çmimeve për të gjitha zërat e preventivit, plan – organizim dhe metodologjinë e punimeve në objekt sipas kërkesave të përcaktuara nga KTP dhe KTZ në fuqi”.

Kërkesa për paraqitjen e planorganizimi dhe metodologjisë së punimeve, si kërkesë e veçantë për kualifikim, nuk i përmbahet përcaktimeve të 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për rregullat e prokurimit publik”. pasi nuk është e qartë si do shërbejë për kualifikimin e ofertuesve, ndërkohë që kriteri i përzgjedhjes së fituesit është oferta ekonomikisht më e favorshme e bazuar në çmim.

**11. Në pikën 2.3.7,** të Kapacitetit Teknik, në DT është kërkuar: “Do të organizohet një vizitë në kantier 3 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e tub fleksibël, shtylla metalike, elektroda tokezimi, të shoqëruara me raport testimet përkatëse, si dhe me Certifikatën ISO 9001 të prodhuesit. Operatorët ekonomik të interesuar gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë dhe shpjegime ku do të pajisen edhe me vërtetim nga insitucioni, të cilat do të paraqiten në tender dhe përbëjnë kusht s’kualifikimi”.

Në pikën 2.17.1, të DT, në seksionin përkatës “Vizitë në kantier”, AK ka përcaktuar që nuk do të organizohet një vizitë në kantier, ndërkohë që në pikën 2.3.7, të kapaciteti Teknik përcakton që do të organizohet një vizitë në kantier 3 ditë para zhvillimit të tenderit, në orën 10:00 pranë AK.

Konsiderohet që në DT janë të gjitha informacionet e nevojshëm për realizimin e kontratës. Kërkesa e sipërcituar nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 5, të nenit 24, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

“Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të organizojë një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, autoriteti/enti

kontraktor mund të organizojë një konferencë paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve.

Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit/entit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit. Në rastin e procedurave të prokurimit me mjete elektronike, kërkesat për sqarim bëhen sipas udhëzimeve të APP-së.”

Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e mostrave, nuk janë në përputhje me përcaktimet e pikës 6/a, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku përcaktohet se AK kërkon “mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat.”

Në çdo rast, OE pjesëmarrës dorëzohet fizikisht mostrat/kampionët e mallit vetëm në datën e hapjes së tenderit, ndërsa dokumentacioni shoqëruar, dorëzohet vetëm elektronikisht.

Në lidhje me kërkesën për certifikatën e cilësisë së prodhuesit, operatorët ekonomikë ofertues në procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre. Në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatave të cilësisë, i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

**B.Kritere që krijojnë probleme për plotësim nga OE konkurues dhe mbarten edhe në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kriterit nga KVO.**

**1.Në pikën 2.2.4,** të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, në DT është kërkuar: “Në mënyrë që ofertuesi/sit (në rast bashkimi OE), të kenë akses pjesëmarrje në prokurimin publik të institucionit tonë prokurues, ai/ata nuk duhet të jenë dhe të figurojnë debitor në këtë institucion. Për plotësimin e këtij kushti duhet të paraqitet ërteretim nga Bashkia Himarë se nuk ka detyrime të pa likuiduara”.

Ky kriter nuk është i argumentuar ligjërisht duke mbajtur në konsideratë që:

- kushtet e kualifikimit dhe të skualifikimit të ofertuesve janë parashikuar në nenin 77 dhe 76 të LPP,
- penalitetet në lidhje me mosshlyerjen e debive që një subjekt mund të ketë, adresohen nga dhe nëpërmjet dispozitave në fuqi për fushën respektive ku detyrimet trajtohen.

**2.Në pikën 2,** të Kapacitetit Teknik, AK në DT është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Certifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) e përditësuar

ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) e përditësuar

OHSAS 18001:2007 ose OHSAS 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)

PAS 99:2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar);

ISO 50001:2011 (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë)

ISO 39001:2012 (Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor)”.

Vendosja e kërkesave për certifikatat e sipërcituara nuk janë në përputhje me përcaktimet e nenit 44, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku parashikohet që: “Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

**3. Në dokumentet e tenderit mungojnë Specifikimet Teknike.**

Veprim në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3/a të nenit 15, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;

- preventivin e hollësishëm dhe kostot;

- grafikun e zbatimit;

- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit”,

AK duhet të plotësojë dokumentet, me të dhënat e nevojshme të cilat do t'i shërbejnë ofertuesve për të hartuar një ofertë të përgjegjshme.

### **- Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO me nr. 414 prot., datë 24.11.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë me vlerë ekonomike e të ofruar:

**1. OE “L...” Shpk** (me NIPT: K...C).Oferta, me vlerë ekonomike **5,680,639** (*pesë milion e gjashtëqindë e tetëdhjetë mijë e gjashtëqindë e tridhjetë e nëntë*) **lekë pa Tvsh.**

Në dosjen e procedurës së prokurimi gjenden me nr. 415 prot., datë 24.11.2021 “Formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes”, formular/nënshkruar nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe dhe KVO.

Procesverbali i KVO me nr. 414 prot., datë 24.11.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është kualifikuar OE, dhe është shpallur oferta e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT, paraqitur nga OE “L...” Shpk.

Raporti përmbledhës me nr. 442 prot., datë 03.12.2021, miratuar nga i titullarit të AK znj. B...B... Formulari i Njoftimit të kontratës së nënshkruar me nr. 346 prot., datë 20.12.2021.

Në dosjen e prokurimit gjendet vërtetimi me nr. 284 Prot., datë 24.09.2021 Me anë të cilit vërtetohet që: OE “L...” Shpk, ka depozituar pranë Bashkisë Himarë, materialet për tubo çeliku të shoqëruar me dokumentacionin teknik.

Dokumentacioni i dorëzimit të mostrave dhe materialet tubo çeliku janë sipas kërkesave tëpercaktuara në DT.

**Kriteri:** Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

**Shkaku:** Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: z. A.G., z. O.V. e z. U.D.**

**Ndikimi:** Kufizimi ipjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën

**Rëndësia:**E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

### **Lidhja e kontratës:**

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 474 prot., datë 22.12.2021, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetar znj. B...B... dhe OE “L...” Shpk, me administrator z. J. L. me objekt: “*Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç*”, Bashkia Himarë, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **6,816,766** (*gjashtë milion e tetë qind e gjashtëdhjetë mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tetë*) **lekë me Tvsh.**

**Konkluzioni:** Procedura paraqitet probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të OE “L...” Shpk. duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët **NJHDT: z. A..G., z. O..V.. e z. U..D.**

## 2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

### **1. Zbatimi i punimeve në objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, Bashkia Himarë.**

#### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 474 prot datë 15.12.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetari znj. B...B... dhe OE “L...” Shpk, me administrator z. J... L..., me licencë profesionale NZ 3386/8, datë 07.04.2020. Vlera e kontratës është 6,816,766 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga momenti i fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 136 prot., datë 15.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Personin Fizik ing. G. K., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3579, datë 26.06.2020.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “K. C.” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .3596, datë 08.09.2020.

#### **Projektpreventivi**

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Himarë nga grupi i projektimit i përbërë prej ing. S..K., Ing. Topograf E..M.. është i miratuar nga titullari i Bashkisë Himarë, z. J.G.

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, nga Titullari i Bashkisë Himarë Z. J..G., nuk është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, për zhvilluesin Bashkia Kolonjë.

Ky veprim dhe mosveprim është në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Himarë.

**Titulli i gjetjes 28:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për realizimin e objektit: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, Bashkia Himarë.

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, janë realizuar punimet në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Himarë.

**Kriteri:** Realizim i punimeve të ndërtimit sipas projektit pa leje ndërtimi, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”  
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

**Ndikimi:** Realizimi i projektit të zbatimit të ndërtimit pa leje ndërtimi.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Himarë.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Himarë të marrë masa që të pajisin me leje ndërtimi për çdo projekt zbatimi në punimet e ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi.

Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Himarë nga grupi i projektimit i përbërë prej ing. S..K., Ing. Topograf E..M.. është i miratuar nga titullari i Bashkisë Himarë, z. J..G...

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se fillimi i punimeve më datë 10.01.2022 dhe kanë përfunduar më datë 20.06.2020. Periudha e garancisë së punimeve është 12 (muaj) deri më datë 05.08.2023.

Gjatë verifikimeve në teren, dhe azhurnimit topografik si dhe tabelave të volumeve për zërat kryesor të punimeve, rezulton se në projekt preventivin e këtij objekti kërkohen rishikime apo përmirësime (zbritjedhe shtesa të volumeve të punimeve). Ndryshimet apo rishikimi projektit dhe preventivit të kontratës kaardhur si rezultat gjendjes faktike në terren.

Fondi rezervë në preventiv është në vlerën 205,507 lekë pa Tvsh dhe janë përdorur 260,741 lekë pa Tvsh. Ky fond është miratuar nga Bashkia Himarë me shkresënr. 1762/5 prot., datë 08.06.2022 Punimet janë realizuar brënda vlerës së kontratës duke përdorur edhe Fondin Rezervë të objektit. Vlera e Preventivit të Rishikuar përfshirë edhe përdorimin e Fondit Rezervë është 6,805,048.38 (gjashtëmiljon e tetëqind e pesëmijë e dyzetë e tetë, pikë tridhjetë e tetë) lekë me Tvsh.

Për defektet e mundëshme në objekt si pasojë e punës së OE “L..” Shpkriparimet do të kryhen sipas kontratës së nënshkruar me fondin 5% të garancisë së punimeve.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk është cituar në asnjë kontratë afati i garancisë së punimeve por është 12 (dymbëdhjetë) muaj

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, Bashkia Himarë				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 2134/6 prot datë 20.12.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 8,816,401.30 lekë <b>OE fitues “L..” Shpk</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>	
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> <b>-Vlera me tvsh 6,805,048 lekë</b>	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 120 ditë. Fillimi punimeve: 10.04.2022 Përfundimi punimeve: 20.06.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b>	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE G.K.	Licenca Nr: MK 3579	Kontrata me nr. 157 prot., datë 29.12.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “K.Co” Shpk	Licenca Nr: MK 3596	Kontrata nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2021	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 16.08.2021	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 23.06.2022		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **598,424 lekë pa Tvsh**.

**Titulli i Gjetjes 29:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, Bashkia Himarë, nga zbatuesi i punimeve OE fitues “L..” Shpk, për zërin e punimeve 8, dhe 10.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve “F.V Morseteri shtyllë 4P + sig + Kapak”, “F.V. elektroda tokëzimi të xinguar 50x30mm L=150 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
  - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
  - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 474 prot, datë 22.12.2021.
  - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 157 prot, datë 29.12.2021.
  - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2022.
- Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Himarë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej lekë 598,424pa tvsh nga OE fitues “L..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 474 prot datë 22.12.2021 me “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Vlera prej 598,424lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Himarë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. G. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. I. A. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 1024/7prot., datë 12.04.2023, është paraqitur observacioni nga z. G.. K..., Mbikëqyrësi i Punimeve për objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë.

**Pretendimet e subjektit:**

*Siç përshkruhet në Akt Konstatimi, unë në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve kam realizuar këtë detyrë për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 136 prot., datë 15.12.2021, të lidhur me kontratën me nr. 157 prot., datë 29.12.2021 të këtij shërbimi midis meje Person Fizik ing. G... K..., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3579, dhe Bashkisë Himarë me datë 26.06.2020.*

*Me anë të kësaj përgjigjeje unë kundërshtoj konkluzionet e nxjerra nga grupi i auditimit të KLSH dhe më poshtë do të rrjeshtoj arsyet e këtij kundërshtimi.*

*Unë deklaroj me përgjegjësi të plotë që nga ana ime, në rolin e caktuar si Mbikëqyrësi i Punimeve për objektin: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”, Bashkia Himarë, janë kryerme përpikmëri të gjitha detyrimet që lindin nga kjo marrëveshje dhe nga pasojat ligjore të saj.*

*Janë ndjekur të gjitha hapat e procedurës së mbikëqyrjes nga ana ime me kontrollet në terren dhe me dokumentacionin e dorëzuar sipas rregullave përkatëse për mbikëqyrjen e punimeve.*

*Së pari, deklaroj që këto 2 zëra janë instaluar nga zbatuesi i punimeve në objekt dhenë vizitën time të fundit madje është bërë edhe matja e tokëzimit (cili nuk realizohet pa elektroda tokëzimi). Zëri “Elektroda tokëzimi të xinkuara” është aplikuar për cdo shtyllë nganjë elektrode dhe këto elektroda janë ngulur në tokë pikërisht në kutitë shpërndarëse*



të instaluar në beton pranë cdo shtylle. Poshtë kapakut të pusëtës janë elektrodën e tokëzimit.

Zëri “Morseteri shtylle 4P+ sig+Kapak” është pjesë e cdo shtylle e cila afër fundit të saj, në lartësinë 60 -70 cm ka një kapak të mbyllur me vida. Këto që unë them më lart, vërtetohen nga fotografitë e bëra në objekt, një pjesë e të cilave janë dorëzuar edhe në dosjen përfundimtare të objektit. Gjithashtu disa nga këto foto do ti gjeni attached në këtë dokument.

Së dyti, punimet kanë mbaruar, janë marrë në dorëzim dhe është dorëzuar dosja e plotë në Bashkinë Himarë që me datë 23.06.2022. Që nga kjo datë e në vazhdim unë nuk kam qenë prezent në objektin në fjalë dhe mendoj që nuk jam aspak përgjegjës nëse zërat e sipërpërmendur gjenden apo nuk gjenden në objekt në këto ditë që flasim. Unë nuk e di si është gjendja aktuale e investimit pas dorëzimit të punimeve dhe realisht në këto momente nuk mund ta them dot pa e verifikuar nëse gjenden apo nuk gjenden zërat në objekt.

### **Qëndrimi i Audituesve të KLSH:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

Nga grupi i auditimit është konstatuar qëndrimi i fshtit Kuç, Bashkia Himarë nuk funksionon, kur objekti ishte brenda garancisë së punimeve.

Bashkia Himarë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve si dhe grupin e marrjes në dorëzim të punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori i punimeve si dhe grupi i marrjes në dorëzim të punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë më datë 23.06.2023. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve dhe vënies në funksion e objektit, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

## **2.Zbatimi i punimeve në objektin: “Rikonstruktion i ujësjellësit Pigeras”, Bashkia Himarë.**

### **Kontratat**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 460 prot datë 15.12.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga zv. Kryetari znj. B...B... dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “K..I..” Shpk & “I...” Shpk, me përfaqësues OE “K..I..” Shpk me administrator z. S... K..., me licencë profesionale NZ 8308, datë 03.11.2021. Vlera e kontratës është 11,108,665 lekë me TVSH, financim i vitit 2021. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 2 (dy) muaj nga momenti i fillimit të punimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 136 prot., datë 15.12.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Personin Fizik ing. N... M...j, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .0992/3, datë 23.04.2019.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “K.. C...” Shpk, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. .3596, datë 08.09.2020.

### **Projektpreventivi**

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Bashkia Himarë nga grupi i projektimit i përbërë prej ing. S..K., Ing. Topograf E..M.. është i miratuar nga titullari i Bashkisë Himarë, z. J..G...

**Titulli i gjetjes 30:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për realizimin e objektit: “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë pa Leje Ndërtimi Infrastrukturore, për zhvilluesin Bashkia Himarë.

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objektin: “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, janë realizuar punimet në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Himarë.

**Kriteri:** Realizim i punimeve të ndërtimit sipas projektit pa leje ndërtimi, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

**Ndikimi:** Realizimi i projektit të zbatimit pa leje ndërtimi.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Himarë.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandime:** Bashkia Himarë të marrë masa që të pajisin me leje ndërtimi për çdo projekt zbatimi në punimet e ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi.

*Për veprimin e mësipërm ngarkohet me përgjegjësi e Titullarit të Autoritetin Kontraktor z. J..G..*

#### Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se fillimi i punimeve më datë 15.12.2022 dhe dhe kanë përfunduar më datë 24.03.2022

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

14. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës së lumit Borsh”, Bashkia Himarë				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 2134/6 prot datë 15.12.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 8,816,401.30 lekë <b>BOE fitues “K..I..” Shpk &amp; “L..” Shpk</b>		<b>16. Likuiduar deri dt</b>	
<b>17. Situacioni Përfundimtar</b> -Vlera me tvsh 11,107,780.60 lekë -Vlera pa tvsh 129,159,596 lekë	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 69 ditë. Fillimi punimeve: 15.12.2021 Përfundimi punimeve : 24.03.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendamenti nr. 1, zgjatja e kontratës deri më datë 24.03.2022	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “N..... M...” SHPK	Licenca Nr: MK 0093/2	Kontrata me nr. 136 prot., datë 15.12.2021	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “F...” SHPK	Licenca Nr: MK 3596	Kontrata nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2022	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 12.08.2021	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> Datë 12.05.2022		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **951,232 lekë pa Tvsh**.

**Titulli i Gjetjes 31:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, nga zbatuesi i punimeve OE fitues “L..” SHPK, për zërin e punimeve 8, dhe 10.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve: “F.V Gabiona me gurë 1x1x2m, me rrjetë xingato me elektrosaldim Ø 3.5 mm, me karkasë hekuri 10mm”, “Sistemim, nivelim dhe pasurim me humus”, “Mbjellje bari”, “F.V. Fidane Peme dekorative”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 460 prot, datë 15.12.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 136 prot, datë 15.12.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 1861/4 prot., datë 14.04.2022.

**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Himarë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej lekë 951,232.26pa Tvsh nga BOE fitues “K..I.” Shpk & “I..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot datë 15.12.2021 me “Mbrotjtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

*Vlera prej 951,232 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Himarë.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. N... M... me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;

2. Z. I... A... me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**3. Zbatimi i punimeve në objektin: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë.**

- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;

- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, i ndryshuar.

- UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;

- Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

- Dokumentacioni i tenderit si pjesë përbërëse e kontratës.

- Dokumentacioni tekniko ligjor i ndodhur në dosjen e zbatimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

### Kontratat

1. Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë, të përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. B...B... dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “K.. G..K..” Shpk & “M../S...” Shpk, me përfaqësues ligjor z. H...S... , me licencë profesionale respektive NZ. 0485/23, datë 06.12.2018 dhe NZ.0440/25, datë 22.01.2021. Vlera e kontratës është **162,037,037 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e tridhjetë e shtatë mijë tridhjetë e shtatë), lekë pa Tvsh 194,444,444 lekë me Tvsh**. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 9 (nëntë) muaj duke filluar nga nënshkrimi i kontratës. Periudha e garancisë të punimeve nuk është cituar në kontratë.

2. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës nr. 333 prot., datë 15.10.2021, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “N... G..” Shpk, (me NIPT: L...P), me përfaqësues ligjor respektiv z. V... B... me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/12, datë 18.06.2021, me vlerë të kontratës së shërbimit **2,747,644 (dy milion e shtatëqind e dyzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzetë e katër) lekë me Tvsh**.

Me nr. 613/14 prot., datë 28.06.2022, Amendimi për shtesë kontrate, mbështetet në kërkesën e sipërmarrësit të punimeve për shtyrjen e afatit të punimeve në objektin të kontratës për punë nr. 229 prot., 07.09.2021, afati i punimeve shtyhet me 4 (tre) muaj. Përfundimi i punimeve në këtë objekt ishte 25.02.2022, bëhet 23.05.2022.

3. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës nr. 613/32 Prot, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “Studio R...-G...” Shpk (me NIPT – L.....M), përfaqësuar nga z. L... B... me licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 324, datë 14.05.2018, me vlerë të kontratës së shërbimit **83,333 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh**.

Akti i Kolaudimit më datë 15.11.2022 (me nr. 613/33 prot., datë 27.12.2022 në Bashkinë Himarë). Me urdhërin nr. 368 e nr. 613/34 prot., datë 28.12.2022 “Për ngritjen e komisionit për marrjen e përkohshme në dorëzim të punimeve” është ngarkuar: 1. Z. D... B..., 2. Z. A... B...e z. E...L....

4. Me shkresë nr. 613/35 prot., datë 28.12.2022 është bërë bërë marrja në dorëzim të parakohshme të investimit me objekt “Ndërtim i ujësjellësit të fshatit Vranisht” Bashkia Himarë, në administrimin e shfrytëzimit paraprak nga AK.

Punimet kanë filluar më datë 16.10.2021.

Data e përfundimit të punimeve 15.11.2022.

Afati sipas kontratës fillestare 9 (nëntë) muaj- 270 ditë

Afati sipas kontratës me shtesën: 4 (katër) muaj, 120 ditë.

Ndërprerje punimesh 16 ditë

Afati sipas faktit 13 muaj + 16 ditë (406 ditë)

B. Projekti i zbatimit; Leje ndërtimi; Oponencë teknike, etj.

Projekt preventive, specifikimet teknike dhe raportin teknike i projektit të zbatimit të objektit është hartuar nga Ing. Hidroteknik K..K., me nr. Licence H/T/01035, Ing. Hidroteknik F.B. me nr. Licence K.2592 e Ing. Hidroteknik S... N.... Relacioni Teknik në vitin 2016.

Detyra e projektimit është hartuar nga Ing. E..M.. e miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. J..G...

**Titulli i Gjetjes 32:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për realizimin e objektit: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, u konstatua që realizim i projektit pa oponencë teknike dhe pa leje ndërtimi infrastrukurore, për zhvilluesin Bashkia Himarë.

**Situata:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, nuk ka kryer oponencën teknike dhe leje

ndërtimor për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, ku përcakton se: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve”.

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 6 kreu III, neni 15, pika 1, i ndryshuar, në Urdhrin e Ministrit nr. 197, datë 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë duke mos kryer Oponencën Teknike të Projektit të Zbatimit me vlerë të preventivuar mbi 100 milionë lekë.

Realizimi i punimeve në kundërshtim, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, sa më sipër përbën kundërvajtje administrative. Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë.

**Kriteri:** Realizim i punimeve të ndërtimit pa kryer oponencë teknike, dhe leje ndërtimore, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, kreun III, neni 15, pika 1, i ndryshuar.

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”

**Ndikimi:** Realizimi i projektit të zbatimit pa oponencë teknike dhe gjithashtu procedura e prokurimit është zhvilluar pa disponimin e saj dhe pa leje dërtimi në infrastrukturë.

**Shkaku:** Neglizhencë e Bashkisë Himarë.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandime:** Bashkia Himarë të marrë masa që të pajisin me oponencë teknike për çdo projekt zbatimi me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë dhe leje ndërtimi sipas legjislacionit në fuqi.

Me nr. 613 prot., datë 20.06.2022 “Kërkesa për zgjatjen e afatit të zbatimit të punimeve” nga BOE “K... G... K...” Shpk & “M.../S...” Shpk drejtuar mbikqyrësit të punimeve OE “N... G...” Shpk, për dijeni Bashkisë Himarë.

Zbatimi i punimeve

- Njoftimi për fillimin e punimeve me nr. 4116 prot., datë 28.09.2021, nga BOE “K... G... Konstruksion” Shpk & “M.../S...” Shpk drejtuar mbikqyrësit të punimeve OE “N... G...” Shpk, për dijeni Bashkisë Himarë.

Me nr. 613/17 prot., datë 09.08.2022 urdhëri për pezullimin e përkoshëm të punimeve nga Titullari i A, Z. J..G., deri në trajtimin e kërkesës së mbikqyrësit të punimeve me nr. 10/8 prot., datë 04.07.2022 “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale” me nr. 613/15 prot., datë 01.08.2022 na Bashkinë Himarë.

Njoftimi i përfundimit të punimeve nga me nr. 613/26 prot., datë 10.11. 2021, nga BOE “K..G..K...” Shpk & “M.../S...” Shpk drejtuar mbikqyrësit të punimeve OE “N...G...” Shpk, për dijeni Bashkisë Himarë.

-Njoftimi i përfundimit të punimeve nga mbikqyrësi me nr. 613/28 prot., datë 16.11.2021, nga mbikqyrësit të punimeve OE “N... G...” Shpk, drejtuar Bashkisë Himarë.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni Teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar, preventive fillestar dhe ai i ripunuar, Situacion përfundimtar, kontrata për punë civile.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

<b>1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve me objekt: “Ndërtim i ujësjellësit të fshatit fshatërave Vranisht”, Bashkia Himarë, Viti 2021</b>				
<b>14. Lidhja e kontratës</b> Nr. 229 prot., datë 07.09.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me tvsh)</b> <b>497,280,095</b> lekë. BOE fitues: “K... G.. K.” Shpk “M...S...” Shpk		<b>16. Likuiduar -----</b> <b>Në aneksin e aktit</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> <b>497,079,737,90</b>	<b>18. Afati i kontratës në ditë</b> Parashikuar 9 (nëntë) muaj. Fillim i punimeve: 16.10.2021 Përfundim i punimeve: 15.11.2022		<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Amendim nr. 613/14 prot., datë 28.06.2022	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “N...-G...” Shpk	Licenca Nr: MK. 1476/12 Dt. 18.06.2021	Kontrata nr. 333 prot., datë 15.10.2021	<b>Vlera (me tvsh) e kontratës:</b> <b>2,747,644</b> lekë	<b>Likuiduar:</b>
<b>21. Kolaudatori i punimeve:</b> OE “S... R...-G...” Shpk	Licenca Nr: MK. 3244 Dt 14.05.2018	Kontrata nr. 229 prot., datë 07.09.2022	<b>Vlera (me tvsh) e kontratës:</b> <b>lekë</b>	<b>Likuiduar:</b>
<b>22. Akt Kolaudimi: datë 27.12.2022</b>	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> datë: 28.12.2022			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferencanë volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,612,310 lekë pa Tvsh.**

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni pjesor	Libri i masave	Fakti	Diferencanë +	
							Vol.	Vlera
<b>II. b Ajruet dhe shkarkues</b>								
2	F.V Të gjitha aksesorët e montimit në pusëtë shkarkuese (saracineska, fllanxa, adapter)	copë	146,000	2	2	1	1	<b>146,000</b>
<b>II.e Rruga b/a që do të ribëhet</b>								
4	F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø 6-10mm (plegma 4kg/m <sup>2</sup> )	Ton	107,000	1.04	1.04	0.32	0.72	77,040
24	Nënshtresë zhavori	m <sup>2</sup>	1,350	108.40	108.40	-	69.40	93,690
								<b>170,730</b>
<b>B. Depo uji 100 m<sup>3</sup></b>								
4	Rrethim i përkohshëm me kollona b/a _+ rrjetë teli	m <sup>2</sup>	1,700	224	224	-	224	391,680
19	Galexhant elektro mekanik DN180, Pn	copë	104,000	1	1	-	<b>1</b>	104,000
14	F.V Kapak inoksi 100x100 me gominë	copë	19,000					19,000
								<b>514,680</b>
<b>Dhoma e manovrimit + klorinimit</b>								
11	F.V saracineskë gize me fllanxa. PN deri 16 bar, Ø 200mm	copë	83,000	2	2	-	2	166,000
15	F.V valvul moskthimi çeliku me fllanxa. PN deri 25 bar, Ø 200mm	copë	103,000	1	1	-	1	103,000
17	Portë metalike me element të galvanizuar me electromotor (5x3m)	total	717,000	1	1	-	1	717,000
								<b>986,000</b>
<b>Rrethim i depos.</b>								
4	F.V. Rrethimi i zinguar, Panel zgare 62x32x25 x2mm, Paneli H1320mm-Kollonë H14000mm, -bulloneri zingato; M10x30mm, Transport +Montim+UPA Metalike.	ml	8,000	160	123.60	90	33.60	<b>268,800</b>
<b>II.e Rruga b/a për në depo</b>								
24	<b>Nënshtresë zhavori</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>1,300</b>	<b>120</b>	<b>120</b>	<b>90</b>	<b>30</b>	<b>39,000</b>
4	F.V Hekur betoni i zakonshëm Ø 6-10mm (plegma 4kg/m <sup>2</sup> )	Ton	107,000	2.40	2.40	0.60	1.80	<b>192,600</b>
								<b>231,600</b>
<b>Rrjeti ajror T.U, me kabëll tip “ABC”</b>								
36	F.V shtylla centrifugale b/a M-300 linja 0.4-10kv, traktor ndërmjet, NH-8m,130/236/5	copë	26,000	9	9	5	4	104,000

39	Transport montim + Transformator fuqie 100KVA.20/10/0.4KV	copë	86,000	1	1	-	1	86,000
								<b>190,000</b>
<b>Punime elektrike në depon e ujit, Brenda e jashtë tij dhe në dhomën e klorinimit</b>								
1	F.V Shtylla metalike për ndriçim, H 7m. d=160mm	copë	19,000	13.3	13.3	9/2	-3.3	<b>104,500</b>
<b>TOTAL</b>								<b>2,612,310</b>

*Vlera prej 2,612,310 pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pa kryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Himarë.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. V.B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. L. B. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

## **2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.**

Bashkia Himarë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, nr. 2, datë 16.10.2017 dhe zbardhur në datë 19.03.2018 (e rishikuar me Projekt-Vendim nr. 5, datë 10.06.2020 dhe Vendim nr. 5, datë. 15.04.2021).

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. *Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.*
2. *Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.*
3. *Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastruktura.*
4. *Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.*

### **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.10.2021 - 31.12.2021**

<b>Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.10.2021 – 31.12.2021 nga sistemi e-Leje</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i lejes</b>	<b>Numri i aplikimeve</b>	<b>Numri i lejeve të miratuara</b>
1	Certifikatë përdorimi	1	0
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	5	1
3	Leje infrastrukture	0	0
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	8	3
5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	0	0
6	Leje për ndryshim funksioni	0	0
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	0	0
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	3	2
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	0	0
11	Leje zhvillimi	1	0
12	Njoftim për fillim punimesh	0	0
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	0	0
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	0	0
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	3	2
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	0	0
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0

Duke ju referuar sistemit “e-Leje” të lejeve të ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Himarë, gjatë periudhës 01.10.2021 deri më 31.12.2021 janë miratuar **8 leje** të ndryshme, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Himarë, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje**, ndërsa leje ndërtimi për

ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **3 leje**, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat	E...D....	17/11/2021	1,180,230
2	Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë	F...M...	10.12.2021	161,973,484
3	Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë	T... G...	24.12.2021	10,230,343
4	Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë	T...G...	24.12.2021	10,230,343
5	Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë, Jalë	J... I...	17.11.2021	635,612,516

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit, u konstatuan 2 praktika, tek të cilat pasqyrohen situata të ngjashme, në lidhje me mosrespektimin e përcaktimeve të ligjeve dhe rregulloreve, në bazë të të cilave DPZHT Himarë kryen aktivitetin e saj. Për të gjitha këto gjetje, Bashkia Himarë ka observuar me të njëjtin argumentim, për këtë arsye, po rendisim më poshtë të gjitha gjetjet në fjalë, dhe në fund po japim argumentimin tonë në lidhje me situatën.

**Titulli i gjetjes 33:** *Mosrespektimi i distancave urbane midis ndërtesës dhe kufirit të pronës.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës nuk janë respektuar sipas kriterëve të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe pika 10, Neni 46 “*Treguesit e distancave*”, Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 4 kateve. Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Duke iu referuar PPV-së, bëjmë përlllogaritjen:  $D_{lejuar} = 17.78 \times 0.4 = 7.1m$ . Nga përlllogaritja e mësipërme dalim në përfundimin se objekti nuk respekton distancat nga kufiri i pronës, më konkretisht: Nga kufiri në Veri – Perëndim,  $D_{miratuar} = 3m$ ; Nga kufiri Jug – Perëndimor,  $D_{miratuar} = 3m$ ; Nga kufiri Jug – Lindor,  $D_{miratuar} = 5m$ .

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “J..I.” Shpk në Jalë, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 6 kateve. Duke iu referuar PPV-së, “*Distanca nga kufiri i pronës llogaritet sipas formulës së mëposhtme:  $d = hst \times 0.4$  (ku  $d$  – është distanca minimale nga kufiri i pronës,  $hst$  – lartësia e ndërtimit të strukturës që propozohet të ndërtohet)*”, bëjmë përlllogaritjen:

-Objekti 6 kate në pjesën veriore:  $D_{lejuar} = 9.2m$ ;  $D_{miratuar} =$  nga 1m deri në 5m.  
 -Objekti 6 kate në pjesën veriore:  $D_{lejuar} = 9.2 m$ ;  $D_{miratuar} =$  nga 5m deri në 9m.  
 -Objekti 1 kat në pjesën qendrore:  $D_{lejuar} = 2m$ ;  $D_{miratuar} = 0m$ .  
 -Objekti 6 kate në pjesën lindore:  $D_{lejuar} = 9.2m$ ;  $D_{miratuar} = 3m$ .  
 -Objekti 6 kate në pjesën lindore:  $D_{lejuar} = 9.2m$ ;  $D_{miratuar} =$  nga 1m deri në 7m.  
 -Objekti 5 kate në pjesën Jug-Lindore:  $D_{lejuar} = 8m$ ;  $D_{miratuar} =$  nga 1m deri në 4m.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këto gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Neni 35, “*Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të



ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

Pika 10, Neni 46, “Treguesit e distancave”, **Plani i Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë:  
- Distanca nga kufiri i pronës llogaritet sipas formulës së mëposhtme:  $d=hst \times 0.4$  (ku d – është distanca minimale nga kufiri i pronës, hst – lartësia e ndërtimit të strukturës që propozohet të ndërtohet).

**Ndikimi:** Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 34:***Mosrespektimi i distancave urbane midis ndërtesës dhe ndërtesave të tjera kufitare.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe ndërtesave të tjera kufitare nuk janë respektuar sipas kriterëve të pikës 2, Neni 34 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Gjetjet e konstatuar u evidentuan në 2 rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 4 kateve. Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga ndërtesave të tjera kufitare përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me ndërtesat e tjera dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus numrin e kateve mbi tokë të ndërtesës kufitare plus 2 metra. Nga përlllogaritja e mësipërme shprehemi se objekti i miratuar nuk ka respektuar distancat urbane ndërtesë - ndërtesë në raport me ndërtesën 4 kate në Veri – Lindje, më konkretisht  $D_{lejuar} = 10m$ , ndërsa  $D_{miratuar} = 4.6 m$ . Edhe pse faqet respektive të objektit të miratuar që përballen me ndërtimin 4 kate janë kallkan, në funksion të pikës 1, Neni 35 të **VKM nr. 408**, datë 13.5.2015: “*Distanca minimale midis dy faqeve, ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij Neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.*”, dalim në përfundimin se distanca e miratuar është në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara. Vlen të theksohet se ndërtesa 4 kate ka çarje në fasadat respektive, gjithashtu nuk kemi asnjë dokumentacion bashkëlidhur që të vërtetojë se ndërtimi 4 kate është ndërtuar në kushtet e paligjshmërisë.

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim Nr. 99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J.I.**” Shpk në Jalë, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 6 kateve. Nga përlllogaritja e mësipërme dalim në përfundimin se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga ndërtimet e tjera kufitare, shprehemi se objekti i miratuar nuk ka respektuar distancat urbane ndërtesë - ndërtesë në raport me vet volumet nga i cili përbëhet ky projekt. DPZHT ka miratuar një leje ndërtimi të një objekti që nuk respekton distancat urbane, sipas përlllogaritjes së më poshtme:

- Nga objekti tjetër 6 kate:  $D_{lejuar} = 14m$ ;  $D_{miratuar} = 3m$ .

- Nga objekti tjetër 6 kate:  $D_{lejuar} = 14m$ ;  $D_{miratuar} = 7m$ .

- Nga objekti tjetër 3 kate:  $D_{\text{lejuar}}= 11\text{m}; D_{\text{miratuar}}= 3\text{m}.$
- Nga objekti tjetër 3 kate:  $D_{\text{lejuar}}= 7\text{m}; D_{\text{miratuar}}= 2\text{m}.$
- Nga objekti tjetër 6 kate:  $D_{\text{lejuar}}= 11\text{m}; D_{\text{miratuar}}= 8\text{m}.$

Edhe pse të gjitha objektet e mësipërme janë pjesë përbërëse e të njëjtit projekt, ky fakt nuk i përjashton ato nga detyrimi për respektimin e distancave urbane ndërtesë – ndërtesë, pasi duhet të garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri, si përcaktohet në pikën 1, Neni 34 të VKM-sënr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këto gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 2, Neni 34, “*Distancat minimale midis ndërtimeve*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:

$d = nr. k \text{ obj.A} + nr. k \text{ obj.B} + 2\text{m}, \text{ ku:}$

$d$  - distanca minimale midis dy ndërtimeve.

$nr. k$  - numri i kateve

Pika 7, Neni 46, “*Treguesit e distancave*”, **Plani i Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë:

- Për përcaktimin e distancave ndërtesë – ndërtesë, ndërtesë – rrugë dhe ndërtesë – kufij prone, në projektim, do të zbatohen normat minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtim të rasteve kur PPV propozon distanca të tjera më të mëdha se minimumi i parashikuar.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i distancës nga ndërtimet e tjera kufitare cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 35:** *Mosrespektimi i distancave urbane midis ndërtesës nga trupi i rrugës.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimitme objekt “**Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë**”, me vendim për miratim nr. 99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J..I.**” Shpk në Jalë, Himarë, u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës nuk janë respektuar sipas kriterëve të nënpikës b), pika 3, Neni 33 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 6 kateve. Referuar përcaktimeve ligjore të nënpikës b), pika 3, Neni 33 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*për gjerësi rruge, përfshirë trotualet, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 3 (tre) metra;*”, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton distancat urbane nga trupi i rrugës së propozuar në përfundim, me gjerësi 8 metra, më konkretisht objekti 1 kat në Perëndim dhe objekti 1 kat në Veri – Perëndim nuk respektojnë distancën minimale të lejuar prej 3m.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika b), pika 3, Neni 33, “*Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Nëse nuk përcaktohet ndryshe në PDV, distancat minimale të faqeve të strukturave nga kufiri i trupit të rrugës apo kufiri i pronës parcelë me trupin e rrugës, brenda zonave të sistemit urban

ekzistues ose ato që urbanizohen, përcaktohen në bazë të gjendjes faktike të trupit të rrugës, por, në çdo rast, jo më pak se përcaktimi ligjor në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme për trupin e rrugës dhe, nëse nuk përcaktohet ndryshe në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, janë:

*b) për gjerësi rruge, përfshirë trotualet, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 3 (tre) metra;*

Pika 7, Neni 46, “*Treguesit e distancave*”, **Plani i Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë:

- Për përcaktimin e distancave ndërtesë – ndërtesë, ndërtesë – rrugë dhe ndërtesë – kufij prone, në projektim, do të zbatohen normat minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtim të rasteve kur PPV propozon distanca të tjera më të mëdha se minimumi i parashikuar.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i distancës nga trupi i rrugës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 36:** *Mosrespektimi i intensitetit të ndërtimit maksimal të lejuar.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se intensiteti i ndërtimit maksimal i lejuar nuk është respektuar sipas kriterëve të pikës 1, Neni 38 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit** si dhe Neni 37 të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr. 114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Duke iu referuar pikës 1, Neni 38 të **VKM nr. 408**, ku përcaktohet që: “*Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore*”, dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083, njësi strukturore në të cilën zhvillohet parcela,  $I_{maksimal} = 0.4$ , ndërsa  $I_{miratuar} = 2.48$ . Edhe pse leja e zhvillimit është miratuar me vendim të KKT-së, në pikën 3 të këtij vendimi, KKT ia ka kaluar kompetencat Bashkisë Himarë për ndjekjen e procedurave administrativo-ligjore. Si përfundim, DPZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkeljes së intensiteti të ndërtimit maksimal të lejuar.

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J.I.**” Shpk në Jalë, Himarë. Duke iu referuar pikës 1, Neni 38 të **VKM nr. 408**, ku përcaktohet që: “*Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore*”, dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428, njësi strukturore në të cilën zhvillohet parcela,  $I_{maksimal} = 0.6$ , ndërsa  $I_{miratuar} = 1.48$ . Edhe pse leja e zhvillimit është miratuar me vendim të KKT-së, në pikën 3 të këtij vendimi, KKT ia ka kaluar kompetencat Bashkisë Himarë për ndjekjen e procedurave administrativo-ligjore. Si përfundim, DPZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkeljes së intensiteti të ndërtimit maksimal të lejuar.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 1, Neni 38 “*Intensiteti i ndërtimit*”, të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”

- Intensiteti (I) përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083:**

- Intensiteti i ndërtimit maksimal i lejuar për njësinë strukturore është 0.4

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428:**

- Intensiteti i ndërtimit maksimal i lejuar për njësinë strukturore është 0.6

**Ndikimi:** Mosrespektimi i intensitetit të ndërtimit maksimal të lejuar cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 37:** *Mosrespektimi i koeficientit të shfrytëzimit të territorit për ndërtim.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim (KSHT) nuk është respektuar sipas kriterëve të pikës 3, Neni 39 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe Neni 38 të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”,** me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Duke iu referuar pikës 3, Neni 39 të **VKM nr. 408**, i cili përcakton se “*Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme.*”, dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083,  $KSHT_{lejuar}=30\%$ , ndërsa  $KSHT_{miratuar}=52.3\%$ . Në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues për sa më sipër është cituar. Edhe pse leja e zhvillimit është miratuar me vendim të KKT-së, në pikën 3 të këtij vendimi, KKT ia ka kaluar kompetencat Bashkisë Himarë për ndjekjen e procedurave administrativo-ligjore. Si përfundim, DPKZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkeljes së koeficientit të shfrytëzimit të tokës maksimal të lejuar.

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”,** me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “J..I.” Shpk në Jalë, Himarë. Duke iu referuar pikës 3, Neni 39 të **VKMnr, 408**, i cili përcakton se “*Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme.*”, dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428,  $KSHT_{lejuar}=30\%$ , ndërsa  $KSHT_{miratuar}=43.5\%$ . Në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues për sa më sipër është cituar. Edhe pse leja e zhvillimit është miratuar me vendim të KKT-së, në pikën 3 të këtij vendimi, KKT ia ka kaluar kompetencat Bashkisë Himarë për ndjekjen e procedurave administrativo-ligjore. Si përfundim, DPKZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkeljes së koeficientit të shfrytëzimit të tokës maksimal të lejuar.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 3, Neni 39, “*Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083:**

- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim është 30 %

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428:**

- Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim është 30 %

**Ndikimi:** Mosrespektimi i koeficientit të shfrytëzimit të territorit për ndërtim cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cënon zhvillimin e ndërtimve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 38:** *Mosrespektimi i koeficientit të shfrytëzimit të hapësirave publike (KSHP) dhe hapësirave për rrugë (KSHR).*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se koeficientit të shfrytëzimit të hapësirave publike (KSHP) dhe hapësirave për rrugë (KSHR) nuk është respektuar sipas kriterëve të pikës 2 dhe 4, Neni 40 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe Neni 39 dhe 40 të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Duke iu referuar pikës 2, Neni 40 të **VKM nr. 408**, i cili përcakton se “*Kshr-ja paraqitet në % dhe përcaktohet në dokumentin e planifikimit për njësi/zonë, në përputhje me:...*”, si dhe pikës 4: “*Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit*”; gjithashtu duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083, njësi strukturore në të cilën zhvillohet parcela, koeficienti i shfrytëzimit të hapësirave publike është KSHP=10%, ndërsa KSHR=15%.

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues **J..I.** ShPK në Jalë, Himarë. Duke iu referuar pikës 2, Neni 40 të **VKM 408**, i cili përcakton se “*Kshr-ja paraqitet në % dhe përcaktohet në dokumentin e planifikimit për njësi/zonë, në përputhje me:...*”, si dhe pikës 4: “*Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit*”; gjithashtu duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428, njësi strukturore në të cilën zhvillohet parcela, koeficienti i shfrytëzimit të hapësirave publike është KSHP=10%, ndërsa KSHR=15%.

Në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues për sa më sipër është cituar, në lidhje me këto 2 leje ndërtimi.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 2 dhe pika 4, Neni 34, “*Koeficientët e shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe hapësira publike*”, **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Kshr-ja paraqitet në % dhe përcaktohet në dokumentin e planifikimit për njësi/zonë, në përputhje me:

- a) numrin e parashikuar të njësive të banimit dhe ndërtimeve të tjera;
- b) distancat e lejuara sipas kësaj rregulloreje;
- c) nevojën për diellëzim dhe eliminim zhurmash;

- ç) hapësirën e nevojshme për kalimin e infrastrukturave nëntokësore dhe ajrore;
  - d) nevojën për krijimin e lidhjes së çdo objekti të vetëm me rrugën;
  - dh) plotësimin e kushteve për nënndarje dhe bashkim parcelash sipas kësaj rregulloreje;
  - e) nevojat e trafikut të brendshëm dhe tranzit;
  - ë) nevojën për lidhje të njësisë/zonës me pjesët e tjera të qytetit;
  - f) nevojën për transport urban, lëvizje të këmbësorëve dhe me biçikleta.
- Kshp-ja paraqitet në % dhe përcaktohet për njësi/zonë në dokumentin e planifikimit.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083:**

- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike është 10 %
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë është 15 %

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428:**

- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike është 10 %
- Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për rrugë është 15 %.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i koeficientit të shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe për hapësira publike cënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 39:** *Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtesës, e matur me numër katesh.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se lartësia maksimale e ndërtesës së miratuar, e matur me numër katesh, nuk është respektuar sipas kriterëve të pikës 2, neni 37 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe pikës 1, Neni 42 të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”,** me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” ShPK, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 4 kateve. Duke iu referuar pikës 2, Neni 37 të **VKM nr. 408**, i cili përcakton se “*Lartësia e ndërtimit mbi tokë, e shprehur në numër katesh, është e barabartë me shumën e kateve mbi tokë, përfshirë katin ose gjysmë kati nën çati, në përputhje me këtë nen*”, si dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083,  $L_{maksimale}$ , e matur me numër katesh, është 3 kate mbi tokë.

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”,** me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J..I..**” Shpk në Jalë, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 6 kateve. Duke iu referuar pikës 2, Neni 37 të **VKM 408**, si dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428,  $L_{maksimale}$ , e matur me numër katesh, është 3 kate mbi tokë.

Në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues për sa më sipër është cituar, në lidhje me këto 2 leje ndërtimi.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 2, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

-Lartësia e ndërtimit mbi tokë, e shprehur në numër katesh, është e barabartë me shumën e kateve mbi tokë, përfshirë katin ose gjysmë kati nën çati, në përputhje me këtë nen.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083:**

- Lartësia maksimale e ndërtimeve, e matur me numër katesh, është 3 kate.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428:**

- Lartësia maksimale e ndërtimeve, e matur me numër katesh, është 3 kate.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtimeve, e matur me numër katesh, cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 40:** *Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtesës, e matur me metra.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se lartësia maksimale e ndërtesës së miratuar, e matur me metra, nuk është respektuar sipas kriterëve të nënpikës a) dhe c), pika 1, Neni 37 të Rregullores së Zhvillimit të Territorit, si dhe pikës 1, Neni 42 të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë. Gjetja e konstatuar u evidentua në 2 rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

1. “**Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë**”, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” ShPK, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 17.78m. Duke iu referuar nënpikës a), pika 1, Neni 37 të VKM nr. 408, i cili përcakton se: “*Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit*”, si dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083,  $L_{maksimale}$ , e matur me metra, është 11m.

2. “**Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë**”, me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues J..I.. ShPK në Jalë, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në lartësinë e 23 m. Duke iu referuar nënpikës c), pika 1, Neni 37 të VKM nr. 408, i cili përcakton se: “*Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike*”, si dhe duke iu referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428,  $L_{maksimale}$ , e matur me metra, është 11.5m.

Në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues për sa më sipër është cituar, në lidhje me këto 2 leje ndërtimi.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika a) dhe c), pika 1, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimve të kësaj rregulloreje, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra.

Lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit:

a) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;

c) Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.6.1083:**

- Lartësia maksimale e ndërtimeve, e matur me metra, është 11 m.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.9.428:**

- Lartësia maksimale e ndërtimeve, e matur me metra, është 11.5 m.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtimeve, e matur me metra, cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 41:** *Mosrespektimi përcaktimeve ligjore në lidhje me parcelën minimale që mund të zhvillohet në njësinë strukturore.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me parcelën minimale që mund të zhvillohet në njësinë strukturore nuk janë respektuar sipas kritereve të pikës 4, “Rregulla mbi intensitetin e zhvillimit dhe treguesit e zhvillimit për njësinë HI.UB.6.1083” të **Planit të Detajuar Vendor** për këtë njësi, miratuar me vendim nr. 43, nr. 1029 prot., datë 23.04.2020. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm, të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit në parcelën me adresë ZK1481, Dhërmi, Vlorë, me sipërfaqe 1262 m<sup>2</sup>. Duke iu referuar pikës 4, “Rregulla mbi intensitetin e zhvillimit dhe treguesit e zhvillimit për njësinë HI.UB.6.1083” të **Planit të Detajuar Vendor** për këtë njësi, miratuar me vendim nr. 43, nr. 1029 prot., datë 23.04.2020, sipërfaqja minimale e parcelës që mund të zhvillohet në këtë njësi strukturore është 1500 m<sup>2</sup>. Si përfundim, DPZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkeljes së sipërfaqes minimale të parcelës që mund të zhvillohet në këtë njësi strukturore.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 4, “Rregulla mbi intensitetin e zhvillimit dhe treguesit e zhvillimit për njësinë HI.UB.6.1083”,

**Plani i Detajuar Vendor** për njësinë strukturore HI.UB.6.1083, , miratuar me vendim nr. 43, nr. 1029 prot., datë 23.04.2020:

-Madhësia minimale e parcelës është 1500 m<sup>2</sup>

**Ndikimi:** Mosrespektimi i madhësisë minimale të parcelës cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 42:** *Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje planin e rievimit topografik.*



**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me rilevimin topografik nuk janë respektuar sipas kritereve të nënpikës ç), pika 1, Neni 10, “*Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi*” të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, ku përcaktohet se: “*planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar*”;”. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm, të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit të sipërcituar, në mungesë të të dhënave të nevojshme që duhen paraqitur në planin e rilevimit, si janë konturi i pasurisë, të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare, të dhëna mbi rrugët , gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Rilevimi topografik nuk paraqet asnjë informacion në lidhje me rrugën pedonale në fasadën Jug – Perëndimore, si gjerësia e saj dhe distanca nga faqja e ndërtimit. Për sa më sipër plani i rilevimit është i pasaktë.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika ç), pika 1, Neni 10, “*Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Dokumentet e vetme që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t’u pajisur me leje zhvillimi janë:

ç): planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar;

**Ndikimi:** Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me planin e rilevimit topografik cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjisllacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 43:** *Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me numrin minimal të vend parkimeve.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit me objekt “**Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë**”, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë, u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me numrin minimal të vend parkimeve nuk janë respektuar sipas kritereve të pikës 1, Neni 32, “*Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie*” të VKM nr. 408, datë 13.5.2015, ku përcaktohet se: “*Numri minimal i vend parkimeve publike në përputhje me rregulloren e planifikimit*”;”, si dhe pikës 1, Neni 43, “*Kërkesat e parkimit*” të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit të sipërcituar, në mungesë të të dhënave që përcaktojnë numrin minimal të vend parkimeve të nevojshme. Numri minimal i vend parkimeve për hotelet dhe resortet është 1 hapësirë parkimi për 10-15 dhoma. Vlen të theksohet se gjatë këqyrjes së projektit arkitektonik, vihet re se objekti 4 kate mbi tokë nuk ka të parashikuar asnjë kat nëntokë që do të shërbente si parkim.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Pika 1, Neni 32, “*Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Numri minimal i vend parkimeve publike në përputhje me rregulloren e planifikimit.  
Pika 1, Neni 43, “Kërkesat e parkimit”, **Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë:

- Numri minimal i vend parkimeve për hotelet dhe resortet është 1 hapësirë parkimi për 10-15 dhoma.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me numrin minimal të vend parkimevendikon në përdorimin e hapësirave të përbashkëta në mënyrë jo-proporcionale, nuk siguron hapësirat që kuadri rregullator parashikon në lidhje me shërbimet akomoduese.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 44:** *Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje katin nëntokësor.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit me objekt “**Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë**”, me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J.I.**” Shpk në Jalë, Himarë, u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me katin nëntokësor nuk janë respektuar sipas kriterëve të nënpikës b), pika 3, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*” të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**. Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit të sipërcituar, duke mos respektuar përkufizimet ligjore të sipërcituara, si përfundim, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me katin nëntokë. Mosrespektimi i këtyre përcaktimeve ndikon në lartësinë maksimale të lejuar, në distancat midis objekteve, distancat nga trupi i rrugës, intensitetin e ndërtimit, si dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika b), pika 3, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**:

- Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe “**Bodrum**”, është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me përcaktimin e katit nëntokësor ndikon në përdorimin e hapësirave të përbashkëta në mënyrë jo-proporcionale, nuk siguron hapësirat që kuadri rregullator parashikon në lidhje me shërbimet akomoduese.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 45:** *Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me lartësinë minimale të katit përdhe, kur shfrytëzohet për përdorim shërbimi.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit me objekt “**Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë**”, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J.I.**” Shpk në Jalë, Himarë, u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me lartësinë minimale të katit përdhe,

kur shfrytëzohet për përdorim shërbimi, nuk janë respektuar sipas kritereve të nënpikës c), pika 3, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*” të **VKM 408, datë 13.5.2015**.

Leja e ndërtimit e miratuar është dhënë për zhvillimin e objektit të sipërcituar, duke mos respektuar përkufizimin ligjor në lidhje me lartësinë minimale të katit përdhe, duke miratuar një lartësi prej 3.15m, kur lartësia minimale e lejuar për katin përdhe është 5m.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika c), pika 3, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

- Kati përdhe, në rastet kur shfrytëzohet për përdorim shërbimi, lartësia minimale dysHEME – dysHEME është 5.00 m

**Ndikimi:** Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me përcaktimin e katit nëntokësorndikon në përdorimin e hapësirave të përbashkëta në mënyrë jo-proporcionale, nuk siguron hapësirat që kuadri rregullator parashikon në lidhje me shërbimet akomoduese.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislationit në fuqi.

*Për sa më lart, për të dyja lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër me Nr. 1 dhe Nr. 2, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G... S..., me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. F... B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 46:** *Mos llogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe duke mos u mbështetur në bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksimi me vlerën më të lartë. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **279,728,78 lekë**.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Neni 27, “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*”, **Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"** të ndryshuar.

Neni 46, “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*”, **Ligji nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”**:

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

**Ndikimi:** Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Himarë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerave që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 1, mbajnë përgjegjësi: z. J.G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G... S..., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, z. F... B..., me detyrë specialist, si dhe z. L.M., me detyrë Drejtor i Financës.*

**Titulli i gjetjes 47:***Mos llogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe duke mos u mbështetur në bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksimi me vlerën më të lartë. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:

**2. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J..I..**” shpk në Jalë, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **4,363,399.06 lekë**.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Neni 27, “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*”, **Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006** “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar.

Neni 46, “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*”, **Ligji nr. 107/2014**, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”:

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

**Ndikimi:** Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Himarë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerave që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 2, mbajnë përgjegjësi: z. J.G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G... S..., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, z. F... B..., me detyrë specialist, si dhe z. L...M..., me detyrë Drejtor i Financës.*

**Titulli i gjetjes 48:***Shqyrtimi i dokumentacionit për aplikim për pajisje me leje ndërtimi me afate të tej zgjatura.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor nuk janë respektuar sipas kriterëve të Nenit 21 dhe 22 të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, si dhe pikës 2, Neni 44, të **Ligjit 107/2014** “*Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në 3 rastet e mëposhtme, të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat”**, me vendim për miratim nr.98, datë 17.11.2021, me zhvillues z. E.. D..., në Qeparo, Himarë.

**2. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim nr.115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T...G..., në Palasë, Himarë.

**3. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim nr.116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T...G..., në Palasë, Himarë.

Lejet e ndërtimit të miratuar janë dhënë për zhvillimin e objektit të sipërcituar, duke mos respektuar afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Neni 21, “*Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015.**

Neni 22, “*Vendimi për lejen nga autoriteti vendor*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015,**

Pika 2, Neni 44, “*Shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi*”, **Ligji nr. 107/2014**, “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”:

- Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i afateve kohore për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor, cenon të drejtat e aplikantit për miratimin ose refuzimin e kërkesës brenda afateve që ligji dhe rregullorja parashikon.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT X

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për shqyrtimin brenda afateve kohore të kërkesave për pajisje me leje ndërtimi.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër me Nr. 1,2 dhe 3, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 49:** *Mosplotësimi i kërkesave të vendosura nga autoritetet e tjera publike, të cilat duhet të japin mendim për miratimin e një leje ndërtimi.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit me objekt “**Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë**”, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë, u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me plotësimin e kërkesave të vendosura nga autoritetet e tjera publike, të cilat duhet të japin mendim për miratimin e një leje ndërtimi nuk janë respektuar sipas kritereve të nën pikës a), pika 1, Neni 10/1 të **VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015**, ku citohet: “*shqyrtojnë kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore*”. Leja e ndërtimit është miratuar, duke mos përmbushur kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si një nga autoritetet publike që duhet të shprehet mbi kërkesat për pajisje me leje ndërtimi. MTMi është drejtuar Bashkisë Himarë, me anë të shkresës së datës 13.08.2021, me lëndë “Vendim për VMN paraprake”. Ndër të tjera, është kërkuar në pikën 3.2 “*Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi*”. Në dokumentacion e ngarkuar në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë dokumentacion justifikues që dëshmon plotësimin e kësaj kërkesë. Si përfundim, shprehem se Bashkia Himarë ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të akteve që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika a), pika 1, Neni 10/1, “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

- shqyrtojnë kërkesën për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore;

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve të vendosura nga autoritetet e tjera publike rrit rrezikun e dëmtimit të tokës, resursit të saj, është në kundërshtim me përdorimin e tokës të përcaktuar në **Planin e Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHTHimarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për respektimin e të gjitha kriterëve të vendosura nga autoritetet e tjera publike, të cilat duhet të japin mendim për miratimin e një leje ndërtimi.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 1, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 50:** *Subjekti zhvillues ka ngarkuar të pa-përditësuar dhe të paplota vërtetimet që tregojnë se nuk ka detyrime të papaguara.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua vërtetimet që tregojnë se nuk ka detyrime të papaguara janë ngarkuar të pa-përditësuar dhe të paplotanga ana e subjektit zhvillues. Referuar kriterëve të nënpikës d) dhe dh), pika 3, Neni 26, “Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje”, të **VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015**. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastet e mëposhtme, miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat”**, me vendim për miratim nr.98, datë 17.11.2021, me zhvillues z. **E..D..**, në Qeparo, Himarë.

Subjekti zhvillues dhe subjekti/et ndërtues kanë detyrimin ligjor, referuar nënpikës d) dhe dh), pika 3, Neni 26, “Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje”, të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, që të ngarkojnë në sistemin elektronik e-leje aktet që vërtetojnë se këto subjekte nuk kanë detyrime të papaguara ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE, Shoqërisë Aksionere të Ujësjiellës-Kanalizime, Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe ndaj Bashkisë Himarë. Të gjitha vërtetimet e ngarkuara në sistemin e-leje, kanë një diferencë kohore 4-5 muaj nga momenti i aplikimit për leje ndërtimi. Nga dokumentacioni i marrë në shqyrtim nuk mund të shprehemi nëse subjekti ndërtues i ka paguar apo jo detyrimet për muajt Mars – Korrik 2021. Gjithashtu, në sistem nuk është ngarkuar asnjë lloj informacioni për detyrime të papaguara nga subjekti zhvillues dhe ndërtues ndaj SHA-UK, si dhe asnjë informacion nëse subjekti ndërtues ka ose jo detyrime të papaguara ndaj DPTTV.

**2. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim Nr.115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T...G..., në Palasë, Himarë; dhe për:

**3. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim nr. 116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T...G..., në Palasë, Himarë, subjekti zhvillues dhe subjekti/et ndërtues kanë detyrimin ligjor, referuar nënpikës d) dhe dh), pika 3, Neni 26 të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, i ndryshuar, që të ngarkojnë në sistemin elektronik e-leje aktet që vërtetojnë se këto subjekte nuk kanë detyrime të papaguara ndaj OSHEE, Sh.A Ujësjiellës-Kanalizime, DPTTV, si dhe ndaj Bashkisë Himarë.

Vlen të theksohet se formati i aplikimit për leje ndërtimi, është firmosur elektronikisht në datën 11.08.2021. Të gjitha vërtetimet e ngarkuara në sistemin e-leje kanë një diferencë kohore 2-3 muaj nga momenti i aplikimit për leje ndërtimi. Nga dokumentacioni i marrë në shqyrtim nuk mund të shprehemi nëse subjekti ndërtues dhe zhvillues i kanë paguar apo jo detyrimet për muajt Qershor – Korrik 2021 ndaj OSHEE, nuk mund të shprehemi nëse subjekti ndërtues ka ose jo detyrime të papaguara ndaj Bashkisë Himarë për muajt Qershor – Gusht 2021. Në sistem nuk është ngarkuar asnjë lloj informacioni për detyrime të papaguara nga subjekti zhvillues dhe ndërtues ndaj SHA-UK, si dhe ndaj DPTTV.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika d) dhe dh), pika 3, Neni 26, “Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

- d) Të dhëna rreth licencave, autorizimeve dhe lejeve të marra nga subjekti për ushtrimin e veprimtarisë, bazuar në legjislacionin sektorial përkatës;

- dh) Listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në **VKM nr. 408**, datë 13.5.2015, ndikon në rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për respektimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara në **VKM nr. 408**, datë 13.5.2015, për rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 1, 2 dhe 3, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 51:** *Subjektet e zhvillimit, ndërtimit dhe projektimit nuk kanë ngarkuar të gjithë dokumentacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se përcaktimet ligjore në lidhje me plotësimin e dokumentacionit që rregullon veprimtarinë e ndërtimit për subjektet e zhvillimit, ndërtimit dhe projektimit nuk janë respektuar sipas kriterëve të nënpikës ë), pika 1, Neni 15, të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, ku përcaktohet se: “Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit” si dhe nënpika d), pika 3, Neni 26, ku përcaktohet se: “Të dhëna rreth licencave, autorizimeve dhe lejeve të marra nga subjekti për ushtrimin e veprimtarisë, bazuar në legjislacionin sektorial përkatës” dhe nënpika dh): “Listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur”. Gjetjet e konstatuara u evidentuan në rastin e mëposhtëm, miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**1. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim Nr.115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T.... G..., në Palasë, Himarë dhe për **2. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”**, me vendim për miratim Nr.116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T....G..., në Palasë, Himarë. Referuar nënpikës ë), pika 1, Neni 15, të **VKM nr. 408, datë 13.5.2015**, si dhe nënpika d) dhe dh), pika 3, Neni 26 të kësaj VKM-je, shprehemi se për subjektin zhvillues, z. T...G..., person fizik, me NIPT M....E dhe për subjekti ndërtues “B...-0...”Shpk, me NIPT K...J, mungon Certifikata e Regjistrimit. Për subjektin projektues, C... S..., me NIPT L.....T mungon ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit. Për subjektin G..., me NIPT L.....D mungon ekstrakti i regjistrimit tregtar

për të dhënat e subjektit. Gjithashtu, për inxhinieren e ndërtimit, A....S..., e cila ka përpunuar projektin konstruktiv dhe preventivin e punimeve, nuk jepet asnjë informacion rreth formës së bashkëpunimit me subjektin ndërtues, si kontratë pune nëse ka të tillë, kontratë sipërmarrjeje, certifikatë regjistrimi në QKB dhe ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, nëse ka të tillë.

**3. “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “J.....I...” Shpk në Jalë, Himarë.

Nga analiza e bërë, rezulton se:

- Mungon Certifikata e Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB për subjektin “M... A..., C...&D...” SHPK, subjekt i cili është autorizuar nga subjekti zhvillues “J...I...”, me anë të prokurës së posaçme të datës 04.03.2021, për të nënshkruar elektronikisht, si dhe për kryerjen e procedurës së aplikimit.

- Licenca profesionale e arkitektes së subjektit “M...A..., C...&D...” Shpk, L... K..., është e pa nënshkruar elektronikisht.

- Licenca profesionale subjektit M... A..., C...&D... SHPK, L... K..., është e pa nënshkruar elektronikisht.

- Mungon ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për subjektin PF D...L..., me profesion inxhinier mjedisi, i cili ka realizuar projektin dhe relacionin hidrosanitar, si dhe projektin dhe relacionin e instalimeve të ngrohje – ftohjes.

- Mungon Çertifikata e Regjistrimit në QKB dhe ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për subjektin “G.-S.”, me profesion inxhinier topograf E...S..., i cili ka realizuar rilevimin topografik.

- Mungon Çertifikata e Regjistrimit në QKB dhe ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për subjektin “G... E... S...”, me profesion inxhinier gjeolog L... L..., i cili ka realizuar raportin dhe studimin gjeologjik.

- Mungon Çertifikata e Regjistrimit në QKB për subjektin “U...-0...” Shpk, me profesion inxhinier ndërtimi M.... B..., i cili ka realizuar raportin dhe studimin sizmik.

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për subjektin PF I... P..., e liçensuar në arkeologji, e cila ka realizuar raportin dhe relacionin arkeologjik.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika ë), pika 1, Neni 15, “*Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;

Nënpika d), pika 3, Neni 26, “*Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Të dhëna rreth licencave, autorizimeve dhe lejeve të marra nga subjekti për ushtrimin e veprimtarisë, bazuar në legjislacionin sektorial përkatës.

Nënpika dh), pika 3, Neni 26, “*Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje*”, VKM nr. 408, datë 13.5.2015:

- Listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në **VKM nr. 408**, datë 13.5.2015, ndikon në rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë



**Rekomandime:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për respektimin e të gjitha kriterëve të përcaktuara në **VKM nr. 408**, datë 13.5.2015, për rregullimin e veprimtarisë ndërtimore të subjekteve zhvilluese.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër me Nr. 1, 2 dhe 3, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 52:** *Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtesës, e matur me metra.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit për objektin “**Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë**”, me vendim për miratim Nr.115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T....G..., në Palasë, Himarë dhe për **2. “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë**”, me vendim për miratim Nr.116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. T....G..., në Palasë, Himarë, u konstatua se lartësia maksimale e ndërtesës së miratuar, e matur me metra, nuk është respektuar sipas kriterëve të nënpikës a) dhe c), pika 1, Neni 37 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**, si dhe pikës 1, Neni 42 të **Planit të Përgjithshëm Vendor** për Bashkinë Himarë. Referuar pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.2.1084,  $L_{lejuar} = 8m$ . Nga këqyrja e projektit arkitektonik të miratuar, rezulton se objekti ka një  $L_{miratuar} = 8.34m$ . Lartësia është matur sipas përcaktimeve të nënpikës a) dhe c), pika 1, Neni 37 të **VKM nr. 408**, datë **13.05.2015**, e ndryshuar. Si përfundim, DPKZHT ka miratuar një leje ndërtimi në kushtet e shkëljes së lartësisë maksimale të lejuar, e matur me metra.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika a) dhe c), pika 1, Neni 37, “*Lartësia e ndërtimeve*”, **VKM nr. 408**, datë **13.5.2015**:

- Për llogaritjen apo vlerësimin sipas përcaktimeve të kësaj rregullore, lartësia e ndërtimeve shprehet gjithmonë njëkohësisht në numër katesh dhe metra.

Lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit:

a) Nga kuota mesatare e sistemimit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;

c) Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

**Pasaportës së njësisë strukturore HI.UB.2.1084:**

- Lartësia maksimale e ndërtimeve, e matur me metra, është 8 m.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i lartësisë maksimale të ndërtimeve, e matur me metra, cenon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe cenon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orientimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuara më sipër me Nr. 1, 2 dhe 3, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 53:** *Plani i rilevimit për objektin e miratuar është i pasaktë.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit “**Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë**”, me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J.I.**” Shpk, në Jalë, Himarë, u konstatua se plani i rilevimit nuk është hartuar i saktë. Nuk janë respektuar kriteret e nënpikës ç), pika 1, Neni 10 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**. Plan i rilevimit të pronës, duhet të paraqesë konturin e pasurisë, të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare, të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Plan i rilevimit nuk jep asnjë informacion në lidhje me përroin në pjesën perëndimore, si dhe në lidhje me pedonalen në pjesën Jug – Perëndimore. Për sa më sipër Plan i rilevimit është i pasaktë.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika ç), pika 1, Neni 10, “*Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi*”, **VKM nr. 408, datë 13.5.2015:**

- Planin e rilevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar;

Pika 1, Neni 84, “*Veprimtaritë në brigje*”, **Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”:**

- Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet: a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve në lidhje me përpilimin e planit të saktë të rilevimit çënon resurset natyrore ujore, si dhe standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 1, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe z. F..B., me detyrë specialist.*

**Titulli i gjetjes 54:** *Leja e ndërtimit është miratuar në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga vet Bashkia Himarë.*

**Situata:** Nga auditimi i lejes së ndërtimit “**Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë**”, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F..M... dhe ndërtues “**A...N**” Shpk, në Dhërmi, Himarë. Bashkia Himarë, u konstatua se kjo leje është miratuar në kushtet e mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga vet Bashkia Himarë. Nuk janë respektuar kriteret e nënpikës e), pika 1, Neni 15, si dhe nënpikës dh), pika 3, Neni 26 të **Rregullores së Zhvillimit të Territorit**. Bashkia Himarë i ka kërkuar subjektit zhvillues, i përfaqësuar nga studio e projektimit “**F..A..**”, me anë të shkresës me nr. 96, datë 17.11.2021, me lëndë “*Njoftim për plotësimin e kërkesës*”, ndër të tjera, plotësimin e kërkesës: “*5. Mungon polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale të topografit.*” Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje nuk u gjet asnjë informacion justifikues për sa më sipër. Si përfundim, shprehemi se Bashkia Himarë ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të akteve që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të vet Bashkisë Himarë.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

Nënpika e), pika 1, Neni 15, “*Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi*”, VKM Nr. 408, datë 13.5.2015:

-Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjeno-sanitare;

Nënpika dh), pika 3, Neni 26, “*Rregulla të përbashkëta për kërkesat për leje*”, VKM Nr. 408, datë 13.5.2015:

- Listën e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve në lidhje me dokumentacionin shoqërues që duhet paraqitur gjatë aplikimit për leje ndërtimi është në kundërshtim me rregulloren e sipërcituar dhe shman mbajtjen e përgjegjësiwe profesionale në rast dëmtimesh ose në rastet problematikave të paparashikuara.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Himarë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet në lidhje me dokumentacionin shoqërues që duhet paraqitur gjatë aplikimit për leje ndërtimi, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

*Për sa më lart, për lejen e ndërtimit të trajtuar më sipër me Nr. 1, mbajnë përgjegjësi: z. J..G., me detyrë Kryetari i Bashkisë Himarë; z. G..S., me detyrë Drejtor i Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, si dhe z. F...B..., me detyrë specialist.*

## **2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit.**

Lidhur me organizimin dhe funksionimin Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Himarë nuk u auditua si pikë edhe pse ishte e planifikuar në programin e auditimit pasi Prokuroria prnë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me nr. 14057 prot., (EV) datë 10.12.2021 “Dërgohet urdhër i prokurorisë për ekzekutimin masës së sigurisë”, për ekzekutimin e Vendimit nr. 508, datë 10.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nisur nga fakti që auditimit i mëparshëm për organizimin dhe funksionimin e IMTV, është realizuar për aktivitetin e IMT deri më datë 01.10.2021 dhe rrethanave sa përshkruhen më sipër, kjo pikë e programit të auditimit nuk u realizua.

## **2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme**

Verifikimi i zbatimit i rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, paraqitet si më poshtë:

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nuk janë zbatuar 13 masa organizative.**

**b. Për shpërbllim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 19,830,776 lekë, deri me datë 13.02.2023, janë arkëtuar shuma 0 lekë, ndërsa shuma 20,724,974 lekë nuk është arkëtuar.**

**b.1. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 5 masa në vlerën 309,314,182 lekë, e pranuar dhe e pa zbatuar.**

**c. Për dhënien e masave disiplinore për punonjësit e atakuar në seksionin Masa Disiplinore, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil. I është rekomanduar që të ngrejë komisionin disiplinor për 11 punonjës, e pranuar dhe e zbatuar në 3 raste. Pa zbatuar 8 raste.**

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Himarë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.594/12 prot., datë 08.03.2022, ndërsa nga Bashkia Himarë për zbatim e rekomandimeve të KLSH. Me anë të shkresës nr.120/9 prot, date 29.03.2022 është kthyer përgjigje nga Bashkia Himarë. Bashkia Himarë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Himarë është hartuar Plan-Vepri për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Himarë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 594/12 prot., datë 08.03.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 08.09.2022.

Nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH. Nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkëlur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Himarë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr.594/12 prot., datë 08.03.2022, dhe ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak) me shkresën nr.1961 prot., datë 20.04.2022, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

4. Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

**Situata:** Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

1. Shkresa përcjellëse nr.594/12, datë 08.03.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

Shkresa kthim-përgjigje (brenda afatit 20 ditë) për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit. **Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

#### **Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Bashkinë Himarë:**

Nga KLSH janë lënë **33** rekomandime gjithsej, nga këto:

- **14** masa organizative;
- **3** masa shpërblim dëmi;
- **5** masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;
- **11** masa disiplinore;

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Në numër rekomandimesh: 33 rekomandime të dhëna, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 33 rekomandime, 4 prej tyre janë zbatuar ose 12%, 29 pa zbatuar ose 88%.

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë** rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nuk janë zbatuar 13 masa organizative.

**b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar** 3 masa me vlerë 19,830,776 lekë, deri me datë 13.02.2023, janë arkëtuar shuma 0 lekë, ndërsa shuma 20,724,974 lekë nuk është arkëtuar.

**b.1. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është** rekomanduar që të analizohet në 5 masa në vlerën 309,314,182 lekë, e pranuar dhe **e pa zbatuar.**

**c. Për dhënien e masave disiplinore** për punonjësit e atakuar në seksionin Masa Disiplinore, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil. I është rekomanduar që të ngrejë komisionin disiplinor për 11 punonjës, e pranuar dhe e zbatuar në 3 raste. **Pa zbatuar 8 raste.**

Pasqyruar në formë tabelare, si dhe përshkruese për çdo rekomandim në kapitullin “Aneksë”.

**Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, për të cilat rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon:**

#### **Masa Organizative:**

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Himarë 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar 1 masa organizative,

Në mënyrë të detajuar ecuria e procesit të zbatimit të masave organizative paraqitet si më poshtë:

#### **Masa Organizative**

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat e nevojshme për analizimin e shkaqeve të mos funksionimit të sistemit të komunikimit, si dhe të nxirren përgjegjësitë.

**1.2. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të hartohet procedurë e veçantë mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit i tyre në zbatim të kërkesave të ligjore.

**Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Pa zbatuar**

**2.1 Rekomandimi:** NJAB, të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi plotësimin e vendeve të NJAB, me minimumin 3 persona përfshirë drejtuesin e njësisë.

**Menjëherë**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është realizuar shpallja e vendeve vakante me shpalljen nr.2576 prot., datë 26.05.2022, por në konkurrim nuk ka marrë pjesë asnjë kandidat. **Zbatuar**

**3.1 Rekomandimi:** NJAB, gjatë realizimit të planit vjetor të auditimit të marrë parasysh analizimin dhe vlerësimin e riskut për përzgjedhjen e fushave të auditimit. ”

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e NJAB, e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **Pa zbatuar**

**4.1 Rekomandimi:** NJAB, të hartojë program të veçantë mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e NJAB, e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **Pa zbatuar**

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **32,752,293 lekë**.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkisë.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**7.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me, Drejtorinë e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë regjistrin e aktiveve të analizojë llogaritë e aktiveve për vlerat e tyre kontabël ku të specifikohen datat e hyrjes ose marrjes në dorëzim dhe personat përgjegjës me qëllim inventarizimin fizik të tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**8.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë të ngrëjë një grup pune me specialist të fushës, për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël dhe për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara si 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstrukione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 215 “Mjete transporti”, të bëhet verifikimin në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit 2020, detyrimet debitorë të pa kontabilizuar për vlerën 112,415,990 lekë.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë pa shpresë arkëtimi.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet. **Në vijimësi.**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**12.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga legjislacioni si dhe të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues “**Bega 07**” ShPK dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare. **Menjëherë**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**13.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*” të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues **E.K. dhe R. M.** dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

#### **Menjëherë**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**14.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë, të analizojë shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, për aplikimin e kriterëve në mënyrë të paargumentuar dhe jo në përputhje me

procedurat e zhvilluara dhe të shpalljes fitues të OE me kritere të paplotësuara, duke mos vlerësuar drejt cdo dokument në përmbushje të kritereve të miratuara në DT.

Të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektiv të fondeve të prokuruar.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

### **C. Masa për shpërblim dëmi**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,915,388 lekë**, si më poshtë:

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **28,575 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “**J... T...**”.

#### **Brenda vitit 2022**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **1,097,086 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “**B... 0...**” Shpk.

#### **Brenda vitit 2022.**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **8,789,727 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “**E... B...**” Shpk.

#### **Brenda vitit 2022**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**



**C/I. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **287,712,121 lekë**, si më poshtë vijon:

*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare,*”.

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

**Menjëherë.**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga **8 subjekte të vlerës 8,000,000 lekë**, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

**Brenda datës 31.12.202**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **3,851,173 lekë**.

**Menjëherë**

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**4.1.Rekomandimi:**Drejtorja e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e **vlerës 5,375,850 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës *Aneks nr. 15*, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Afati i zbatimit të rekomandimit:** Në vartësi të natyrës së rekomandimit, afati mund të jetë a) në vijimësi b) menjëherë c) një datë kohore të përcaktuar.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

**5.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **4,375,038 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik **“B.B.” ShPK.Menjëherë**

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. **I pazbatuar**

#### **D. Masa disiplinore**

##### **D/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Himarë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.10.2021 deri më 30.5.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:**

##### **D/1 “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në Largim nga Shërbimi Civil”**

###### **1. z. L..M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social.**

Nga verifikimi rezultoi se:

Është ngritur nga kryetari komisioni disiplinor (vendim me nr175 prot.120/30, datë: 10.06.2022) për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj Z. L..M...

Procesverbal (datë:12.07.2022) mbi dokumentimin e mbledhjes së Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore për Z. L..M.. me detyrë Drejtor i drejtorisë së financës, planifikimit dhe e integritit evropian nisje e shqyrtimit disiplinor të pretenduar për të.

Vendim (nr. 01; datë: 12.07.2022) për dhënie masë disiplinore për Z. L..M., u vendos pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit.

###### **I zbatuar**

###### **2. z.K..K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave.**

**Personi është larguar nga detyra me anë të paraqitjes së dorëheqjes nr.76 ., datë 06.01.2023 Pa zbatuar**

###### **3. znj. B...B..., me detyrë Nënkryetare e Bashkisë**

-Njoftim (nr. 120/14. prot ; datë: 27.04.2022) për fillimin e ecurisë disiplinore, Znj B...B...

njoftohet me anë të lëndës përkatëse se ndaj tij ka filluar procedura e ecurisë disiplinore për masë disiplinore: - Vërejtje deri në zgjidhje të kontratës së punës.

- Vendim (nr. 81; datë: 31.05.2022) për dhënie masë disiplinore për Znj. B...B..., është vendosur masa vërejtje . **I zbatuar**

###### **4. z. G..S., me detyrë drejtues i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit**

###### **5. F...B..., me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi**

**“Vërejtje deri në pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”**

-Është ngritur nga kryetari komisioni disiplinor (vendim me nr176 prot.120/31, datë: 10.06.2022) për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj Z. G.... S.....

-Procesverbal (datë:12.07.2022) mbi dokumentimin e mbledhjes së Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore për Z. G.... S.... me detyrë Drejtor i drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nisje e shqyrtimit disiplinor të pretenduar për të. Në mbledhje u morën

këto vendime: Komisioni vendosi të mos merret masë disiplinore. Vendim (nr. 01; datë: 13.07.2022) për dhënie masë disiplinore për Z. G... S..., ka vendosur të ndërpresë ecurinë disiplinore sepse nuk rezulton se nëpunësi ka kryer shkelje me faj të detyrës. **I pazbatuar**

**6. z. E..M..**, me detyrë Specialist Gjeodet.

**Punonjësi është pezulluar nga detyra për shkak të procesit të hetimit penal.** *Për shkeljet e konstatuara: **I pazbatuar***

**7. znj. B... R...**, me detyrë Specialist i Regjistrimit dhe Procedurave. *Për shkeljet e konstatuara: **I pazbatuar***

**8. z. O..V..**, me detyrë Specialist i Prokurimeve

*Për shkeljet e konstatuara:*

Vendim nr.120/29 prot., datë 10.06.2022, për dhënien e masës vërejtje. **I zbatuar**

**9. z. U..D..**, me detyrë Specialist i Buxhetit. *Për shkeljet e konstatuara: **I pazbatuar***

**10.z. A..G..**, me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi. *Për shkeljet e konstatuara:*

**I pazbatuar**

**11. z. A..B..**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes. *Për shkeljet e konstatuara: **I pazbatuar***

### **E. Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", indryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", indryshuar.

Shkresa nr.120/51 prot., datë 08.08.2022;

Shkresa nr.120/52 prot., datë 08.08.2022. **I zbatuar**

**Titulli i Gjetjes 55:** *Bashkia Himarë nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të lëna në auditimin e mëparshëm.*

**Situata:** Bashkia Himarë, nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të lëna në auditimin e mëparshëm të rikërkua me shkresën nr. 6793/2 prot., datë 10.03.2022.

Konkretisht është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve për të cilat nuk është iniciuar asnjë proces. Nga auditimi rezultoi se: për rekomandimet e dhëna nga KLSH Bashkia Himarë është mjaftuar vetëm me miratimin e plan veprimit dhe ngritjen e komisionit disiplinor për masa disiplinore. Nuk ka kryer procedurë për urdhër ndalesave, nuk ka ngritur padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave përgjegjës nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë shkak për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 19,830,776 lekë, deri me datë 13.02.2023, janë arkëtuar shuma 0 lekë, ndërsa shuma 20,724,974 lekë nuk është arkëtuar.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 5 masa në vlerën 309,314,182 lekë, e pranuar dhe e pa zbatuar.

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.

**Shkaku:** Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese të kësaj bashkie për rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Rëndësia:** E lartë.

**Ndikimi:** Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Bashkinë Himarë.

**Rekomandimi:** Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, znj. J..G.. me detyrë Kryetar i Bashkisë Himarë dhe z. L..M.. Drejtor Ekonomik.*

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Sistemi aktual i komunikimit të institucionit nuk është eficient. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat e nevojshme për analizimin e shkaqeve të mos funksionimit të sistemit të komunikimit, të nxirren përgjegjësitë më qëllim që të kryejë funksionet e veta.

-Bashkia Himarë, dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të hartohet procedurë e veçantë mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit i tyre në zbatim të kërkesave të ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** NJAB funksionon duke pasur në përbërje të njësisë maksimumi 1 punonjës dhe jo minimumi 3 persona duke përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore tëveprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, duke i dhënëmbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim eficientë në këtë sektor të rëndësishëm për Bashkinë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021, buxheti është realizuar në total në masën 47% ose nga 961,416 mijë të programuara, është realizuar 452,081 mijë lekë, nga të cilat nga granti i kushtëzuar dhe i pakushtëzuar në vlerën 158,261 mijë lekë ose sa 35% e realizimit vjetor dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 293,820 mijë lekë ose 65% e realizimit vjetor.

Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën 86 % ose nga 123,217 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 106,568 mijë lekë, nga të cilat nga granti 68,765 mijë lekë ose në masën 65% dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 37,803 mijë lekë ose 35,% të totalit të realizimit të pagave, në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 75 % ose nga 23,640 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 17,780 mijë lekë, nga të cilat nga granti 11,180 mijë lekë ose 63% dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 6,618 mijë lekë ose 37% të totalit të sigurimeve. Shpenzimet operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 65 % ose nga 202,867 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 131,631 mijë lekë, nga të cilat nga granti në vlerën 9,695 mijë lekë ose 7% e realizimit dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 121,936 mijë lekë ose 93% të totalit të shpenzimeve operative dhe në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masën 26 % ose nga 478,210 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 125,181 mijë lekë, nga të cilat nga granti 30,319 mijë lekë ose në masën 24% dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 94,862 mijë lekë ose 76 % të totalit të investimeve. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, 65; UMF Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore, neni 46. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2021, të llogarisë(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera nëllog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 74,770,620 lekë, ose 12,8 % e vlerës së buxhetit të vitit 2021 dhe vendime gjykatë në vlerën 585,320 lekë nga viti 2018-2021. Sa më sipër mos likuidimi në kohë i detyrimeve të vitit paraardhës janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40, 48. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Himarë të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore të paraqesë një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrimeve në vlerën **74,770,620 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se llogaritë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” 215 “Mjete transporti”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 26-30, si dhe pikën 74, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike.

### Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për vitin 2021, inventarizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara, Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve Qarkulluese, nuk është kryer dhe as i dokumentuar me dokumente ligjorë e kontabël për rrjedhojë; llogaritë e pasqyrave financiare, për këto llogari, nuk janë të besueshme, nuk janë të verifikuara me gjendjen fizike të tyre. Në këtë rast, përgatitja e pasqyrave financiare është në shkelje të kërkesave të, Kreu III, pika 30, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe pikave; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale të aktiveve, fizike dhe kontabël.

### Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

**7. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2021, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet me vlerë kontabël 137,747,839 lekë në fillim të vitit 2021 dhe 287,712,000

lekë në fund të vitit 2021. Gjendja e kësaj llogarie ka pësuar rritje nga në vlerë 149,964,161 lekë, si pasojë e mos pagesës dhe mos arkëtimit së detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore nga subjekte (biznes i madh dhe i vogël, taksë toke bujqësore, familjarë etj). Kjo llogari është e analizuar si vijon:

Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, konstatohet se me datë 31.12.2021 janë gjithsej debitorë 914 subjekte për vlerën 252,053,121 lekë.

Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë, janë gjithsej debitorë për vlerën 35,659 mijë lekë.

Taksë toke bujqësore 5,012 familje dhe për vlerën 5,819 mijë lekë dhe për taksë ndërtese dhe tarifa vendore 5,852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë.

Konstatohet se: Nga Bashkia Himarë (Nga auditimi i kaluar) është konstatuar se veç këtyre debitorëve, nuk janë kontabilizuar debitorë të tjerë për 14 raste të gjobave të vendosura nga APPP për shumën totale 3,240,000 lekë si dhe debitorë të tjerë sipas rekomandimeve të KLSH-së për 54 subjekte fizikë dhe juridikë për vlerën totale 80,145,955 lekë.

Në këtë rast, **vlera totale e debitorëve të pa kontabilizuar** në pasqyrat financiare, është për shumën totale **83,385,955 lekë** (fakt që është konstatuar edhe në auditimin e kaluar). Në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-70 të Raportit të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe debitorët e vitit 2020, të pa kontabilizuar për vlerën 103,574,000 lekë.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë pa shpresë arkëtimi.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2021, llogaria 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 46,136,181 lekëe rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën 20,859,786 lekë, pra me diferencë për vlerën **178,152 lekë**, pasqyruar më pak në llogaritë e fund vitit 2020 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në 51 raste për vlerën 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Himarë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhblokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-70 të Raportit të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në

informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe pagesave për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, u konstatua se disa fatura të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin vitit 2020, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 5 raste në vlerën 16,378,087 lekë. Për vlerën 46,593,485 lekë si detyrim i prapambetur për objektin “Ndërtimi i rrugës së fushës së sportit Himarë” kategoria Investim me fondet e veta, kryer para vitit 2015. Është konstatuar se ky detyrim nuk është përcjellë në raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe as nuk është përfshirë në buxhetin e vitit 2021 duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të PF të vitit 2021 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve. Për pasojë është nën vlerësuar llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerë -62,958,572 lekë. Vlerë e cila duhej të paraqitej në shumën 137,729,192 lekë në fund të vitit 2020 dhe 120,364,105 lekë në mbyllje të vitit 2021.

Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerje investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2021 për vlerën -46,593,485 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3/c.d “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kriteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Himarë, ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar. Bashkia Himarë ka miratuar 2 leje ndërtimi, për të cilat leja e zhvillimit është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), më konkretisht:

- “Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë, dhe

- “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”, me vendim për miratim Nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “J..I..” Shpk në Jalë, Himarë,

duke mos marrë në konsideratë ligjet dhe rregulloret e sipërcituara, edhe pse KKT ka autorizuar Bashkinë Himarë për ndjekjen e procedurave administrative – ligjore për miratimin e lejes së ndërtimit. Më konkretisht, Bashkia Himarë, me miratimin e këtyre lejeve të ndërtimit, ka shkelur



përcaktimet ligjore në lidhje me respektimin e distancave urbane, lartësisë së ndërtesave, parcelën minimale të zhvillueshme, intensitetin e ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit të tokës, shfrytëzimin e hapësirave publike dhe hapësirave për rrugë, kërkesat minimale për parkim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kritereve në lidhje me afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar. Bashkia Himarë ka miratuar 3 leje ndërtimi, të cilat janë shqyrtuar me afate të tejzgjatura, më konkretisht:

- “Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat”, me vendim për miratim nr. 98, datë 17.11.2021, me zhvillues z. **E..D..**, në Qeparo, Himarë,
- “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”, me vendim për miratim nr. 115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. Th. Gj., në Palasë, Himarë,
- “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”, me vendim për miratim nr. 116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. Th. Gj., në Palasë, Himarë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 5 praktika, në lidhje me mosrespektimin e kritereve në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit që duhet ngarkuar në sistemin e-leje, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar. Bashkia Himarë ka miratuar 5 leje ndërtimi, të cilat kanë mangësi në dokumentacionin shoqërues të aplikimeve për leje ndërtimi, më konkretisht:

- “Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat”, me vendim për miratim nr. 98, datë 17.11.2021, me zhvillues z. **E..D..**, në Qeparo, Himarë,
- “**Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë**”, me vendim për miratim nr. 114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F..M... dhe ndërtues “A...N” Shpk, në Dhërmi, Himarë,
- “Pishinë dhe sistemime të jashtme në banesë personale 3 kat”, me vendim për miratim nr. 98, datë 17.11.2021, me zhvillues z. **E..D..**, në Qeparo, Himarë,
- “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”, me vendim për miratim nr. 115, datë 24.12.2021, me zhvillues z. Th. Gj., në Palasë, Himarë,
- “Objekt shërbimi 2 kat dhe pishinë”, me vendim për miratim nr. 116, datë 24.12.2021, me zhvillues z. Th. Gj., në Palasë, Himarë,
- “Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”, me vendim për miratim nr.99, datë 17.11.2021, me zhvillues “**J..I..**” Shpk në Jalë, Himarë.

Më konkretisht, dokumentacioni që mungon ka të bëjë me vërtetimet e “Ujësjellës-Kanalizime Himarë” Sha, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, që tregojnë se

subjektet e zhvillimit nuk kanë detyrime të papaguara, Certifikatës së Regjistrimit në QKB ose ekstraktit historik i regjistrit tregtar, policës së sigurimit të përgjegjësive profesionale. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit shoqëruar për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Himarë, nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të lëna në auditimin e mëparshëm me shkresën nr. 594/12 prot., datë 08.03.2022. Konkretisht është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve për të cilat nuk është iniciuar asnjë proces. Nga auditimi rezultoi se: për rekomandimet e dhëna nga KLSH Bashkia Himarë është mjaftuar vetëm me miratimin e plan veprimit dhe ngritjen e komisionit disiplinor për masa disiplinore. Nuk ka kryer procedurë për urdhër ndalesave, nuk ka ngritur padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave përgjegjës nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë shkak për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit të Procedurave Administrative. Për shpërbllim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 9,915,388 lekë, deri me datë 13.02.2023, nuk është arkëtuar. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 5 masa në vlerën 309,314,182 lekë, e pranuar dhe e pa zbatuar.

**13.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 594/12, prot datë 08.03.2022 të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.

**13.1.a Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **28,575 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “**J....T....**”.

**13.1.b Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **1,097,086 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “**B.... 0...**” Shpk.

**13.1.c Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **8,789,727 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “**E..... B....**” Shpk.

### **Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Himarë nuk është realizuar inventarizimi i pasurive (pyje/kullota) ku ushtrohet veprimtaria minerare. Pra nuk ka nisur procesi i transferimit të pronës që kalon në tre faza:

1. Identifikimi i statusit të inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore drejt njësisë së qeverisjes vendore, Bashkisë Himarë;
2. Problematikat e procesit të transferimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;

3. Identifikimi dhe analizimi i opsioneve të përdorimit dhe menaxhimit të pronës shtetërore. Nga auditimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Himarë rezulton se:

- Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullor, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator si vijon: Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

**1.** T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

**2.** Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**3.** Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej **207.65** ha, duke aplikuar tarifatat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**14,090,740 lekë/vit**, për 18 subjekte).

**4.** Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore qëndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

**5.** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Paketës Fiskale.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRIKUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë **914** subjekte në vlerën

**252,053,121 lekë** dhe në vlerë **35,659,000 lekë** janë debitorë për taksë toke **5012 familje** në vlerën **5,819,000 lekë**, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, 5852 familje në vlerën **29,840,000 lekë**.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me Kreun XI “*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*”, të ligjit nr .9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 “*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **287,712,121 lekë**, si më poshtë vijon:

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektorit i Taksave dhe Tarifave dhe Sektorit Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “*Mospagimi taksave dhe tatimeve*”.*

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i praktikave të pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ukonstatua se nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, për periudhën objekt auditimi, ndaj subjekteve “H..... P...-1” Shpk, “M.....” Shpk, “A... K....” Shpk, “D....” Shpk, “D....O...” Shpk, “H.... P...-2..” Shpk, “M.... S.... P...” Shpk, e “D.. O...” Shpk, nuk janë ndjekur procedurat për pajisjen e tyre me autorizim/licenca për tregtimin e naftës dhe gazit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kap II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxheti Bashkisë Himarë **në vlerë 8,000,000 lekë** sipas pasqyrës bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga **8 subjekte** të **vlerës 8,000,000 lekë**, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së

liçencë/autorizimit, Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

**Brenda datës 31.12.2021**

**3. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 59 persona me vlerë **3,851,173 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë, sipas të dhënave sipas pasqyrës Aneks nr. 2/4, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të RPA).*

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t’i kërkojë ASHK-së, Vlorë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi dhe hipotekore subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit, pa kryer pranë Bashkisë Himarë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, sektorin e të Ardhurave Vendore të bëjë të mundur kontabilizimin dhe pasqyrimin e plotë të debitorëve. Të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë ndjekjen e hapave ligjorë, deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e paraqitur si debitorë në vlerën **3,851,173 lekë** sipas listës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Himarë për periudhën objekt auditimi ka lidhur 11 kontrata për dhënie me qira të Aseteve pyje dhe kullota për vendosjen e antenave të telefonisë celulare, nga auditimi në lidhje me pagesat e detyrimeve të kontratave u konstatua se nuk kanë likuiduar detyrimet në vlerën **5,375,850 lekë** që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë, sipas pasqyrës paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-48 të RPA).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **5,375,850 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

### **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” Neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,805,094.10 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 11,108,665.70 lekë, fituar nga BOE “K..I..” Shpk & “I..” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **951,232.26** lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 460 prot., datë 15.12.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe BOE “K..I..” Shpk & “I..” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 126-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **951,232.26 lekë pa Tvsh** nga BOE “K..I..” Shpk & “I..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: “Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 194,444,444 lekë, fituar nga BOE “K..G..K..” Shpk & “M../S..” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,612,310** lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 229 prot., datë 07.09.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe BOE K..G..K..” Shpk & “M../S..” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 126-139 të RPA).*

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,612,310 lekë pa Tvsh** nga BOE “K..G..K..” Shpk & “M../S..” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshtit Kuç”, Bashkia Himarë, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 6,816,766.80 lekë, fituar nga OE “L..” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **598,424** lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 474 prot., datë 20.12.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Himarë dhe OE “L..” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 126-139 të RPA).*

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Himarë të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin, kolaudatorin e punimeve dhe grupin e marrjes në dorëzim të punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën në lidhje me funksionimin e ndriçimit të fshtit Kuç, në zbatim të kontratës nr. 474 prot., datë 20.12.2021 bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori i punimeve si dhe grupi i marrjes në dorëzim të punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë më datë 23.06.2023. Në rast të kundërt, mosvendosja e pajisjeve dhe vënies në funksion e objektit, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga personat përgjegjës.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, duke mos u

mbështetur në bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë, por në një tjetër bazë ligjore dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksa me vlerën më të lartë, në bazë të **Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006** dhe ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt:

**“Godinë shërbimi hoteleri me 4 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”**, me vendim për miratim Nr.114, datë 10.12.2021, me zhvillues z. F...M... dhe ndërtues “A...N” ShPK, në Dhërmi, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **279,728.78 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **279,728.78 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues z. F...M...

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur nëpë rputhje me bazën ligjore të taksës së ndikimit në infrastrukturë, por në një tjetër bazë ligjore dhe nuk është bërë verifikimi me dy metodat e llogaritjes, që të përcaktohet taksa me vlerën më të lartë, në bazë të **Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006** dhe **Ligjin nr. 107/2014**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt: **“Struktura hotelerie 1, 2, 3, 4, 5, 6 kate me 1-3 kate nëntokë”**, me vendim për miratim nr. 99, datë 17.11.2021, me zhvillues OE “J..I..” Shpk në Jalë, Himarë, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **4,363,399.06 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 139-172 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandim:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **4,363,399.06 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues OE “J..I..” Shpk.

**Menjëherë**

## **D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1-7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimin e 7 procedurave me vlerë të fondit limit **159,825 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 7 procedura me vlerë kontrate **151,937mijë lekë** ose 95 % e vlerës së fondit limit, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, vendosje jo e drejtë e kriterëve për kualifikim ka pasur mungesë konkurrence me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike në 4 (katër) procedura për vlerën **51,729,783 lekë pa Tvsh, respektivisht:**

**1.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion pjesor i shkollës 9 vjeçare Himarë”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **6,666 mijë lekë**, me fitues OE “A..A..C” Shpk, me vlerë të ofertës **6,285 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara

dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT, mungojnë Specifikimet Teknike, në përmbushje të përcaktimeve të pikës 3/a, të nenit 15, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “A..A..C”, Shpk. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “A..A..C” Shpk, me ofertë 6,285 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin e paligjshëm të fondeve publike për vlerën **6,285,550 lekë pa Tvsh** (7,542,660 lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 70-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje shkollash”, Bashkia Himarë” Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **8,329 mijë lekë**, me fitues OE “J...” Shpk, me vlerë të ofertës **7,034 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “J...” Shpk. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “J...” Shpk, me ofertë 7,034 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin e paligjshëm të fondeve publike për vlerën **7,034,878 lekë pa Tvsh**(8,441,559.60lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 72-126 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**3.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ujësjetësi i zonës Barmush, Horë Vranisht”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **35,231 mijë lekë**, me fitues OE “A..A..C” Shpk, me vlerë të ofertës **33,441 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT, mungojnë Specifikimet Teknike, në përmbushje të përcaktimeve të pikës 3/a, të nenit 15, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.



Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punëpublike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “A..A..C”, Shpk. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “A..A..C” Shpk, me ofertë 33,441 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **33,441,800 lekë pa Tvsh** (40,130,160lekë me Tvsh). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 70-126 të Raportit të Auditimit).*

**4.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ujësjellësit Piqeras”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **75,765 mijë lekë**, me fitues BOE “E... S...” Shpk & “D... C...” Shpk & “B... B...” Shpk, me vlerë të ofertës **72,556 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara është kërkuar vizitë në kantier pa e formuluar në njoftimin e shkurtuar të kontratës. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punëpublike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 70-126 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**5.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Vepra e marrjes dhe e shtesës së linjës kryesore të ujësjellësit Kuç”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **22,200 mijë lekë**, me fitues OE “L..” Shpk, me vlerë të ofertës **21,970 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara është kërkuar vizitë në kantier pa e formuluar në njoftimin e shkurtuar të kontratës. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punëpublike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 70-126 të Raportit të Auditimit).*

**6.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje lerash”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **5,831 mijë lekë**, me fitues OE “A..A..C” Shpk, me vlerë të ofertës **4,967 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, është kërkuar vizitë në kantier pa e formuluar në njoftimin e shkurtuar të kontratës, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë

publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 70-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësimi i ndriçimit të fshatit Kuç”. Bashkia Himarë, Viti 2021, me fond limit **5,799 mijë lekë**, me fitues OE “L..” Shpk, me vlerë të ofertës **5,680 mijë lekë**, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë tëëkzagjeruara dhe të paargumentuara. Nga NJP prokurimit nuk ka reflektuar tërësisht problematika e konstatuara nga kordinatori i APP-së në lidhje me DT,

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 70-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1-1.7 Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë për pjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

**Menjëherë**

#### **IV. Të dhëna mbi rekomandimet:**

Në përfundim të auditimit në terren dhe hartimit të projekt raportit të auditimit me qëllim përmirësimin e situatës dhe problematikave të konstatuara, grupi i auditimit ka lënë **14** rekomandime organizative, **4** rekomandime për uljen borxhit tatimor, **5** rekomandime për shpërbllim dëmi në vlerën **8,805,094 lekë pa Tvsh** dhe **1** rekomandim për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në përdorimin e fondeve publike.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

*Tiranë Qershor 2023*

